



Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, Prof.Dr. Shkëlqim Cani.

FJALA E GUVERNATORIT

I NDERUAR LEXUES,

Duke përfituar nga privilegji i prezantimit të Raportit Vjetor të Bankës së Shqipërisë për vitin 2003, dëshiroj të theksoj se viti që lamë pas, përgjithësisht shënoi zhvillime pozitive në drejtim të konsolidimit të stabilitetit makroekonomik të vendit, të rritjes ekonomike si dhe të zhvillimit dhe të shëndoshjes së sistemit financiar të vendit. Ky vit u karakterizua nga një rritje e mëtejshme cilësore e punës të Bankës së Shqipërisë, duke dhënë një kontribut pozitiv më të pasur në ekonominë shqiptare. Tashmë gjykoj se ekonomia shqiptare ka hyrë në një proces të pakthyesëm reformash, që do ta afrojnë atë me modelet e përparuara të ekonomive që aspirojnë të anëtarësohen në Bashkimi Evropian.

Ekonomia shqiptare gjatë vitit 2003 i është kthyer ritmeve të kënaqshme të rritjes ekonomike. Vlerësimet paraprake tregojnë se PBB-ja, në terma realë është rritur **me 6 për qind gjatë vitit 2003**. Kjo rritje konstatohet se ka një bazë të gjerë, pasi është mbështetur nga rritja e aktivitetit ekonomik në të gjithë sektorët e ekonomisë. Në veçanti, spikatin sektori i ndërtimit, shërbimeve dhe transportit si sektorët më dinamikë të ekonomisë shqiptare. Aktiviteti ekonomik gjatë vitit 2003 është ndikuar pozitivisht edhe nga rritja e ekonomisë botërore, e cila shënoi një rritje të moderuar duke lënë pas pasiguritë e vitit 2002. Rritja ekonomike ka gjetur një mbështetje në rritje nga sistemi bankar. Teprica e kredisë u rrit me 11.9 miliardë lekë, ndërsa kredia e re e lëvruar gjatë vitit 2003 ishte 92.6 miliardë lekë ose 48 për qind më shumë se në vitin 2002.

Viti 2003 u karakterizua nga një shpërndarje më racionale e shpenzimeve fiskale. Kërkesa e qeverisë për hua ka qenë më e njëtrajtshme gjatë vitit 2003, duke shmangur përqendrimin e financimit të deficitit në muajin dhjetor. Deficiti vjetor në total ishte 19 për qind më i ulët në krahasim me një vit më parë, duke arritur në nivelin 4.4 për qind të PBB-së.

Viti 2003 është karakterizuar nga një aktivitet intensiv në sektorin e jashtëm të vendit, i shprehur në rritjen e konsiderueshme të të ardhurave dhe të shpenzimeve korente. Deficiti i llogarisë korente vlerësohet të jetë ulur me 2 pikë përqindjeje krahasuar me një vit më parë duke arritur në 6.7 për qind të PBB-së. Pozicioni i përgjithshëm i bilancit të pagesave është pozitiv duke bërë që rezervat valutore të vendit të rriten vazhdimisht. Për herë të parë, në muajin dhjetor, niveli i përgjithshëm i tyre kaloi shifrën 1 miliardë dollarë amerikanë.

Rritja ekonomike ka ndikuar edhe treguesit e punësimit, megjithëse ky ndikim shfaqet disi i zbehtë për arsye të problemeve kronike të tranzicionit shqiptar: emigrimit dhe informalitetit të tregut të punës dhe ekonomisë në përgjithësi. Në fund të vitit 2003 shkalla e papunësisë, sipas burimeve zyrtare, **ra në nivelin 15 për qind** krahasuar me 15.8 për qind që ishte në fund të vitit 2002.

Viti 2003 u karakterizua nga një inflacion i ulët, brenda objektivit të Bankës së Shqipërisë. Vlera e inflacionit në muajin dhjetor rezultoi 3.3 për qind, duke respektuar objektivin e Bankës së Shqipërisë. Pavarësisht faktorëve të ndryshëm që kanë ndikuar, vlerësohet se ky inflacion i ulët e ka burimin tek administrimi i kujdesshëm i kërkesës së brendshme, si pasojë e politikave të përshtatshme fiskale e monetare.

Politika monetare e Bankës së Shqipërisë gjatë vitit 2003 ka patur karakter zbutës. Ajo ka synuar uljen e kostos së huamarrjes në ekonomi në përputhje me respektimin e objektivit të stabilitetit të çmimeve dhe të ruajtjes së stabilitetit financiar të vendit. Banka e Shqipërisë ka ulur katër herë normën e interesit, në muajt prill, korrik, tetor dhe dhjetor. Norma bazë e interesit në fund të vitit zbriti në 6.5 për qind duke qenë në nivelin më të ulët të regjistruar.

Ulja e normës bazë të interesit gjatë vitit 2003 nuk ka ndikuar negativisht në treguesit monetarë. Treguesit monetarë gjatë vitit 2003 kanë ecur përgjithësisht sipas parashikimeve të programit monetar të Bankës së Shqipërisë. Raportet e elementeve të ofertës monetare janë rikthyer në ekuilibrin e parakrizës së tërheqjes së depozitave të vitit 2002. Paraja e kthyer në sistem ka lëvizur në drejtim të depozitave me afat në lekë. Në fund të vitit, norma vjetore e rritjes së tyre arriti në 19.1 për qind, duke qenë ndjeshëm mbi normat vjetore të viteve të kaluara.

Tregu bankar pësoi zhvillime të rëndësishme gjatë vitit 2003. Hyrja e një banke të re dhe miratimi paraprak për një tjetër (të dyja bankat e reja me kapital vendas) u shoqërua nga përfundimi i suksesshëm i shitjes së Bankës së Kursimeve, e cila iu shit në masën 100 për qind investitorit strategjik Raiffeisen Bank, një bankë e mirënjohur kjo në tregun financiar ndërkombëtar. Pas këtyre ndryshimeve sistemi bankar shqiptar, në fund të vitit 2003, numëron 15 banka.

* * *

I NDERUAR LEXUES,

Viti 2003 ishte një vit i veçantë dhe i rëndësishëm për Shqipërinë, në procesin e integritimit Evropian, pasi shënoi çeljen, në fund të muajit janar, të bisedimeve zyrtare për nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit midis Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian. Banka e Shqipërisë ka qenë anëtare aktive e grupit negociator të Qeverisë Shqiptare. Në këtë kuadër, Banka e Shqipërisë ka diskutuar nene të marrëveshjes që kanë lidhje me krijimin e institucioneve bankare dhe aktivitetet e lejuara financiare që kryejnë këto institucione; nene që lidhen me liberalizimin e lëvizjeve të kapitalit; me problemet e parandalimit të pastrimit të parasë etj..

Prej kohësh, Banka e Shqipërisë ka shprehur ambicien e saj për të përafuar modelin e vet të bankingut qendror pranë atij të Bankës Qendrore Evropiane. Për këtë arsye, ndryshimet dhe rregullimet e akteve nënligjore të saj janë dhe do të vazhdojnë të mbështesin këtë synim.

Gjithashtu, në funksion të përmirësimit të infrastrukturës së ekonomisë dhe tregjeve shqiptare dhe veçanërisht në drejtim të ndërgjegjësimit të publikut për përparësitë e privatizimit të sistemit bankar, për kujdesin ndaj çmimeve të konsumit në fund të vitit, për uljen graduale të përdorimit të *cash*-it në ekonomi etj.. Banka e Shqipërisë është angazhuar në disa fushata e programe edukuese.

Raporti Vjetor në vijim përmban një trajtim më të detajuar të këtyre çështjeve të prekura në fjalën time. Duke shpresuar se ai do të ofrojë një pasqyrë të mirë të ecurisë së ekonomisë shqiptare dhe të aktivitetit të Bankës së Shqipërisë gjatë vitit 2003, ju ftoj të njiheni më nga afër me të.

*Me respekt,
Shkëlqim Cani
Guvernator*



Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë.

Nga e majta në të djathtë përpara:

Prof.Asocc. Dr. DRINI SALKO	Anëtar
Dr. FATOS IBRAHIMI	Zëvendëskryetar dhe Zëvendësguvernator i Parë
Prof.Dr. SHKËLQIM CANI	Kryetar dhe Guvernator
Prof.Dr. SABAH HILMIA	Anëtar
LLAZI BALLIU	Anëtar

Nga e majta në të djathtë mbrapa:

Prof.Dr. SULO HADËRI	Anëtar
BAJRAM MUÇA	Anëtar
Prof.Asocc. Dr. TONIN KOLA	Anëtar

KAPITULLI I. EKONOMIA BOTËRORE


I.1 ZHVILLIMET NË EKONOMINË BOTËRORE GJATË VITIT 2003

Ekonomia botërore u karakterizua nga një rritje e moderuar gjatë vitit 2003. Pasiguritë e krijuara nga lufta në Irak, pasojat negative që solli rritja joreale e çmimeve në tregjet e kapitalit në Shtetet e Bashkuara si dhe efektet e ndjeshme që pati epidemia SARS, kryesisht në vendet në zhvillim të Azisë Lindore, bënë që prodhimi industrial dhe tregtia ndërkombëtare të vuanin gjatë periudhës prill-qershor. Ndërsa në tremujorin e tretë të vitit filluan të shfaqen shenja optimiste të treguesve ekonomikë, sidomos në SHBA, në Japoni dhe në disa vende të Azisë, të cilat tregonin për një përmirësim të aktivitetit ekonomik deri në fund të vitit.

Politikat makroekonomike të ndjekura në përgjithësi në ekonomitë e mëdha gjatë vitit 2003 ishin lehtësuese, duke reflektuar presionet e ulëta inflacioniste. Të kryesura nga Banka Qendrore Evropiane dhe Komiteti i Tregjeve të Hapura i Rezervës Federale (FOMC), autoritetet monetare të ekonomive kryesore botërore kanë ndjekur një politikë monetare zbutëse duke ulur normën bazë të interesit. Ndërkohë politika fiskale ka patur natyrë më ekspansioniste, veçanërisht në Shtetet e Bashkuara. Pas nuk kanë mbetur edhe disa ekonomi të rëndësishme të Evropës, ku shenjat e ekspansionit fiskal duken në formën e pranimit të shkeljes së kriteve të Traktatit të Maastrichtit, që kufizojnë nivelin e deficitit buxhetor të këtyre vendeve deri në 3 për qind të PBB-së.

Megjithatë, politikat nxitëse makroekonomike, duket se kanë dhënë efekt më të madh në Amerikë dhe në Britaninë e Madhe.

Grafik I.1. Ecuria e ekonomive kryesore të botës.



Burimi: IMF, World Economic Outlook, september 2003.

Tabelë 1.1. Inflacioni (ndryshimi vjetor në përqindje) dhe norma e papunësisë (përqindje e forcës së punës) në Eurozonë dhe në Shtetet e Bashkuara, periudha 2000-2003.

	IÇK*		Papunësia	
	Eurozonë	USA	Eurozonë	USA
2000	2.1	3.4	8.5	4.0
2001	2.3	2.8	8.0	4.8
2002	2.3	1.6	8.4	5.8
2003-T1	2.3	2.9	8.7	5.8
2003-T2	1.9	2.1	8.8	6.1
2003-T3	2.0	2.2	8.8	6.1
2003-T4	2.0	1.9	8.8	5.9

Burimi: Statistikat e Bankës Qendrore Evropiane, janar 2004.

* Për Eurozonën matet indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit (IHÇK).

Likuiditeti i tepërt në tregjet financiare, politikat monetare lehtësuese dhe pritjet se normat e interesit do të qëndronin në nivele të ulëta për një periudhë më të gjatë se ç'ishte menduar fillimisht, shkaktuan rënien e normave të instrumenteve financiare afatgjata. Këto norma arritën në muajin qershor nivelin e tyre më të ulët të 40 viteve të fundit. Muajt në vazhdim, regjistruan rritje të lehtë në normat e instrumenteve financiare, e cila ishte më e dukshme në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Kjo rritje pasqyrore sinjalet pozitive që vinin nga një përmirësim i situatës së përgjithshme ekonomike dhe nga presionet e ulëta inflacioniste. Gjithsesi, ato mbeten në nivele të ulëta si pasojë e kërkesës së madhe të vendeve aziatike për letra me vlerë afatgjatë amerikane.

Në tregjet valutore, dollari amerikan ka vazhduar të nënçmohet ndaj euros si dhe ndaj monedhave të vendeve të tjera të industrializuara. Normat e interesit relativisht më të ulëta në SHBA, shqetësimet lidhur me deficitin e llogarisë korente të këtij vendi dhe rritja e pasigurisë e shkaktuar nga terrorizmi mendohet se janë faktorët e këtij dobësimi.

I.1.1 EKONOMIA EVROPIANE

Ekonomia e Eurozonës u zhvillua me ritme më të ngadalta nga sa ishte parashikuar gjatë vitit 2003. Si pasojë e kërkesës së brendshme të ulët për konsum dhe për investime fikse nga ana e sektorit privat si dhe rritjes më të lartë të importeve krahasuar me eksportet jashtë Eurozonës, në tremujorin e dytë, u regjistrua niveli më i ulët i rritjes së produktit të brendshëm bruto. Ndërkohë, përmirësimi i ambientit ekonomik global gjatë tremujorit të tretë ndikoi pozitivisht në ecurinë e eksporteve evropiane. Këto të fundit, gjykohen si një faktor vendimtar në rritjen e PBB-së në këtë zonë, veçanërisht për ekonomitë e Gjermanisë dhe të Francës.

Pavarësisht shenjave pozitive që u shfaqën në vendet e Eurozonës në gjysmën e dytë të vitit, besimi i konsumatorëve dhe i biznesit mbeti i ulët, papunësia deri në dhjetor rezultonte e lartë, rreth nivelit 9 për qind, ndërkohë që prodhimi industrial nuk tregon për një rritje të qëndrueshme. Nga ana tjetër, indeksi i çmimeve të konsumit për të gjithë zonën gjatë vitit 2003 paraqet një rritje relativisht të ulët e të qëndrueshme. Inflacioni total kapi shifrën 2 për qind në fund të vitit, duke u ndikuar më shumë nga zhvillimet në çmimet e energjisë dhe të ushqimeve të papërpunuara. Niveli i ulët i kërkesës së brendshme dhe vlerësimi i euros

ndaj dollarit amerikan kanë qenë faktorët kyç që kanë ndikuar në zhvillimin e ngadaltë të Eurozonës gjatë vitit 2003.

I.1.2 EKONOMIA AMERIKANE

Aktiviteti ekonomik në Shtetet e Bashkuara ka ardhur duke u zgjeruar gjatë vitit 2003. Politikat rregulluese makroekonomike dhe përmirësimi i vazhdueshëm i produktivitetit ndihmuan në forcimin dhe qëndrueshmërinë e kërkesës së përgjithshme. Produkti i brendshëm bruto vazhdoi të rritej me ritme më të shpejta nga një tremujor në tjetrin. Kontributin më të madh në këtë rritje e kanë dhënë shpenzimet për konsum vetjak, shpenzimet e qeverisë dhe investimet fikse.

Fillimi i vitit 2003 përkonte me kulmimin e krizës së Irakut. Për këtë arsye, gjatë tremujorit të parë të vitit, parashikimet e ekonomisë vareshin nga pasiguritë që shkaktonte konflikti në Irak. Rritja e çmimit të naftës si dhe përkeqësimi i deficitit buxhetor për shkak të rritjes së shpenzimeve të mbrojtjes, çuan në rënien e ekonomisë në përgjithësi. Për rrjedhojë, indeksi i besimit konsumator u lëkund duke iu shtuar hezitimit të bizneseve për të shpenzuar, për të punësuar dhe për të investuar në projekte të reja.

Përfundimi i shpejtë i ndërhyrjes ushtarake në Irak ishte një hap vendimtar pasi reagimi në ekonominë e brendshme amerikane ishte i menjëhershëm. Në tremujorin e katërt të vitit 2003, PBB u rrit me rreth 4.3 për qind krahasuar me periudhën korresponduese të vitit të mëparshëm. Ndërsa norma vjetore e inflacionit erdhi duke rënë nga rreth 3 për qind në tremujorin e parë në 1.9 për qind në muajin e fundit të vitit. Niveli i papunësisë u ul gradualisht në rreth 5.9 për qind në dhjetor nga ngjitja e përkohshme prej 6.1 për qind në mes të vitit. Gjithashtu, nënçmimi i dollarit prej rreth 16 për qind ndaj një shporte të vogël të monedhave kryesore ndërkombëtare, vlerësohet të ketë qenë në përputhje me dëshirën e politikëbërësve amerikanë, ndonëse treguesit e deficitit tregtar dëshmojnë për përmirësime minimale.

I.1.3 ZHVILLIMET NË KURSIN E KËMBIMIT

Tregjet valutore ndërkombëtare kudo në botë gjatë vitit 2003 u karakterizuan nga rritja e vazhdueshme e vlerës së monedhës evropiane ndaj dollarit amerikan. Në fillim të vitit, një euro shkëmbehej me 1.0392 usd ndërsa në fund të tij shkëmbehej me 1.259 usd, duke u mbiçmuar kështu me rreth 21 për qind në harkun e një viti. Përgjithësisht, mund të konkludohet se nënçmimi i dollarit gjatë vitit 2003 pjesërisht ka manifestuar pasojat e luftës në Irak, pjesërisht faktorë ekonomikë dhe pjesërisht vendimmarrjen e vetë këtyre vendeve.


Tremujori i parë i vitit u karakterizua nga pasiguria e lartë gjeopolitike gjatë periudhës së luftës në Irak. Në këtë këndvështrim, lëvizja e dollarit është ndikuar nga pasiguritë për ecurinë e ekonomisë amerikane dhe ekuilibrin e treguesve të saj, të kërcënuar nga deficitin e lartë të llogarisë kapitale, nga deficitin e lartë fiskal, nga prodhimi i ulët industrial dhe nga tregjet e dobëta të punës. Në këto kushte, besimi i investitorëve ndërkombëtarë ndaj monedhës amerikane ra, duke ulur edhe pjesën e investimeve në dollarë e duke çuar dollarin drejt një rënieje edhe më të thellë.

Megjithatë ecuria e monedhës amerikane mbeti e tillë edhe në pjesën e dytë të vitit 2003, kur ekonomia amerikane filloi të jepte shenja të rigjallërimit ekonomik të vendit.

Përveç faktorëve ekonomikë, rënia e dollarit duket se ka gjetur përkrahje edhe nga autoritetet amerikane, të cilat kanë hequr dorë nga mbështetja e tyre verbale ndaj politikës së një dollari të fortë. Një dollar më i dobët do të ndihmonte në rimëkëmbjen e eksporteve amerikane dhe në korrigjimin e deficitit të llogarisë korente, për ta bërë më të qëndrueshëm gjallërimin e ekonomisë amerikane. Gjithashtu, ulja e normës së interesit nga Fed dhe deklaratat publike për rishikimin e politikave dhe të regjimeve valutore të Japonisë dhe Kinës, e kanë mbështetur këtë politikë.

Ndërkohë, euro e fortë nuk ka ndihmuar aspak ekonominë e Eurozonës. Shpeshherë drejtuesit e këtyre vendeve kanë fajësuar forcimin e euros për performancën e dobët ekonomike. Gjithsesi, mbiçmimi nominal i këmbimit të euros ndaj usd nuk pasqyron saktësisht shkallën relative të konkurrencës së ekonomive. Krahasuar me shportat përkatëse të monedhave del se kursi nominal efektiv i dollarit¹ gjatë vitit 2003 është nënçmuar me 15 për qind, ndërsa kursi nominal efektiv i euros është mbiçmuar me 10.76 për qind.

Grafik I.2. Ecuria e kursit nominal efektiv të këmbimit të euros dhe të dollarit si dhe kursi spot i këmbimit usd/euro, gjatë vitit.



I.1.4 VEPRIMET E BANKAVE QENDRORE ME NORMAT E INTERESIT

Politika monetare e bankave qendrore të vendeve kryesore të industrializuara ka patur një natyrë zbutëse. Në kushtet e një inflacioni nën kontroll, madje në prani edhe të shqetësimeve për deflacion, politika monetare zbutëse ka synuar mbështetjen e rritjes ekonomike.

Banka Qendrore Evropiane ka ulur dy herë normat e interesit, në muajt mars dhe qershor. Këto ulje e çuan normën e interesit në nivelin 2.0 për qind nga 2.75 për qind. Megjithatë, gjatë vitit 2003 Këshilli i Bankës Qendrore Evropiane konfirmoi edhe një herë se vendimet mbi politikën monetare do të mbështeteshin tërësisht në arritjen e stabilitetit të çmimeve² në periudhën afatmesme. Mbiçmimi i euros, duke ulur presionet inflacioniste si pasojë e reduktimit të çmimeve të naftës të shprehura në euro, i krijoi më shumë hapësirë Bankës

¹ Kursi nominal efektiv i euros dhe dollarit llogaritet si mesatare e ponderuar e kursit nominal të euros dhe dollarit kundrejt një shpote monedhash. Shportat e përdorura për të llogaritur kurset efektive të euros dhe usd janë të ndryshme. Pesa e monedhave në këto shporta përcaktohet nga pesha e vëllimit të tregtisë me vendet partnere.


² Përkufizimi i Bankës Qendrore Evropiane mbi stabilitetin e çmimeve, i cili është formuluar që në muajin tetor të vitit 1998 "stabiliteti i çmimeve është rritja në bazë vjetore e Indeksit të Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit (HICP), për Zonën Euro poshtë normës 2 për qind. Ky nivel çmimesh duhet mbajtur për një periudhë afatmesme".

Qendrore Evropiane për uljen e normave të interesit. Pavarësisht se rritja e ofertës monetare dhe e likuiditetit ishin në nivele të larta gjatë kësaj periudhe, analistët e Bankës Qendrore Evropiane kanë vlerësuar se për shkak të zhvillimit të dobët ekonomik dhe të paqartësisë për të ardhmen, presionet inflacioniste nuk do të shtoheshin në ekonominë e Eurozonës.

Komiteti i Tregjeve të Hapura i Rezervës Federale (FOMC), reagoi me normën e interesit vetëm pasi Këshilli i Bankës Qendrore Evropiane uli normën për herë të dytë. Komiteti vendosi të reduktojë normën e interesit nga 1.25 për qind në 1 për qind. Kjo ulje kishte si qëllim të mbështeste më shumë rritjen ekonomike, në një kohë që presionet inflacioniste ishin të dobëta.

Grafik I.3. Politika monetare e ekonomive kryesore të botës.

Ecuria e normave bazë të interesit në SHBA, në Eurozonë dhe në Mbretërinë e Bashkuar gjatë periudhës 2002 - 2003 .




I.1.5 ÇMIMET E NAFTËS

Çmimet e naftës kanë pasur një luhajtje të fortë gjatë vitit 2003, të ndikuara kryesisht nga shqetësimet gjeopolitike të globit. Gjatë dy javëve të para të muajit mars çmimi i një barrele me naftë ra nga 34 usd në 25 usd. Gjatë periudhës së luftimeve në Irak oferta e naftës nuk pësoi ndryshime të mëdha pasi kuota që prodhonte Iraku u plotësua nga vendet e tjera të OPEC-ut, kryesisht nga Arabia Saudite.

Shkaktare të luhajtjeve të çmimit të naftës kanë qenë dhe vende të tjera si Venezuela dhe Nigeria. Prodhimi në Venezuelë ra ndjeshëm si pasojë e një greve dymujore të punonjësve të kompanisë shtetërore të prodhimit të naftës në këtë vend. Megjithatë, rimëkëmbja e situatës u bë më shpejt se ç'ishte parashikuar; prodhimi i naftës nga ky vend arriti në 3.3 milionë barrele në ditë, nga 3.2 milionë barrele në ditë që ishte para grevës. Konfliktet në Nigeri, gjithashtu sollën çrregullime në ofertën e naftës.

Gjatë muajit shtator OPEC-u uli ofertën me rreth 900,000 barrele në ditë, veprim ky që bëri që çmimi i një barrele të luhatej rreth 35 dollarë për barrelë. Niveli objektiv i OPEC-ut është 22-28 dollarë për barrelë. Aktualisht, oferta ditore e OPEC-ut, i cili prodhon rreth 40 për qind të naftës në të gjithë botën, është 24.5 milionë barrele në ditë (pa përfshirë Irakun).

Grafik I.4. Çmimet e naftës gjatë vitit 2003.



I.2 EKONOMITË E RAJONIT

Në përgjithësi, ekonomitë e vendeve të rajonit kanë shënuar ritme të larta rritjeje gjatë vitit 2003, të shoqëruar me uljen e inflacionit dhe të normave të interesit. Ndërmarrja e reformave të ndryshme³ ka qenë një faktor më shumë në arritjen e rezultateve optimiste.

Tabelë I.2. Treguesit kryesorë makroekonomikë për disa nga ekonomitë e rajonit gjatë vitit 2003.

	PBB reale % 1/	Inflacioni % 1/	Bilanci fiskal (% ndaj PBB)2/	Llog. korentë (% ndaj PBB)3/	Papunësia % 4/
Turqia	5.4	25.4	-8.0	-3.0	10.2
Maqedonia	3.0	2.5	-1.5	-8.6	31.6
Serbia & Mali i Zi	4.0	12.2	-2.5	-10.3	34.7
Kroacia	5.0	1.5	-5.0	-17.2	14.1

Burimi: 1/ Consensus Economics; OECD Economic Outlook; Economic Commission for Europe.

2/ Official estimates. European Commission; FMN; UN Economic Commission for Europe; EBRD.

3/ FMN, International Financial Statistics; UN Economic Commission for Europe; Economic Survey of Europe, 2003, No 2.

4/ EBRD Transition Report 2003; Economic Commission for Europe; OECD Economic Outlook.

TURQIA

Ekonomia turke është rritur me 5.4 për qind gjatë vitit 2003. Gjatë periudhës janar-dhjetor 2003 prodhimi industrial është rritur me 12.6 për qind krahasuar me vitin 2002. Kjo është shoqëruar edhe me rritje në normën e përdorimit të kapitaleve, e cila në muajin korrik arriti në 80.9 për qind, çka përbën shkallën më të lartë të përdorimit të tyre që nga muaji tetor 2002. Norma e papunësisë vlerësohet të ketë mbetur pak a shumë e njëjtë me një vit më parë, duke regjistruar nivelin 10.2 për qind.

³ Turqia, Ish-Jugosllavia dhe Maqedonia kanë vazhduar procesin e reformave makroekonomike, me qëllim forcimin e ekulibrave të tyre makroekonomikë.

Inflacioni dhe pritjet për të kanë qenë në ulje si rrjedhojë e politikës së shtrënguar monetare të ndjekur nga Banka Qendrore e Republikës së Turqisë. Inflacioni vjetor për vitin 2003 regjistroi shifrën 25.4 për qind, krahasuar me 45 për qind të një viti më parë.

MAQEDONIA

Ekonomia në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë ka patur zhvillime pozitive gjatë vitit 2003. Megjithatë, norma e rritjes ekonomike prej 3 për qind ishte më e ulët se norma e rritjes ekonomike të një viti më parë. Rritje është vërejtur në të gjithë sektorët e ekonomisë.

Norma e inflacionit vjetor për vitin 2003 është 2.5 për qind, ndërsa inflacioni mesatar vjetor është 1.1 për qind. Deficiti buxhetor gjatë këtij viti llogaritet rreth 1.5 për qind e PBB-së, normë kjo më e ulëta në tre vitet e fundit. Situata në tregtinë e jashtme paraqitet me rritje më të madhe në importe se në eksporte. Deficiti në llogarinë korente për vitin 2003 llogaritet rreth 1.5 për qind e PBB-së duke qenë lehtësisht më i ulët se një vit më parë.

SERBIA & MALI I ZI

Kriza politike në Parlamentin e Serbisë ka ndikuar në uljen e ritmit të reformave institucionale, në drejtim të ristrukturimit të sektorit bankar dhe të sektorëve të tjerë të ekonomisë. Megjithatë, vlerësohet se edhe këtë vit ekonomia e Serbisë dhe e Malit të Zi është rritur në terma realë në nivelin 4 për qind, një ritëm rritjeje i njëjtë me atë të një viti më parë.

Duket se arritje ka pasur edhe në drejtim të konsolidimit fiskal të vendit. Deficiti buxhetor regjistroi vetëm 2.5 për qind të PBB-së krahasuar me 5.7 për qind të PBB-së në vitin 2002. Duket se sfida më e madhe mbetet shkalla e lartë e papunësisë, e cila për shkak të reformave strukturore që i bëhen ekonomisë sa vjen e rritet. Sipas të dhënave statistikore nga Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale norma e papunësisë, në shtator të vitit 2003 arriti në nivelin 34.7 për qind.

KROACIA

Ekonomia kroate gjatë vitit 2003 është rritur me ritëm më të ulët krahasuar me vitin 2002. Kështu, në dhjetë muajt e parë të vitit, rritja kumulative e prodhimit industrial arriti nivelin 2.4 për qind, nga 4.6 për qind në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Megjithatë, rritja reale PBB-së përsëri është një shifër e lartë në nivelin 5.0 për qind.

Norma vjetore e inflacionit regjistroi një vlerë prej 1.5 për qind. Ndërkohë që shkalla e papunësisë së regjistruar për vitin 2003 ishte 14.1 për qind, rreth 2 pikë përqindjeje më pak se viti i mëparshëm.

Megjithatë, duhet theksuar se nga problemet më shqetësuese për këtë vend vazhdon të jetë ende konsolidimi fiskal. Edhe gjatë vitit 2003, deficiti buxhetor i matur si përqindje relative ndaj PBB-së ka regjistruar një nivel pak a shumë konstant prej 5 për qind të PBB-së.

KAPITULLI II. EKONOMIA E BRENDSHME

Respektimi i objektivave kryesorë makroekonomikë të përcaktuar në programin afatmesëm për reduktimin e varfërisë dhe nxitjen e rritjes ekonomike ka bërë të mundur forcimin e mëtejshëm të ekuilibrit makroekonomik të vendit gjatë vitit 2003.

Ekonomia shqiptare gjatë vitit 2003 duket se i është kthyer ritmeve të kënaqshme të rritjes ekonomike. Vlerësimet paraprake tregojnë se, gjatë vitit 2003, PBB-ja në terma realë është rritur me rreth 6 për qind, krahasuar me 4.7 për qind në vitin 2002. Rritja e aktivitetit ekonomik është verifikuar në të gjithë sektorët e ekonomisë, pavarësisht se më e theksuar ajo vlerësohet të jetë në sektorin e ndërtimit, të transportit dhe të shërbimeve. Në rritjen e ekonomisë ka dhënë kontribut edhe rritja e investimeve gjatë vitit 2003. Këto investime vlerësohet të kenë arritur në 22.3 për qind të PBB-së, duke shënuar një rritje prej 0.3 pikë përqindjeje krahasuar me vitin 2002. Investimet e sektorit privat, të cilat përbëjnë afërsisht 75 për qind të investimeve totale kanë gjetur një mbështetje më të madhe nga sektori bankar. Teprica e kredisë së sektorit bankar është rritur me 11.9 miliardë lekë ose 30.7 për qind gjatë vitit 2003.

Viti 2003 ka regjistruar një përmirësim të lehtë në situatën e punësimit. Numri i të punësuarve ka pësuar rritje ndërkohë që faktorët kronikë të tranzicionit shqiptar: emigrimi dhe informaliteti i ekonomisë ndikojnë në uljen e forcave të punës gjithsej dhe vështirësojnë shpjegimin e efektit në punësim të politikave dhe zhvillimeve ekonomike të vendit. Në fund të vitit 2003, shkalla e papunësisë u ndal në nivelin 15 për qind krahasuar me 15.8 për qind që ishte në fund të vitit 2002.

Viti 2003 u karakterizua nga një inflacion i ulët, brenda objektivit të Bankës së Shqipërisë. Vlera e inflacionit në muajin dhjetor ishte 3.3 për qind, duke respektuar objektivin e Bankës së Shqipërisë ndërkohë që mesatarisht gjatë vitit 2003, çmimet e konsumit janë rritur me 2.37 për qind. Pavarësisht faktorëve të ndryshëm që kanë ndikuar, vlerësohet se ky inflacion i ulët ka reflektuar kontrollin e presioneve të kërkesës së brendshme si pasojë e politikave të shëndosha fiskale e monetare.

Ndryshe nga vitet e tjera, ky që sapo lamë u karakterizua nga një shpërndarje më racionale e shpenzimeve fiskale. Shpërndarja e kërkesave të qeverisë për huamarrje ka qenë më e njëtrajtshme gjatë vitit 2003, duke shmangur përqendrimin e financimit të deficitit në muajin dhjetor. Gjithashtu, zgjedhjet lokale të tetorit dhe klima e acaruar politike gjatë gjysmës së dytë të vitit nuk janë shoqëruar me përqendrim të shpenzimeve buxhetore apo me kompromentim të disiplinës fiskale. Së bashku me kufizimin e huamarrjes së brendshme të qeverisë në nivelin 2.7 për qind të PBB-së, kanë përbërë një kontribut të çmuar të politikës fiskale për stabilitetin makroekonomik në përgjithësi, dhe për atë të çmimeve në veçanti. Megjithatë, duhet theksuar se pika të dobëta mbeten realizimi i të ardhurave në masën 93 për qind dhe veçanërisht realizimi i shpenzimeve kapitale në masën 62 për qind të planit.

Viti 2003 është karakterizuar nga një aktivitet intensiv në sektorin e jashtëm të vendit, i shprehur në rritjen e konsiderueshme të të ardhurave dhe të shpenzimeve korente. Deficiti i llogarisë korente vlerësohet të ketë arritur në 6.7 për qind të PBB-së, duke u ulur me 2 pikë përqindjeje krahasuar me një vit më parë. Duhet theksuar se deficiti tregtar në terma absolutë vazhdon të thellohet. Ai reflekton kryesisht rritjen e konsumit të ekonomisë shqiptare dhe nënvizion nevojën e rritjes së kapaciteteve prodhuese dhe konkurruese të ekonomisë shqiptare. Pavarësisht sa më sipër, pozicioni i përgjithshëm i bilancit të pagesave është pozitiv, duke

bërë që rezervat valutore të vendit të rriten vazhdimisht. Për herë të parë, në muajin dhjetor, niveli i përgjithshëm i tyre kaloi shifrën 1 miliard dollarë amerikanë, për të regjistruar më saktësisht 1.026 miliardë dollarë në fund të muajit dhjetor 2003.

Tabelë II.1. Disa tregues të ekonomisë në vite.

	1996	1997	1998	1999	2000	2001	2002	2003
Rritja reale e PBB-së (në %) ¹	9.1	-10.3	12.7	8.9	7.7	6.5	4.7	6.0
PBB (me çmime korente, në milionë lekë)	315,835	333,071	425,356	488,611	551,282	590,237	658,062	744,974
PBB (me çmime korente, në milionë usd)	3022.3	2236.9	2824.4	3548.4	3836.3	4113.7	4695.4	6,027.3
PBB (në usd për frymë) ²	920.6	672.9	842.1	1052.0	1128.0	1332.6	1521.0	1934.9
Numri i të punësuarve (në mijë)	1116.0	1107.0	1103.0	1081.0	1068.0	1065.0	921.0	928.0
Përqindja e papunësisë ³	12.4	14.9	17.8	18.0	16.9	14.6	15.8	15.0
Përqindja e inflacionit (v/v)	17.4	42.1	8.7	-1.0	4.2	3.5	2.1	3.3
Deficiti i buxhetit (pa grantet, në % të PBB-së)	-11.4	-13.2	-11.4	-12.1	-9.2	-8.2	-6.9	-5.6
Borxhi i brendshëm (në % të PBB-së)	30.7	36.2	36.2	37.4	42.6	39.5	38.8	38.0
Llogaria korente (pa transfertat zyrtare, në % të PBB-së)	-3.6	-12.2	-7.1	-7.9	-7.4	-6.2	-9.0	-6.7
Borxhi i jashtëm (në % të PBB-së)	29.2	35.6	36.9	32.3	31.8	28.2	24.4	23.3
Kursi mesatar i këmbimit, lekë/usd	104.5	148.9	150.6	137.7	143.7	143.5	140.1	121.9
Kursi mesatar i këmbimit, lek/euro	-	-	-	146.96	132.58	128.47	132.36	137.51

Burimi: INSTAT, Ministria e Financave, vlerësime të FMN-së dhe Banka e Shqipërisë.

II.1 ZHVILLIMI SIPAS SEKTORËVE

Prodhimi sektorial i vendit gjatë vitit 2003 përforcoi rëndësinë e sektorit të shërbimeve, i cili nga viti në vit rrit peshën që zë në totalin e prodhimit të përgjithshëm. Ndërkohë, bujqësia, tradicionalisht një nga degët me potencialin më të madh në drejtim të zhvillimit të vendit, vazhdon të ulë kontributin e saj duke pasqyruar shkaqe të natyrave të ndryshme, ku ato që kanë të bëjnë me reformën e tokës, me pronësinë dhe me lëvizjet e popullsisë vlerësohen si pengesat më serioze.

¹ Të dhënat për PBB-në dhe rritjen reale të saj për vitet 1996-2000 janë të INSTAT-it. Për pjesën tjetër të dhënat janë vlerësime të Ministrisë së Financave, të FMN-së dhe të dhëna të Bankës së Shqipërisë.

² PBB nominale, e konvertuar me kursin mesatar të periudhës. Gjatë vitit 2003 leku kundrejt dollarit është mbijmuar mesatarisht 13 për qind.

³ Shifrat e punësimit i përkasin fundit të nëntëmujorit të parë të vitit 2003.

Tabelë II.2. Kontributi i sektorëve të ekonomisë në prodhimin e brendshëm.

Sektorët	2001	2002	2003
Bujqësia	26.0	25.4	24.7
Industria	10.8	10.5	10.2
Ndërtimi	8.3	8.6	9.1
Shërbimet	45.7	45.9	46.1
Transporti	9.1	9.6	10.0

Burimi: Ministria e Financave.

II.1.1 INDUSTRIA

Prodhimi industrial shënoi një rritje të lartë gjatë vitit 2003 duke kontribuar pozitivisht në rritjen ekonomike të vendit. Kështu, në total prodhimi mall i shitur për industrinë për vitin 2003 arriti vlerën 20.5 miliardë lekë që shënon një rritje prej 18 për qind në krahasim me vitin e kaluar. Industria nxjerrëse⁴, veçanërisht sektori i hidrokarbureve dhe KESH-i, pati rritjen më të lartë prej 77.5 për qind (12 dhe 90 për qind në mënyrë respektive). Ndërsa industritë përpunuese të metalurgjisë, ajo mekanike, ajo e tekstilit dhe e konfeksioneve ishin sektorët të cilët regjistruan një ecuri jo pozitive.

Tabelë II.3. Vëllimi i shitjeve gjatë vitit 2003 (rritja në %).

Aktiviteti	T1-03/T1-02	T2-03/T2-02	T3-03/T3-02	2003/2002
Industria gjithsej	25.48	15.87	13.84	17.92
Industria nxjerrëse	54.77	77.04	101.83	77.50
Industria përpunuese	20.55	24.50	7.57	16.76
Energjia elektrike, ujë, gaz	28.76	-11.42	14.09	9.94
Ndërtim	2.96	3.89	22.90	10.69
Tregti, hotele, restorante	18.32	17.2	3.7	12.27
Transport dhe telekomunikacion	-16.60	5.43	5.25	-1.18
Shërbime të tjera	28.08	-4.13	-8.30	3.90
Gjithsej ekonomia	14.38	12.59	8.40	11.51

Burimi: INSTAT.

Siç është deklaruar edhe në dokumente të tjera të Bankës së Shqipërisë, gjatë vitit 2003 mund të thuhet se situata energjitike e vendit ka qenë relativisht më e favorshme në krahasim me periudhat e mëparshme. Ndoshta për shkak të kushteve atmosferike si dhe pa dyshim për shkak të një administrimi më të mirë nga ana e KESH-it, u shënuar një rritje e ndjeshme e prodhimit në vend. Siç vihet re nga tabela⁵ II.4, importet u ulën me 46.5 për qind në krahasim me vitin 2002, ndërkohë që kapacitetet e brendshme të prodhimit plotësuan 80 për qind të kërkesës së brendshme krahasuar me 57 për qind të një viti më parë. 37 për qind e burimeve energjitike totale u konsiderua si humbje në shpërndarje. Familiarët përbëjnë 63.3 për qind të përdorimit të konsumit të energjisë. Konsumi i tyre u rrit me 9.4 për qind.

⁴ Tabela II.3 paraqet ndryshimin në përqindje të vëllimit të shitjeve për gjithë aktivitetin ekonomik të vendit. Për këtë qëllim, kjo tabelë mund të përdoret si referencë edhe për sektorët e tjerë që janë të analizuar në vijim.

⁵ Siç mund të vihet re disponohet informacion me çmime korente, fakt ky që nuk tregon se sa është ndryshimi real i treguesit. I njëjti problem qëndron edhe për disa nga treguesit e tjerë të përdorur në këtë kapitull.

Tabelë II.4. Treguesit kryesorë të bilancit të energjisë elektrike (në mln. lekë).

	2002	2003	2003/2002
Burime gjithsej	5,535,832	6,145,611	11.0%
Prodhim	3,179,488	4,903,668	54.2%
- Termocentrale	106,712	81,275	-23.8%
- Hidrocentrale	3,072,776	4,824,060	57.0%
Import (përfshirë këmbime)	2,321,595	1,241,943	-46.5%
Përdorime	5,470,145	6,145,611	12.3%

Burimi: INSTAT.

II.1.2 BUJQËSIA

Pavarësisht prej faktit se pesha e këtij sektori në ekonominë e vendit ka ardhur duke u zvogëluar vitet e fundit, përsëri sektori i bujqësisë mbetet një prej sektorëve kryesorë të ekonomisë. Bujqësia këtë vit ka kontribuar me 24.7 për qind të produktit të brendshëm bruto të vendit. Sipas vlerësimeve të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit, prodhimi bujqësor gjatë vitit 2003 është rritur me 3.0 për qind në krahasim me vitin 2002.

Në bazë të vlerësimeve të bëra nga Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit, ecuria e zërave kryesorë të prodhimit bujqësor për vitin 2003 ka qenë si më poshtë:

- Prodhimi i bimëve të arave ka qenë thuajse në të njëjtat nivele si vitin e kaluar. Temperaturat e ulëta të muajit prill dhe thatësira e zgjatur gjatë stinës së verës ndikuan në uljen e prodhimit të grurit dhe të perimeve. Por, prodhimi i misrit dhe i bimëve industriale vlerësohet të jetë rritur mbi nivelin e parashikuar të prodhimit.
- Prodhimi i pemëtarisë gjatë vitit 2003 vlerësohet të jetë rritur me 9.6 për qind në krahasim me vitin 2002.
- Prodhimi i blegtorisë është rritur me 4.6 për qind.

Sektori i agroindustrisë dhe i peshkimit vlerësohet të jetë zhvilluar sipas parashikimeve të bëra. Këta sektorë janë rritur përkatësisht me 10 për qind dhe me 15 për qind.

Tabelë II.5. Parashikimet për sektorin e bujqësisë gjatë vitit 2003.

Degët	Vlerësim i muajit tetor (në mld lekë)	Rritja (në përqindje)
Bujqësi	189.8	2.9
Agroindustri	37.3	10.0
Peshkim	2.4	15.1
Totali	229.6	4.1

Burimi: Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit


Gjatë vitit 2003, sistemi bankar i ka akorduar rreth 712 milionë lekë kredi të re sektorit të bujqësisë. Pavarësisht se mbështetja ndaj këtij sektori të ekonomisë nga sistemi bankar ka ardhur duke u rritur përsëri ajo mbetet në nivele të ulëta. Teprica e kredisë akorduar bujqësisë deri në fund të vitit 2003 është rritur me 25 për qind në krahasim me kredinë në fundvitin 2002. Bujqësia zë 1 për qind të të gjithë portofolit të kredisë së sistemit bankar.

Niveli i ulët i organizimit, copëzimi i tokës, infrastruktura e pazhvilluar në zonat rurale, mungesa financimit e cila çon në mungesën e përdorimit të teknologjisë së përparuar dhe të mënyrave më efikase për përpunim dhe konservim, si dhe migracioni i vazhdueshëm drejt qyteteve, vazhdojnë të jenë disa faktorë zgjidhja e të cilëve do t'i hapi rrugën zhvillimit më të shpejtë të këtij sektori.

II.1.3 NDËRTIMI

Sektori i ndërtimit është ndër sektorët më dinamikë të ekonomisë shqiptare. Të dhënat në dispozicion tregojnë se tremujori i tretë i vitit 2003 shënoi një rritje të indeksit të vëllimit të shitjeve prej 22 për qind krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2002. Ky tregues flet për një rritje të madhe reale. Ndërkohë, rritja vjetore e indeksit të kushtimit në ndërtim regjistroi vetëm 2.7 për qind.

Grafik II.1. Ndryshimet në indeksin e kushtimit në ndërtim.



Burimi: INSTAT.

Ndër faktorët kryesorë që kanë rritur koston në ndërtim do të veçonim shpenzimet direkte, të cilat u rritën me 3.8 për qind në krahasim me vitin 2002. Shpenzimet për materiale ndërtimi u rritën me 4 për qind kurse ato për materiale elektrike dhe hidrosanitare u rritën me 2.4 dhe 3.8 për qind respektivisht. Shpenzimet për paga gjithashtu u rritën me 3.5 për qind, ndërsa shpenzimet për transport u ulën me 2.3 për qind.

Megjithatë, vlen për t'u theksuar se fitimi i parashikuar dhe ngritjet e kantierëve nuk patën ndryshime në krahasim me vitin 2002. Së bashku me rritjen e formalizimit të këtij sektori, këta faktorë mund të ndikojnë në ritmin e zhvillimit të këtij sektori.

II.1.4 SHËRBIMET

Rëndësia e këtij sektori në ekonominë e vendit ka ardhur duke u rritur, fakt ky që konfirmohet nga pesha prej 46.1 për qind që sektori i shërbimeve zë në strukturën e PBB-së. Indeksi i vëllimit të shitjeve për zërin "tregti, hotel, restorante" dhe "shërbime të tjera" është rritur 11.5 për qind krahasuar me vitin e kaluar. Sipas vlerësimeve të para të bëra nga specialistët e bilancit të pagesave, të ardhurat nga turizmi për vitin 2003 janë rritur me 7.2 për qind, por ritmi i rritjes së shpenzimeve që shqiptarët kanë kryer jashtë vendit për turizëm ka qenë më

i lartë. Kjo ka sjellë uljen e të ardhurave neto nga turizmi në 33 milionë dollarë nga 121 milionë dollarë që ishin një vit më parë. Kredia e re që sistemi bankar ka akorduar për sektorin e shërbimeve⁶ është 55.9 miliardë lekë. Teprica e kredisë për këtë sektor në fund të vitit 2003 është 24.9 miliardë lekë, duke zënë 49 për qind të portofolit të kredisë së sistemit bankar.

II.1.5 TRANSPORTI


Në vitin 2003 u vu re një rritje modeste e investimeve në sektorin e transportit. Në krahasim me vitin që kaloi, këto investime u rritën me 3 për qind duke arritur nivelin prej 9.7 miliardë lekësh. Kjo rritje në investime i dedikohet zgjerimit të buxhetit qeveritar prej 7 për qind në krahasim me vitin 2002, duke i vënë theksin përmirësimit të infrastrukturës në vend. Ndërsa, për sa i përket investimeve me kredi apo ndihma të huaja, ato nuk patën ndryshim nga niveli i vitit të kaluar prej 5.3 miliardë lekësh.

Për sa i përket shpërndarjes së këtyre fondeve, ndërtim-montimet përbëjnë 80 për qind të totalit të investimeve, ndërsa investimet e tjera dhe studime e projektimet zënë respektivisht, 15 dhe 5 për qind të buxhetit.

II.2 KURSIMET DHE INVESTIMET

Raporti i kursimeve të brendëshme⁷ kundrejt PBB-së, për vitin 2003, është 14.0 për qind. Kursimet e brendshme për vitin 2003 vlerësohet të jenë rritur me 0.8 pikë përqindje në krahasim me vitin 2002. Në rritjen e kursimeve të brendshme ka ndikuar rritja e kursimeve publike⁸, të cilat për herë të parë gjatë periudhës së tranzicionit kanë vlerë pozitive. Konsolidimi i disiplinës financiare dhe kontrolli i deficitit buxhetor kanë bërë që kursimet publike të jenë me vlera pozitive. Gjithsesi, kursimet e brendshme private janë burimi kryesor i kursimeve në ekonomi. Sipas vlerësimeve, këto kursime arritën në 13.3 për qind të PBB-së gjatë vitit 2003. Niveli i normave reale të interesit ka ndikuar në tërheqjen e një pjese të tyre në sistemin bankar.

Grafik II.2. Ecuria e kursimeve dhe e investimeve në përqindje ndaj PBB-së.



Burimi: IMF, Country Report, january 2004.


⁶ Këtu është përfshirë kredia e dhënë për tregtinë, për riparime automjetesh, për hotele, për restorante, për shërbime dhe për veprimtari sociale, shërbime kolektive dhe personale.

⁷ Të dhënat mbi kursimet dhe investimet i referohen vlerësimeve të publikuara nga FMN-ja në Country report 04/22 'Albania: Review under the three year arrangement under poverty reduction and growth facility - staff report', janar 2004.

⁸ Kursimet publike llogariten si diferencë midis të ardhurave dhe shpenzimeve korente.

Investimet totale në ekonomi arritën në 22.3 për qind të PBB-së. Rritja e investimeve gjatë këtij viti i atribuohet plotësisht rritjes së investimeve private, pasi investimet publike janë ulur me rreth 11.7 për qind. Ulja e investimeve publike ka ardhur si pasojë e realizimit të pjeshëm të shpenzimeve kapitale të planifikuara për vitin 2003.

Grafik II.3. Ecuria e investimeve publike dhe private ndaj PBB-së.



Burimi: IMF, Country report, janar 2004.

Ecuria e bilancit të kursimeve dhe investimeve tregon për një zhvillim më të ekuilibruar gjatë vitit 2003. Rritja më e shpejtë relative e kursimeve të brendëshme në krahasim me investimet është shoqëruar me ngushtimin e deficitit të llogarisë korente gjatë vitit 2003. Nga ana tjetër, kanalizimi i kursimeve në investime të cilat ndihmojnë zhvillimin afatgjatë, është dhe duhet të jetë një nga prioritetet e autoriteteve qeverisëse.

II.3 TREGU I PUNËS⁹

Tregu i punës gjatë vitit 2003 vijoi të ketë disa ndryshime strukturore. Ndryshimet më të rëndësishme ndodhën në numrin e përgjithshëm të forcave të punës, në strukturën e numrin e të punësuarve, si edhe në shifrën e papunësisë.

Tabelë II.6. Treguesit e tregut të punës (në mijë vetë).

Emërtimi	2002				2003			
	Tr.I	Tr.II	Tr.III	Tr.IV	Tr.I	Tr.II	Tr.III	Tr.IV
Forcat e punës gjithsej (në mijë)	1096	1093	1094	1094	1096	1093	1092	1091
A. Të punësuar gjithsej (në mijë)	918	917	919	921	926	927	928	927
i) në sektorin shtetëror	189	188	187	187	185	185	184	182
ii) në sektorin privat jobujqësor	203	203	206	208	207	208	210	211
iii) në sektorin privat bujqësor	526	526	526	526	534	534	534	534
B. Papunësia (në mijë)								
i) të papunë gjithsej	178	176	175	173	170	166	164	164
ii) përfitojnë pagesë papunësie	13	13	12	11	11	11	11	11
C. Shkalla e papunësisë (në %)	16.2	16.1	16.0	15.8	15.5	15.2	15.0	15.0

Burimi: INSTAT, mars 2003.

⁹ Treguesit kryesorë të tregut të punës, me gjithë përmirësimet e matjes statistikore të ndodhura gjatë vitit 2002, duhen marrë akoma me rezerva për shkak të deformimeve që janë rrjedhojë e migrimit të pakontrolluar brenda vendit. Ky migrim, vazhdon të sjellë ndryshime të vazhdueshme në raportin e popullsisë së zonave rurale me ato urbane, emigracionit të krahut të punës jashtë vendit, si edhe në ekzistencën e një tregu të zi të punës relativisht të gjerë.

II.3.1 FORCAT E PUNËS

Forcat e punës në fund të vitit 2003 ishin 1,091 milionë vetë. Gjatë vitit 2003 vihet re një ulje e lehtë e numrit të forcave të punës. Treguesi i punësimit ka ardhur në rënie nga tremujori në tremujor. Kjo ulje tregon se një pjesë e rëndësishme e forcave të punës që krijohen në vend, vazhdojnë të preferojnë emigracionin apo edhe tregun informal të punës.

II.3.2 PUNËSIMI

Në fund të vitit 2003 treguesi i numrit të të punësuarve regjistron një rritje prej 6 mijë vetësh. Rritja e treguesit të punësimit në vitin 2003 është rezultat kryesisht i rritjes së të punësuarve në sektorin privat jobujqësor, në mënyrë të veçantë në sektorin e tregtisë me pakicë dhe të shërbimeve. Ky nënsektor mendohet se punëson një pjesë të mirë të forcave të punës në sektorin privat të vogël, si atë tregtar edhe atë të shërbimeve. Kështu, punësimi në tregtinë me pakicë, gjatë vitit 2003, është rritur me 12.8 për qind në krahasim me fundin e vitit 2002. Në përgjithësi, rritja në sektorin privat jobujqësor arrin në 4 mijë vetë në fund të vitit 2003 në krahasim me fillimin e vitit.

Në sektorin shtetëror ky tregues është ulur me rreth 5 mijë persona, në krahasim me fundin e vitit 2002. Kjo rënie është pasojë e vazhdimit të reformës në administratën shtetërore, në kuadër edhe të plotësimit të kërkesave të integritit të vendit në Bashkimin Evropian.


Rritje është shënuar edhe në numrin e punonjësve në sektorin privat bujqësor, me 8 mijë vetë. Kjo shifër reflekton kryesisht matjen më të saktë të forcave natyrale të punës në këtë sektor pas regjistrimit të fundit të popullsisë dhe banesave (kur kjo shifër u rishikua). Në realitet, periudha e tranzicionit ekonomik në Shqipëri është shoqëruar me lëvizje të popullsisë nga zonat rurale drej atyre urbane dhe jo anasjelltas.

II.3.3 PAPUNËSIA

Treguesi i papunësisë gjatë vitit 2003, në përgjithësi ka regjistruar përmirësime. Papunësia, në fund të vitit 2003 është 9 mijë vetë më e ulët sesa në fund të vitit 2002 ose e shprehur në përqindje, rreth 15 për qind. Viti 2003, është karakterizuar nga ulja e vazhdueshme e papunësisë nga njëri tremujor në tremujorin pasardhës, duke rënë me 6 mijë vetë që nga fillimi i vitit, për të shënuar shifrën e 164 mijë vetëve.

Gjatë vitit 2003 numri i personave që përfitojnë pagesë papunësie ka qenë i pandryshuar, në 11 mijë vetë. Kjo shifër tregon se gjatë vitit 2003 nga kjo kategori punonjësish nuk ka patur punonjës të ripunësuar. Mendohet se kjo kategori ka patur rënie të ndjeshme në dy vitet e fundit, duke u ulur nga 21 mijë vetë në fillim të vitit 2001 në 11 mijë vetë në vitin 2003. Megjithatë, analiza e bazuar në shifrat e punësimit duhet marrë me rezerva. Situata e punësimit, megjithë përmirësimet e vërejtura gjatë vitit 2003 mbetet një problem që meriton një vëmendje të madhe gjatë viteve të ardhshëm.

Grafik II.4. Numri i të papunëve në tre vitet e fundit (në mijë vetë).



II.4 ZHVILLIMET NË SEKTORIN FISKAL

Në zbatim të Programit Buxhetor Afatmesëm, i cili përmbledh parimet dhe prioritetet e politikës fiskale për periudhën 2002-2005, objektivi kryesor i buxhetit për vitin 2003 ka qenë rritja e disiplinës financiare. Në vija të përgjithshme, rritja e disiplinës nënkupton forcimin e qëndrueshmërisë fiskale dhe të stabilitetit makroekonomik në vend si dhe rritjen e efektivitetit të përdorimit të fondeve publike, në interes të përmirësimit të cilësisë së shërbimeve ndaj komunitetit.

Buxheti i vitit 2003 parashikonte rritjen me 20 për qind të të ardhurave dhe ruajtjen e deficitit buxhetor nën nivelin 6 për qind të PBB-së. Performanca e treguesve fiskalë gjatë vitit 2003 ka qenë pozitive në drejtim të ruajtjes së stabilitetit makroekonomik, por me një kontribut më të ulët se parashikimi në aktivitetin ekonomik. Ndërsa deficitin buxhetor u mbajt nën kontroll, duke rezultuar në ruajtjen e ekuilibrave të përgjithshëm makroekonomikë dhe duke kontribuar në veçanti në kontrollin e inflacionit, objektivi i të ardhurave buxhetore nuk u përmbush. Të ardhurat buxhetore u realizuan në masën 93 për qind të planit, duke bërë që edhe shpenzimet buxhetore të ishin nën nivelin e parashikuar. Shpenzimet buxhetore u realizuan në masën 90 për qind të nivelit të planifikuar.

Tabelë II.7. Tregues fiskalë në përqindje ndaj PBB-së.

	1994	1995	1996	1997	1998	1999	2000	2001	2002	2003
Të ardhurat totale	24.1	23.4	16.3	17.0	22.0	22.0	21.9	23.0	22.9	22.4
- Të ardhura tatimore	16.0	13.2	10.7	9.8	12.3	12.9	15.6	15.6	15.7	19.6
Shpenzimet totale	33.1	33.6	31.3	27.7	30.2	33.3	30.9	31.5	29.1	26.9
- Shpenzimet kapitale	3.4	8.3	4.9	4.2	5.7	5.8	6.6	7.4	5.6	4.1
Deficiti buxhetor	-9.0	-10.2	-11.4	-13.2	-11.3	-11.3	-9.1	-8.6	-6.2	-4.4
- Financimi i brendshëm ¹⁰	8.6	6.5	9.0	11.3	6.5	5.0	5.4	4.8	3.2	3.2
- Financimi i jashtëm	0.4	3.7	2.4	1.9	4.8	6.3	3.7	3.8	3.0	1.2

Burimi: Ministria e Financave. Treguesit fiskalë sipas buxhetit të konsoliduar.

¹⁰ Përfshin edhe të ardhurat nga privatizimi.

Në terma nominalë, të ardhurat dhe shpenzimet buxhetore në total u rritën respektivisht me 11 për qind dhe 4 për qind kundrejt vitit 2002, duke përbërë 22.4 për qind dhe 26.9 për qind të PBB-së nominale. Deficiti vjetor ishte 19 për qind më i ulët në krahasim me një vit më parë, duke arritur në nivelin 4.4 për qind të PBB-së.

II.4.1 TË ARDHURAT BUXHETORE

Objektivi strategjik i politikës fiskale në fushën e të ardhurave për vitin 2003 ishte zgjerimi dhe konsolidimi i bazës tatimore si dhe krijimi i një ambienti të favorshëm për zhvillimin ekonomik. Të ardhurat buxhetore vazhduan të ruanin një tendencë rritjeje të lartë edhe pse nuk arritën parashikimin sasior të rritjes prej 20 për qind.

Të ardhurat në total për vitin 2003 u rritën me 11 për qind në krahasim me vitin 2002. Tatimet dhe doganat vazhdojnë të mbajnë peshën kryesore të të ardhurave në buxhetin e shtetit. Tatimi mbi vlerën e shtuar u realizua në masën 93 për qind të nivelit të parashikuar duke dhënë pasoja në mosrealizimin e planit të të ardhurave vjetore.

Tabelë II.8. Struktura e të ardhurave buxhetore në vite (në për qind).

	1998	1999	2000	2001	2002	2003	Realizimi 2003
Të ardhurat në total	100	100	100	100	100	100	93
-Të ardhurat nga tatimet dhe doganat	59.9	60.0	68.6	66.2	66.7	65.0	94
- TVSH	30.8	27.7	31.6	30.4	30.6	30.3	93
- Tatim mbi fitimin	4.6	5.6	6.7	7.6	8.1	7.9	101
- Akcizat	5.3	6.5	7.6	7.0	6.2	7.3	106
- Tatim mbi biznesin e vogël	1.0	1.1	1.4	1.5	1.7	1.8	96
- Tatim mbi të ardhurat personale	1.2	2.9	3.8	4.6	4.1	3.8	86
- Taksat nacionale	3.3	3.7	4.8	5.1	6.7	7.3	87
- Taksat doganore	13.5	10.7	11.2	9.4	8.9	8.3	94
- Të ardhura nga pushteti lokal	0.8	0.8	1.1	1.5	1.8	5.0	103
- Kontribute shoqërore	16.9	16.9	16.6	16.6	17.0	17.2	94
- Të ardhura jotatimore	22.2	22.1	13.7	15.6	14.6	11.3	86

Burimi: Ministria e Financave. Treguesit fiskalë sipas buxhetit të konsoliduar.

Akcizat, të ardhurat nga pushteti lokal dhe tatimi mbi fitimin ishin të vetmet që tejkaluan synimin e vënë në fillim të vitit.

II.4.2 SHPENZIMET BUXHETORE

Shpenzimet buxhetore gjatë vitit 2003 u realizuan në masën 89.6 për qind të nivelit të planifikuar, duke u rritur me 4 për qind krahasuar me vitin 2002. Mosrealizimi i shpenzimeve ka prekur kryesisht shpenzimet kapitale. Këto shpenzime janë realizuar në nivelin 62 për qind të atyre të planifikuara, kryesisht si rrjedhojë e mungesës së financimit të huaj.

Shpenzimet korente realizuan planin vjetor duke patur një përshejtim të tyre sidomos në shpenzimet për personelin në muajt e fundit të vitit. Nga ana tjetër, vihet re se shpenzimet kapitale nuk janë realizuar në asnjë muaj të vitit që kaloi, prandaj mund të thuhet se ato nuk kanë kontribuar në nivelin e pritshëm për rritjen ekonomike gjatë vitit 2003. Mbështetja me

burime të brendshme e këtyre shpenzimeve u realizua sa dyfishi i asaj të huaj ose me 86 për qind dhe 43 për qind respektivisht.

Tabelë II.9. Realizimi i planit për shpenzimet në vitin 2003 (në përqindje).

	1998	1999	2000	2001	2002	2003	Plani 2003
Totali i shpenzimeve	100	100	100	100	100	100	89.6
- Shpenzime korente	82.9	79.1	78.1	76.0	80.6	84.8	100.7
- Personeli	20.0	18.8	19.5	22.2	21.9	22.4	96.6
- Interesat	25.3	21.1	17.3	13.0	12.9	14.9	110.3
- Sigurime sociale	17.2	20.5	21.9	23.6	24.2	22.4	99.5
- Shpenzime kapitale	17.1	20.6	21.3	23.2	19.4	15.2	61.8

Burimi: Ministria e Financave. Treguesit fiskalë sipas buxhetit të konsoliduar.

II.4.3 DEFICITI BUXHETOR

Shpenzimet e ulëta bënë që edhe deficitit buxhetor të ishte më i vogël gjatë vitit 2003. Ky tregues arriti në shifrën 32.8 miliardë lekë ose sa 76 për qind i atij të planifikuar. Kështu, në vlerë absolute ai ishte 19 për qind më i vogël sesa ai i vitit 2002.

Deficiti i vitit 2003 ishte parashikuar të mbulohej 51 për qind me burime të jashtme dhe 49 për qind me burime të brendshme. Në realitet, financimi i brendshëm në fund të vitit ishte 73 për qind i atij total dhe ai i jashtëm 27 për qind. Kjo rritje në financimin e brendshëm solli rritjen e portofolit të obligacioneve qeveritare në treg, ku blerësit kryesorë mbeten bankat tregtare të nivelit të dytë.

II.5 ZHVILLIMET NË INFLACION DHE POLITIKA MONETARE

Inflacioni gjatë vitit 2003 rezultoi brenda objektivit të Bankës së Shqipërisë. Inflacioni vjetor shënoi vlerën 3.3 për qind në fund të vitit 2003 ndërsa norma mesatare e inflacionit vjetor gjatë vitit rezultoi 2.37 për qind.


Tabelë II.10. Norma vjetore e inflacionit (në për qind).

	1999	2000	2001	2002	2003
Janar	6.0	-1.3	2.2	6.5	0.0
Shkurt	3.5	-1.3	1.5	7.6	1.1
Mars	2.0	-2.1	2.9	7.5	1.3
Prill	0.4	-1.4	3.0	6.5	2.3
Maj	-0.1	-0.1	2.5	4.6	2.8
Qershor	-0.6	0.1	4.0	3.7	2.6
Korrik	0.1	-1.3	5.6	4.2	3.0
Gusht	-0.6	-0.7	4.1	5.5	3.0
Shtator	-1.9	0.9	3.5	5.3	2.8
Tetor	-1.8	1.8	1.8	5.8	2.9
Nëntor	-1.2	1.9	2.8	3.7	3.4
Dhjetor	-1.0	4.2	3.5	1.7	3.3

Burimi: INSTAT.

Ecuria e inflacionit gjatë vitit 2003 ka qenë më e qëndrueshme në krahasim me vitet e mëparshme. **Me përjashtim të tremujorit të parë, inflacioni vjetor ka qenë brenda intervalit 2-4 për qind gjatë gjithë vitit 2003.** Gjithashtu, mesatarja e normës vjetore të inflacionit ka ardhur në rënie, duke iu afruar kufirit të poshtëm të këtij intervali.

Grafik II.5. Inflacioni vjetor (në për qind).



Respektimi i objektivit të inflacionit nga Banka e Shqipërisë dhe ruajtja e tij brenda intervalit 2-4 për qind gjatë pjesës më të madhe të vitit 2003 ka dhënë një kontribut pozitiv në zhvillimin e ekonomisë shqiptare. Ai ka ndikuar në ruajtjen e ekuilibrave makroekonomikë dhe në stabilitetin e sistemit financiar. Inflacioni i ulët ka mbajtur normën reale të interesit në nivele pozitive, duke ruajtur aftësinë e sistemit bankar për të thithur kursimet e ekonomisë dhe për t'i kanalizuar ato në financimin e nevojave të ekonomisë.

II.5.1 ZHVILLIMET E INFLACIONIT SIPAS GRUPEVE KRYESORE

Ecuria e inflacionit gjatë vitit 2003 është ndikuar kryesisht nga ecuria e çmimeve të grupit “Ushqime dhe pije joalkolike”. Ky grup¹¹ ka dhënë një kontribut të madh në inflacionin vjetor, veçanërisht gjatë periudhës maj – shtator. Reduktimi i çmimeve si pasojë e futjes së prodhimit vendas nuk u ndje plotësisht në inflacionin vjetor gjatë vitit 2003. Zgjerimi i aktivitetit turistik në këtë periudhë rriti kërkesën për mallra ushqimorë duke zbehur efektin e faktorit sezonal në normën e inflacionit. Kontributi i grupit “Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji” ka qenë i moderuar gjatë muajve të parë të vitit 2003. Por, rritja e çmimit të energjisë elektrike në muajin maj si dhe rritja e çmimit të qirasë në muajin gusht dhe në muajin tetor, sollën rritjen e kontributit të këtij grupi në inflacionin total vjetor. Rritja e çmimit të qirasë u reflektua dhe në rritjen e çmimit të qirasë së inputuar, indeksi i së cilës u rillogarit nga INSTAT-i në muajin tetor (shih **box 1**).

Tabelë II.11. Kontributi i grupeve në inflacionin total vjetor (në pikë për qindjeje).

	Jan	Shk	Mar	Pri	Maj	Qer	Kor	Gus	Shta	Tet	Nën	Dhje
Ushqime dhe pije joalkolike	0.05	0.99	1.11	2.09	2.34	2.23	2.56	2.33	2.21	1.82	2.01	1.20
Qira, ujë, lëndë djegëse, energji elektrike	-0.45	-0.24	-0.18	-0.18	0.10	0.11	0.10	0.39	0.23	0.68	0.91	0.95
Hotele, kafene dhe restorante	0.28	0.20	0.21	0.24	0.26	0.24	0.17	0.15	0.19	0.18	0.17	0.18
Transport	0.13	0.20	0.31	0.25	0.16	0.12	0.10	0.10	0.07	0.12	0.12	0.14
Komunikim	-0.05	-0.05	-0.06	-0.06	-0.05	-0.04	-0.04	-0.04	-0.03	-0.03	-0.02	0.67
Grupet e tjera	0.04	0.00	-0.09	-0.04	-0.01	-0.06	0.07	0.03	0.10	0.10	0.19	0.16
Totali	0.0	1.1	1.3	2.3	2.8	2.6	3.0	3.0	2.8	2.9	3.4	3.3

Burimi: Banka e Shqipërisë.


¹¹Grupi “Ushqime dhe pije joalkolike” zë një peshë prej 42.6 për qind në shportën me të cilën llogaritet IÇK-ja.

Kontributet e grupeve të tjera të shportës kanë qenë të moderuara gjatë vitit 2003.

Rritja e çmimeve të telefonisë fikse ndikoi në rritjen e ndjeshme të inflacionit të këtij grupi dhe të kontributit të tij në inflacionin total gjatë muajit dhjetor. Tarifa e telefonisë fikse u rrit me 68.8 për qind në muajin dhjetor, duke sjellë rritjen e inflacionit vjetor me 0.67 pikë përqindjeje.

Rritja e çmimit të naftës në tregun ndërkombëtar u shoqërua me rritjen e çmimit të naftës në vend, e cila u transformua në rritjen e çmimeve të transportit, gjatë tre muajve të parë të vitit. Ky efekt erdhi duke u zbutur në muajt në vazhdim.

Grafik II.6. Inflacioni vjetor i 4 grupeve kryesore të shportës së IÇK-së (në për qind).



Megjithëse me peshë të vogël, rritja e pagesave arsimore dhe e pagesave shëndetësore bënë që grupet "Shërbimi arsimor" dhe "Shëndeti" të ndikonin në rritjen e inflacionit vjetor të gjashtëmuajorit të dytë të vitit 2003.

Box II.1. Rillogaritja e indeksit të grupit “Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji”.


Në dhjetor të vitit 2001 shporta e mallrave dhe e shërbimeve, e cila shërben për të matur indeksin e çmimeve të konsumit, u ndryshua. Ndryshimi konsistonte në shtimin e artikujve të rinj të konsumit dhe në rillogaritjen e peshave të tyre brenda shportës, për të reflektuar më mirë realitetin e konsumit të familjeve shqiptare.

Një nga artikujt e rinj që u shtua ishte dhe qiraja e inputuar, e cila zë një peshë të konsiderueshme të shportës totale (rreth 17 për qind). Qiraja e inputuar përfaqëson një qira të mundshme (konsum të mundshëm) për qytetarin shqiptar. Ajo mund të kuptohet si qiraja që do të paguante ai nëse do të banonte në një shtëpi jo të vetën. Por, mënyra e matjes së çmimit të këtij artikulli solli disa probleme. Çmimi i tij, përpara muajit tetor 2003, llogaritej si mesatare e ponderuar e të gjithë artikujve të grupit ku bënte pjesë “Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji”. Në këtë mënyrë, rritjet e çmimeve të artikujve të tjerë llogariteshin dy herë në inflacionin total, duke sjellë në ndikime joproporcionale të tyre në inflacion. Konstatimi i kësaj pasaktësie solli nevojën e rishikimit të mënyrës së llogaritjes së indeksit të këtij artikulli të shportës. Ndryshimi, i bërë në muajin tetor 2003, e bazon çmimin e qirasë së inputuar në çmimin e qirasë së zakonshme.

Rillogaritja e këtij indeksi solli ndryshime dhe në indeksin total, duke sjellë rënie të normës vjetore të inflacionit me rreth 0.6-1 pikë përqindjeje gjatë vitit 2003.

Në grafikun e mëposhtëm jepet ecuria e inflacionit për vitin 2003, me të dyja metodat e ndjekura për llogaritjen e tij.

Grafik 1. Norma vjetore e inflacionit sipas metodologjisë së vjetër dhe asaj aktuale.



Ecuria e normës vjetore të inflacionit, e llogaritur me mënyrën e re, ka respektuar me rigorozitet intervalin objektiv të Bankës së Shqipërisë.


II.5.2 FAKTORËT QË KANË NDIKUAR NË ECURINË E INFLACIONIT

Respektimi i objektivave kryesorë të programit të zhvillimit ekonomik të vendit krijoi kushte të përshtatshme për kontrollin e inflacionit gjatë vitit 2003. Këta objektiva kanë garantuar kontrollin e kërkesës së brendshme të ekonomisë dhe stabilizimin e përmirësimin e treguesve monetarë.

SHPENZIMET BUXHETORE DHE DEFICITI BUXHETOR

Shpenzimet buxhetore kanë qenë më të ulëta se niveli i parashikuar vjetor. Ky fakt ka ndikuar në uljen e presioneve inflacioniste, duke qenë se këto shpenzime janë pjesë e kërkesës së brendshme të ekonomisë. Për më tepër, këto shpenzime janë të shpërndara në mënyrë më të njëtrajtshme gjatë vitit 2003 në krahasim me vitet paraardhës. Situata e tensionuar politike dhe zgjedhjet e tetorit nuk u shoqëruan me kompromentim të disiplinës fiskale në drejtim të rritjes së shpenzimeve dhe të thellimit të deficitit buxhetor. Ulja e përqendrimit të shpenzimeve buxhetore në periudha të caktuara, ka kufizuar luhatjet e çmimeve gjatë vitit dhe ka lehtësuar kontrollin e financimit të deficitit buxhetor dhe të lëvizjeve të likuiditetit në ekonomi.

Grafik II.7. Ecuria e shpenzimeve mujore buxhetore (në përqindje ndaj PBB-së).



Gjithashtu, qeveria ka respektuar nivelin e parashikuar të huamarrjes së brendshme gjatë vitit 2003. Kjo huamarrje rezultoi në nivelin 2.7 për qind të PBB-së, kundrejt nivelit 3.2 për qind të PBB-së së shënuar në vitin 2002. Kontrolli i deficitit buxhetor ka sjellë uljen e presionit fiskal mbi treguesit monetarë dhe ka çliruar gjithnjë e më shumë fonde për kreditimin e ekonomisë. Ashtu siç edhe ishte parashikuar nga Banka e Shqipërisë, financimi i brendshëm është përballuar nga kursimet e ekonomisë, ndërkohë që Banka e Shqipërisë nuk ka marrë pjesë në këtë financim.


POLITIKA MONETARE DHE ZHVILLIMET NË TREGUESIT MONETARË

Politika monetare e Bankës së Shqipërisë gjatë vitit 2003 ka patur një kah zbutës. Ajo ka synuar uljen e kostos së huamarrjes në ekonomi, në përputhje me vlerësimet për një ecuri të pranueshme të inflacionit dhe të stabilitetit të sistemit financiar. Zbutja e politikës monetare ishte e nevojshme edhe për të kompensuar rritjen e detyruar të normës së interesit të ndërmarrë nga Banka e Shqipërisë gjatë vitit 2002.

Ritmi i zbutjes së politikës monetare gjatë vitit 2003 është diktuar nga ecuria dhe parashikimet e inflacionit në ekonomi, si dhe nga nevoja për të ruajtur stabilitetin financiar të vendit.

Kështu, Banka e Shqipërisë ka bërë një zbutje më të kujdesshme të politikës monetare gjatë gjashtëmujorit të parë. Gjatë kësaj periudhe, ajo ka bërë vetëm një ulje të normës bazë të interesit, me 0.5 pikë përqindjeje në muajin prill. Ky qëndrim i kujdesshëm i detyrohej tendencave rritëse të inflacionit në tremujorin e parë dhe stabilitetit ende të brishtë të treguesve monetarë. Ndërkohë, stabilizimi i nivelit të inflacionit brenda intervalit 2–4 për qind në muajt në vijim, bëri që Banka e Shqipërisë të ndërmarrë edhe tre ulje të tjera të normës bazë të interesit, në muajt korrik, tetor dhe dhjetor. Të gjitha këto ulje kanë qenë me nga 0.5 pikë përqindjeje. Norma bazë e interesit në fund të vitit zbriti në 6.5 për qind duke qenë në nivelin më të ulët të regjistruar.

Grafik II.8. Norma bazë e interesit në ekonomi.




Diferenca e normave të interesit ka favorizuar mbiçmimin e lekut gjatë vitit 2003, duke ruajtur një kërkesë më të lartë për aktivet financiare në lekë. Në përputhje me politikën monetare zbutëse, Banka e Shqipërisë ka qenë e pranishme në tregun valutor, në kahun e blerjes së valutës. Nëpërmjet këtyre ndërhyrjeve, Banka e Shqipërisë ka tërhequr valutë nga tregu, duke injektuar 6.2 miliardë lekë likuiditet.

Ulja e normës bazë të interesit gjatë vitit 2003 nuk ka ndikuar negativisht në treguesit monetarë dhe në inflacion. Politika monetare ka qenë e kujdesshme në drejtim të respektimit të objektivave sasiorë të Bankës së Shqipërisë dhe të ruajtjes së treguesve monetarë brenda parashikimeve të programit. Banka e Shqipërisë ka qenë e vëmendshme për të ruajtur normat reale të interesit në terma pozitivë, duke ruajtur interesin e publikut për të depozituar kursimet e tyre në sistemin bankar dhe duke kontrolluar situatën e likuiditetit në ekonomi.

ZHVILLIMET NË TREGUESIT MONETARË

Zhvillimet në treguesit monetarë gjatë vitit 2003 kanë ecur përgjithësisht sipas parashikimeve. Rritja e qëndrueshme e agregatëve monetarë, brenda intervaleve të programuara dhe rritjet vjetore të depozitave në lekë dhe parasë jashtë bankave, kanë patur tendenca stabilizimi duke siguruar një situatë të qëndrueshme të likuiditetit.

Grafik II.9. Ndryshimet vjetore të agregatëve monetarë M1 dhe M3 (në përqindje).



ECURIA E KURSIT TË KËMBIMIT

Leku është karakterizuar nga tendenca mbiçmuese kundrejt dy valutave kryesore gjatë vitit 2003. Ky mbiçmim i lekut ka ndikuar në zbutjen e ndikimit të inflacionit të importuar dhe ka mbajtur të ulëta pritshmëritë e popullatës për inflacionin. Veçanërisht i ndjeshëm mbiçmimi i lekut ka qenë në gjashtëmuajorin e dytë, gjatë të cilit leku u mbiçmua mesatarisht me rreth 3.8 për qind ndaj euros dhe me rreth 7.8 për qind kundrejt dollarit.

Grafik II.10. Ecuria e kursit nominal efektiv të lekut gjatë vitit 2003.



Ecuria e inflacionit gjatë vitit 2003 është ndikuar nga rritja e çmimeve të administruara dhe nga disa goditje që kanë ardhur nga kahu i ofertës.

LUFTA NË IRAK

Lufta në Irak çoi në rritjen e çmimit të naftës, nga 26 usd për barrelë në fund të muajit dhjetor 2002, në 32 usd për barrelë në muajin mars 2003. Kontributi i grupit “transport”, në inflacionin vjetor u rrit ndjeshëm, duke arritur në 0.31 pikë përqindjeje në muajin mars. Ndikimi i këtij faktori në inflacion u zbut në muajin maj (kontributi i grupit u ul në 0.16 pikë përqindje), si pasojë e vendimit për rritjen e kufirit maksimal të lejuar të prodhimit marrë nga vendet e OPEC-ut, si dhe uljes së çmimit të referencës për zhdoganimin e naftës.


SEKTORI I BUJQËSISË

Sektori i bujqësisë rezultoi me një prodhim më të ulët të disa degëve të tij në krahasim me parashikimet fillestare të Ministrisë së Bujqësisë. Temperaturat e ulëta në prill, thatësira e zgjatur e stinës së verës dhe rritja e eksportit të produkteve bujqësore dhe blegtorale gjatë periudhës janar-gusht, kanë bërë që në treg të ndihej mungesa e prodhimit¹² bujqësor vendas. Për më tepër, kjo u shoqërua nga zgjerimi i aktivitetit turistik gjatë periudhës së verës në vitin 2003. Këto zhvillime bënë që efekti sezonal i stinës së verës, i cili ndikon në uljen e çmimeve në këtë periudhë, të shënonte një intensitet më të ulët gjatë vitit 2003.

RITJA E KOSTOS SË LËNDËVE TË PARA

Rritja e kostos së lëndëve të para, ka dhënë ndikim në rritjen e nivelit të çmimeve. Indeksi i çmimeve të prodhimit¹³ ka shënuar vlera të larta gjatë vitit 2003. Rritja e çmimeve që në hallkat më të para të prodhimit rezulton në rritjen e çmimeve të produkteve përfundimtare.

Grafik II.11. Indeksi i çmimit të prodhimit për vitin 2003.



INFLACIONI I IMPORTUAR

Inflacioni i importuar nga vendet partnere ka ushtruar një presion më të lartë mbi çmimet e mallrave të konsumit në Shqipëri në krahasim me vlerat normale të tij. Ky ndikim merr një rëndësi të veçantë në kushtet kur kërkesa në vend për mallrat e konsumit plotësohet në një masë të madhe nga mallrat e importit. Ekonomia shqiptare, si një ekonomi në rritje dhe me një bazë të vogël prodhuese, mbetet e orientuar drejt importit¹⁴. Partnerët kryesorë të vendit tonë në shkëmbimet tregtare, gjatë vitit 2003, mbeten Italia dhe Greqia. Importet nga këto shtete zënë respektivisht 34 për qind dhe 21 për qind të importeve totale. Të dyja këto shtete kanë shënuar norma të larta të inflacionit¹⁵.

¹² Burimi: Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit. Parashikimi për rritjen e prodhimit të degës së bujqësisë në korrik u reduktua me 0.2 pikë përqindjeje. Thatësira uli prodhimin e grurit dhe të perimeve me respektivisht rreth 20 mijë ton dhe rreth 10 mijë ton më pak se parashikimi për vitin 2003. Po kështu, për periudhën janar-gusht 2003, eksporti i produkteve bujqësore dhe blegtorale ishte 12 për qind më i lartë se viti i kaluar.

¹³ Ky indeks, i llogaritur nga INSTAT-i, mat çmimin e lëndëve të para dhe ndërmjetëse duke u bazuar në anketimin e 600 ndërmarrjeve prodhuese.

¹⁴ Gjatë nëntëmuorit të parë importi ishte rreth 4 herë më i lartë se eksporti.

¹⁵ Norma e inflacionit mesatar për vitin 2003, e matur mbi indetin HCPI për Italinë është 2.8 për qind dhe për Greqinë 3.5 për qind.

Këto norma janë më të larta sesa norma e inflacionit mesatar të Eurozonës, prej 2.1 për qind. Burimi i të dhënave: Eurostat.

Tabelë II.12. Inflacioni vjetor i vendeve kryesore partnere (në për qind).

	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
Greqi	1.2	1.2	1.0	3.5	3.6	3.5	3.3	3.4	3.2	3.1	2.9
Itali	4.2	3.9	3.3	2.9	2.9	2.9	2.7	3.0	2.8	2.	2.5

FUSHATA EFEKTIVE PËR PARANDALIMIN DHE ZBUTJEN E FENOMENIT SPEKULATIV

Një faktor specifik, i cili duhet përmendur, është dhe fushata efektive për parandalimin dhe zbutjen e fenomenit spekulativ të rritjes së çmimeve gjatë festave të fundvitit. Rezultatet e kësaj fushate përmbledhen jo vetëm në faktin që rritja e çmimeve në muajin dhjetor rezultoi e ulët, por dhe në ndërgjegjësimin e publikut për ndikimin pozitiv që ushtron një sjellje më normale konsumatore dhe tregtare në nivelin e çmimeve (shih box.2).


Box II.2: Fushata për parandalimin e fenomenit të rritjes spekulative të çmimeve.

Ruajtja e stabilitetit të çmimeve është qëllimi kryesor i Bankës së Shqipërisë. Për të përmbushur këtë mision, Banka e Shqipërisë, krahas zbatimit të një politike monetare të përshtatshme dhe të kujdesshme përdor dhe mjete të tjera, që ndihmojnë në rritjen e efektivitetit të vendimeve të saj. Një nga këto mënyra komunikimi është fushata për parandalimin e fenomenit spekulativ të rritjes së çmimeve. Për të dytin vit rresht, Banka e Shqipërisë organizoi një fushatë për të zbutur rritjen spekulative të çmimeve gjatë festave të fundvitit. Natyra spekulative e tregut, si pasojë e mungesës së konkurrencës, mungesës së një kontrolli të duhur tatimor, si dhe një modeli sjelljeje në blerje, i cili e kthen kërkesën në një kërkesë joelastike, bën që çmimet të rriten edhe në kushtet e një oferte të mjaftueshme. Banka e Shqipërisë, duke qenë e ndjeshme ndaj efekteve të dëmshme që sjell një fenomen i tillë, për ekonominë në tërësi, për ekonominë e individëve, si dhe për përmbushjen e objektivit të saj bashkëpunoi me organet shtetërore, me biznesin, me shoqërinë civile dhe median, me synimin e vetëm për të edukuar publikun dhe për të rritur, kështu transparencën dhe efektivitetin e vendimeve të marra nga ajo.

Fokusi kryesor i kësaj fushate, si dhe sukcesi real i saj ishte ndërgjegjësimi i publikut. Rritja e çmimeve gjatë festave të fundvitit është kthyer në një mentalitet që pranohet në një shkallë të gjerë nga popullsia. Nga vrojtimi i kryer nga Banka e Shqipërisë rezultoi se 92 për qind e popullsisë presin rritjen e çmimeve gjatë dhjetorit. Duke qenë se konsumatori shqiptar ka një pritje të tillë gjatë festave të fundvitit, ai bëhet dhe vetë nxitës i rritjes së çmimeve. Sensibilizimi i tij për të mos kryer blerje të tepërta u shoqërua me sensibilizimin e biznesit për të rritur fitimet e tij nëpërmjet rritjes së vëllimit të shitjeve dhe me thirrjen drejtuar organeve tatimore për të mbledhur me rigorozitet taksat.

Në kuadër të kësaj fushate, Banka e Shqipërisë ndërmori iniciativën e monitorimit të çmimeve për një sërë artikujsh ushqimorë të konsumit të përditshëm. Nga analizat dhe vrojtimet e bëra deri më tani rezultoi se artikujt e përfshirë në monitorim, të cilët zënë një peshë të konsiderueshme në shportën e indeksit të çmimeve të konsumit, reflektojnë dukshëm efektet spekulative të rritjes së çmimeve. Nga monitorimi rezultoi se çmimi i frutave dhe perimeve rritet ndjeshëm në prag të festave. Nga përpunimi i të dhënave të çmimeve ditore të frutave dhe perimeve u evidentua tregu i shumicës si hallka që jep nxitjen për rritjen e çmimeve në zinxhirin e tregtisë.

Grafik 1. Ecuria e çmimeve në tregjet e ndryshme.



Fushata kundër rritjes spekulative të çmimeve dha efektet e veta që në muajin dhjetor. Inflacioni mujor i artikuljeve ushqimorë rezultoi më i ulët në krahasim me vitet paraardhëse.

Tabelë 1. Inflacioni mujor i nëngrupeve "Fruta" dhe "Zarzavate" në vite.

	2000	2001	2002	2003
Fruta	24.8	16.3	16.5	1.5
Zarzavate	25.6	41.2	42.9	33.7

Megjithatë, efektet e fushatave të tilla shtrihen në një horizont të gjatë kohor. Në planin afatshkurtër, ajo ka ndikuar në zbutjen e efekteve negative të këtij fenomeni në normën mujore të inflacionit gjatë muajit dhjetor të vitit 2003. Në krahasim me 4 fundvitet e fundit, inflacioni mujor i nëngrupeve "Fruta" dhe "Zarzavate përfshirë patate" në muajin dhjetor 2003 rezultoi më i ulët.

Rezultatet afatgjata të kësaj fushate janë edukimi dhe sensibilizimi i konsumatorëve. Këto rezultate janë një shpërblim i vullnetit të mirë, i kohës, i energjisë dhe i përkushtimit të Bankës së Shqipërisë.


II.6 BILANCI I PAGESAVE

II.6.1 ZHVILLIME TË PËRGJITHSHME NË BILANCIN E PAGESAVE GJATË VITIT 2003

Deficiti korent në fund të vitit 2003 ishte 407 milionë usd duke qenë në nivelin 6.7 për qind të PBB-së. Peshja e deficitit korent ndaj PBB-së është zvogëluar ndjeshëm në krahasim me vitin e kaluar, kur ky raport ishte 8.7 për qind. Ngushtimi i deficitit korent me 13 milionë dollarë ka ardhur si pasojë e bilanceve pozitive të të ardhurave dhe transfertave korente.

Hyrjet neto të kapitalit kanë mbuluar rreth 90 për qind të deficitit korent. Detyrimet financiare të Shqipërisë ndaj jorezidentëve janë rritur me 328 milionë usd. Ato përfaqësohen pothuajse tërësisht nga investimet e huaja direkte dhe nga huamarrja zyrtare dhe private. Rritje gjatë këtij viti është regjistruar edhe në mjetet e rezidentëve jashtë, të përfaqësuara nga depozita, investime portofoli dhe valutë në pronësi të rezidentëve.

Grafik II.12. Deficiti korent ndaj PBB në përqindje.



Gjatë vitit 2003 dollari amerikan është nënçmuar ndjeshëm ndaj monedhës evropiane dhe ndaj lekut. Duke qenë se një numër i madh i transaksioneve midis rezidentëve dhe jorezidentëve kryhet në euro dhe jo në monedhën e raportimit të bilancit të pagesave, dollari amerikan, analiza e bilancit të pagesave duhet të mbajë parasysh efektet e kursit të këmbimit. Konkretisht, deficiti tregtar i matur në euro është zvogëluar me 3.4 për qind gjatë vitit 2003, ndërkohë që raportimi në usd tregon një deficit të rritur me 15.7 për qind. Të njëjtat komente mund të bëhen edhe për zërat e tjerë të llogarisë korente apo të asaj kapitale dhe financiare.

II.6.2 LLOGARIA KORENTE

Vëllimi i transaksioneve korente arriti në rreth 5 miliardë dollarë gjatë vitit 2003. Nga këto, 2.7 miliardë kanë qenë shpenzime dhe kanë shkuar kryesisht për blerje mallrash dhe shërbimesh prej jorezidentëve. Të ardhurat e llogarisë korente janë siguruar në pjesën më të madhe nga transfertat korente (40 për qind), nga shërbimet e kryera për jorezidentët (32 për qind) si edhe nga eksportet e mallrave (20 për qind). Deficiti korent shënoi 407 milionë dollarë gjatë vitit 2003. Ky deficit paraqitet më i ulët sesa ai i vitit 2002, edhe nëse nuk merret parasysh efekti i kursit të këmbimit.

Tabelë II.13. Zërat e llogarisë korente gjatë viteve 2002 dhe 2003 (në milionë dollarë).

	2001	2002	2003	Ndryshimi 2003/2002
LLOGARIA KORENTE (1+ 6)	-217.9	-420.8	-406.7	96.6
1. Mallra, shërbime dhe të ardhura (2+ 5)	-788.7	-1,034.0	-1,248.6	120.8
1.1 Kredi	1000.6	1,062.2	1,361.6	128.2
1.2 Debi	-1789.2	-2,096.2	-2,610.3	124.5
2. Mallra dhe shërbime (3+4)	-937.7	-1,160.4	-1,419.0	122.3
2.1 Kredi	838.1	915.3	1,166.9	127.5
2.2 Debi	-1,775.8	-2,075.6	-2,585.8	124.6
3. Mallra	-1,027.0	-1,155.1	-1,336.3	115.7
3.1 Kredi	304.6	330.2	447.2	135.4
3.2 Debi	-1331.6	-1,485.4	-1,783.5	120.1
4. Shërbime	89.3	-5.2	-82.7	1578.8
4.1 Kredi	533.5	585.0	719.7	123.0
4.2 Debi	-444.2	-590.3	-802.4	135.9
5. Të ardhura	149.0	126.4	170.3	134.8
5.1 Kredi	162.5	146.9	194.8	132.6
5.2 Debi	-13.4	-20.6	-24.4	118.7
6. Transferta korente	570.8	613.2	841.9	137.3
6.1 Kredi	647.5	671.7	924.2	137.6
6.2 Debi	-76.7	-58.5	-82.3	140.5

Deficiti i thellë i tregtisë në mallra dhe në shërbime u balancua pjesërisht prej suficiteve në llogarinë e të ardhurave dhe në atë të transfertave korente. Megjithëse rritja relative e importeve të mallrave, në terma të dollarit ishte më e vogël se rritja e eksporteve, deficiti tregtar gjatë vitit 2003, rezultoi rreth 180 milionë dollarë më i lartë sesa deficiti i vitit 2002. Rritja vjetore prej rreth 16 për qind e deficitit tregtar, është shkaktuar kryesisht prej efektit të kursit të këmbimit.

Llogaria e shërbimeve gjatë vitit 2003 ka regjistruar rritje si në kahun e të ardhurave, ashtu edhe në atë të shpenzimeve. Këtu duhet nënvizuar fakti që shpenzimet për shërbime kanë paraqitur një ritëm rritjeje më të lartë sesa të ardhurat. Kjo llogari u mbyll me një deficit prej 83 milionë dollarësh, në ndryshim nga vitet paraardhës kur bilanci i shërbimeve është paraqitur me suficit.

Llogaria e të ardhurave, për shkak të përafërsisë së burimeve të përdorura, paraqet ecuri të ngjashme me atë të llogarisë së transfertave korente. Një zhvillim pozitiv në këtë llogari është rritja e të ardhurave nga interesat mbi investimet e njësive rezidente jashtë vendit.

Bilanci i transfertave korente ka të njëjtën formë dhe shenjë si në vitet e kaluara, duke u dominuar dukshëm nga prurjet nga emigrantët. Këto të fundit përbëjnë 84 për qind të hyrjeve në këtë llogari, raport ky disi më i ulët se ai i vitit të kaluar, gjatë të cilit prurjet nga emigrantët ishin 94 për qind e totalit të hyrjeve.


TREGTIA E MALLRAVE

Shkëmbimet tregtare në mallra, regjistruan një vëllim prej rreth 2.2 miliardë dollarësh ose 22.8 për qind më të lartë në krahasim me vitin paraardhës. Transaksionet tregtare gjatë këtij viti kanë përfaqësuar 54 për qind të të gjitha transaksioneve të Shqipërisë me botën.

Shpenzimet për importe mallrash kapën shifrën 1.8 miliardë usd, duke qenë 289 milionë dollarë ose 20 për qind më të larta se ato të vitit të kaluar. Të ardhurat nga eksporti i mallrave regjistruan 447 milionë usd dhe një rritje vjetore prej 35 për qind. Ekonomia shqiptare mbetet e orientuar nga importet e mallrave, të cilat gjatë vitit 2003, përfaqësuan 80 për qind të vëllimit të tregtisë së jashtme.

Deficiti tregtar për vitin 2003 arriti në rreth 1.3 miliardë dollarë dhe vlerësohet 16 për qind më i lartë sesa ai i vitit paraardhës. Edhe pse rritja vjetore e eksporteve gjatë vitit 2003 ka qenë më e lartë në krahasim me vitet e kaluara (117 milionë dollarë), vëllimi total i eksporteve mbulon vetëm 25 për qind të importeve. Arsyeja kryesore e zhvillimit jo të kënaqshëm të eksporteve shqiptare është shkalla e ulët e konkurrencialitetit të produkteve shqiptare në tregjet ndërkombëtare. Ky tipar bën që eksportuesit shqiptarë të mos shfrytëzojnë plotësisht përfitimet e rrjedhura nga marrëveshjet e tregtisë së lirë në rajon. Kërkesa e huaj, dhe sidomos ajo e vendeve të Bashkimit Evropian për eksporte shqiptare, falë zhvillimit të ngadaltë ekonomik botëror, ka mbetur në të njëjtat nivele si në dy-tre vitet e mëparshme.

Grafik II.13. Rritja në eksporte dhe importe. Index. 1996=100.



Megjithë vëllimin e vogël, ecuria e eksporteve gjatë këtij viti, ka përcjellë shenja të përmirësimit të industrisë përpunuese në vend. Kontributin kryesor në rritjen e eksporteve shqiptare e kanë dhënë riekспортet (eksporte me material porositësi), të cilat dominojnë eksportet shqiptare, duke zënë rreth 77 për qind të vëllimit të përgjithshëm të tyre. Gjithashtu, një rritje vjetore prej 16 për qind është regjistruar në eksportet nga prodhimi vendas. Këto të fundit, gjatë vitit 2003, kanë përfaqësuar rreth 22.5 për qind të eksporteve të përgjithshme. Pavarësisht nga ky zhvillim, struktura e eksporteve vazhdon të vuajë nga shkalla e ulët e diversifikimit.

Rritja e çmimit të kromit në tregjet ndërkombëtare, pas 6 vjetësh rënieje të vazhdueshme, ofroi mundësinë për gjallërimin e industrisë minerare të kromit në Shqipëri. Çmimi i ferrokromit në tregjet e huaja, afërsisht 600 usd/ton, çoi në rritje të eksporteve të këtyre të fundit. Të ardhurat nga eksporti i metaleve bazë për vitin 2003 rezultuan 61 për qind më të larta në krahasim me të ardhurat e vitit paraardhës. Aktualisht, në vendin tonë, në këtë industri ushtrojnë aktivitet 109 subjekte private¹⁶.

¹⁶ Burimi: Ministria e Industrisë dhe Energjitikës.

Tabelë II.14. Shpërndarja e importeve sipas grupmallrave.

Kodi	Përshkrimi	Import	Eksport	Bilanci tregtar
0	Ushqime dhe kafshë të gjalla	268.1	18.9	-249.2
1	Pije dhe duhan	68.8	5.8	-63.0
2	Materiale të papërpunuar	63.7	19.4	-44.3
3	Lëndë djegëse	158.9	4.9	-154.0
4	Yndyrna bimore dhe shtazore	29.0	0.5	-28.5
5	Produkte kimike	159.7	2.9	-156.8
6	Mallra të përpunuar	441.0	77.5	-363.4
7	Makineri dhe pajisje	403.4	15.8	-387.5
8	Mallra të tjerë të përpunuara	264.7	301.5	36.8
9	Mallra të paklasifikuar diku tjetër	0.0	0.0	0.0
	TOTAL	1,857.2	447.2	-1,410.0

Importi tregtar shënoi rritje të ndjeshme në të gjitha kategoritë e grupmallrave. Një zhvillim inkurajues është edhe rritja e importeve të mallrave kapitale, të cilët përdoren për investime në procese të ndryshme prodhuese. Efektin më të madh në rritjen e importeve të përgjithshme e kanë dhënë importet në makineri e pajisje (rritje vjetore prej 18 për qind), të cilat zënë një peshë të konsiderueshme në importet e përgjithshme. Ecuria e importeve të këtij grupi është një tregues i nivelit të investimeve në vend. Importet më të larta kanë qenë ato të pajisjeve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (media elektronike, valë komunikimi) si edhe pajisjet e përdorura për rinovimin e rrjetit energjetik në vend.

Megjithë rritjen e vazhdueshme të çmimit të karburanteve në tregjet ndërkombëtare, kërkesa e brendshme për këto të fundit ka mbetur e lartë, duke bërë që sasia e importuar gjatë vitit 2003 të ishte 19 për qind më e lartë në krahasim me një vit më parë.

Ecuria pozitive e prodhimit të energjisë elektrike në vend gjatë vitit 2003, solli rënie të importeve në energji elektrike në krahasim me vitin paraardhës. Gjatë këtij viti janë importuar 561 milionë kwh më pak se një vit më parë, gjë që ka çuar në uljen e shpenzimeve të importit me rreth 17 për qind.

Kushtet atmosferike jo të favorshme për prodhimin bujqësor dhe për frutikulturën në vend, çuan në rritje të importeve në produkte vegjetale (18 për qind), ndër të cilat ndjeshëm janë rritur drithërat, zarzavatet dhe frutat.

E lartë mbetet kërkesa për importet në ushqim, pije dhe duhan, të cilat gjatë këtij viti kanë shënuar një rritje prej 21 për qind. Një zhvillim për t'u përmendur në këtë grup, është rritja prej 29 për qind e sasisë së importuar të duhanit, gjë që mendohet se ka ardhur kryesisht si pasojë e luftës kundër evazionit fiskal. Edhe në të ardhmen, vazhdimësia e këtij procesi, pritet të ketë rezultat në importet e regjistruara të mallrave që janë subjekt i akcizës.

Importet e lëndëve të para për përpunim aktiv (tekstile, veshje të këmbëve dhe metale) u rritën me rreth 34 për qind. Ecuria e këtyre importeve reflekton zhvillimet e vërejtura në sektorin e rieksperteve.

Nga pikëpamja gjeografike aktiviteti tregtar i Shqipërisë mbetet i orientuar drejt vendeve të Bashkimit Evropian. Shkëmbimet tregtare me këtë grup shtetesh zënë rreth 68 për qind të importeve dhe 93 për qind të eksporteve. Italia dhe Greqia përfaqësojnë partnerët kryesorë brenda këtij grupimi. Normat e rritjes së importeve dhe eksporteve me vendet e Bashkimit

Evropian flasin për një thellim të tregtisë me këto vende. Ndërkohë, tregtia me vendet e rajonit të Evropës Juglindore (EJL) të përfshira në procesin e krijimit të zonës të lirë tregtare, vlerësohet e kufizuar. Ajo paraqet një sjellje rastësore dhe nuk shfaq një model të mirëfilltë tregtar.

Tabelë II.15. Shpërndarja e importeve sipas partnerëve tregtarë në vite.

Importi	Pesha në totalin e importit			Ndryshimi vjetor	
	2001	2002	2003		%
Total	100.0	100.0	100.0		24.9
Vendet e BE – 15	74.2	71.1	68.3		14.5
Itali	31.9	34.7	34.1		17.6
Greqi	25.8	21.9	19.8		1.7
Gjermani	5.8	5.6	5.7		42.8
Vendet e Evropës Juglindore	5.8	7.1	6.1		2.9
Bullgaria	2.0	1.9	2.2		40.8
Bosnje & Hercegovinë	0.0	0.0	0.1		83.6
Kroaci	1.3	2.2	1.5		-12.2
Ish- Jugosllavi	0.5	0.8	0.6		-23.8
IRJ e Maqedonisë	1.1	1.1	0.9		-4.8
Rumani	0.9	1.1	0.9		-6.1
Turqi	6.2	6.1	6.5		31.4
Rusi	1.4	2.6	2.9		46.8
Ukrahinë	1.1	1.2	2.3		205.0
Vende të tjera	11.4	11.8	13.9		22.6

Efektet e pritshme të liberalizimit tregtar midis vendeve të Evropës Juglindore mund të konsiderohen të shumëllojshme. Liberalizimi i tregtisë nënkupton jo vetëm ndryshim në mjedisin e biznesit, i cili sjell zgjerimin e mundësive për eksporte dhe rritjen e konkurrencialitetit, por edhe ndryshime në sjelljen sociale dhe kulturore të vendeve.

Tabelë II.16. Shpërndarja e eksporteve sipas partnerëve tregtarë në vite.

Eksporti	Pesha në totalin e eksportit			Ndryshimi (2003/2002)	
	2001	2002	2003		%
Total	100.0	100.0	100.0		35.4
Vendet e BE – 15	91.6	92.1	93.3		37.1
Itali	71.2	71.7	74.9		41.4
Greqi	13.1	12.8	12.9		35.7
Gjermani	5.5	5.5	3.4		-16.8
Vendet e Evropës Juglindore	4.7	3.8	4.3		20.8
Nga të cilat:					
Ish - Jugosllavia	3.1	2.2	2.6		41.7
IRJ e Maqedonisë	1.5	1.5	0.7		-37.1
Vende të tjera	3.7	4.1	2.4		45.2

SHËRBIMET

Viti 2003 u karakterizua nga një deficit i lartë në tregtinë e shërbimeve. Eksporti neto i shërbimeve për vitin 2003 u vlerësua në -82.7 milionë dollarë, duke qenë mjaft më i lartë se ai prej -5.2 milionë dollarësh i regjistruar në fund të vitit 2002. Deficiti i vitit 2003, paraqet një

kthesë në llogarinë e shërbimeve e cila gjatë viteve 1999-2001 ka regjistruar suficite të vazhdueshme. Njëkohësisht, ky deficit ka qenë më i larti që prej vitit 1993. Të ardhurat nga shërbimet, gjatë këtij viti, u rritën me 23 për qind, ndërsa shpenzimet me 36 për qind. Zërat kryesorë në tregtinë e shërbimeve të Shqipërisë me botën e jashtme janë: shërbimet e udhëtimit, shërbimet e transportit, ato të sigurimit dhe shërbime të tjera. Peshën më të madhe në shërbimet totale si në anën e kredisë, ashtu edhe në atë të debisë, vazhdojnë ta ruajnë shërbimet e udhëtimeve. Këto të fundit karakterizohen nga një rritje më e shpejtë e shpenzimeve në krahasim më të ardhurat. Shërbimet e transportit dhe ato të sigurimit për pjesën e lidhur me qarkullimin e mallrave, ecin paralelisht me zhvillimet në tregtinë e mallrave. Kategoria “shërbime të tjera” ka regjistruar një deficit prej 10 milionë dollarësh, duke qenë larg suficitit prej 30 milionë dollarësh të regjistruar në fund të vitit 2002. Deficiti i sivjetshëm është shkaktuar kryesisht si pasojë e rritjes së shpenzimeve për asistencën teknike, që vendi ynë ka vazhduar të sigurojë nga jashtë. Këto shpenzime gjatë vitit 2003 kanë kapur shifrën 44 milionë dollarë. Një zhvillim pozitiv, po në grupin “shërbime të tjera”, vjen nga shërbimet e komunikacionit. Ky grup shërbimesh, ashtu si edhe gjatë vitit 2002, ka gjeneruar më shumë të ardhura sesa shpenzime për vendin, duke sjellë në llogarinë tonë korente rreth 27 milionë dollarë të ardhura neto. Zhvillimi i vrullshëm që kanë marrë kohët e fundit shërbimet e telekomunikacionit si edhe marrëdhëniet gjithnjë e më të shpeshta me subjektet jorezidente, kërkon zgjerimin e bazës së subjekteve të komunikacionit nga të cilat merret informacion për bilancin e pagesave. Në përfundim të analizës së tregtisë në mallra dhe shërbime, duhet të theksojmë se shkalla e hapjes ekonomike e Shqipërisë¹⁷ vlerësohet në nivelin 61 për qind ose 1 pikë përqindjeje më e vogël se në vitin 2002, dhe lë ende për të dëshiruar në raport me vendet e rajonit.

TË ARDHURAT DHE TRANSFERTAT KORENTE

Llogaria e të ardhurave e ka mbyllur vitin me një bilanc pozitiv prej 170 milionë dollarësh. Hyrjet në këtë llogari kanë qenë dukshëm më të larta se ato të vitit të kaluar, ndërkohë që diferenca në dalje ka qenë mjaft e vogël. Rritje në kahun e të ardhurave (hyrjeve) janë vërejtur në të ardhurat nga kompensimi i punonjësve si edhe në të ardhurat nga investimet. Të ardhurat nga kompensimi i punonjësve, ndikohen nga vlerësimi i bërë për prurjet nga emigrantët, duke qenë se një pjesë e këtyre të fundit, klasifikohen si të ardhura nga puna e punonjësve sezonalë dhe kufitarë. Rrjedhimisht, rritja në transfertat korente private është pasqyruar edhe në rritjen e të ardhurave nga puna ose nga kompensimi i punonjësve. Këto të fundit gjatë vitit 2003 kanë kapur nivelin 110 milionë dollarë duke qenë 22 milionë dollarë më të larta se të ardhurat gjatë vitit 2002. Investimet e rezidentëve jashtë në formën e investimeve të portofolit, investimit të rezervave dhe investime të tjera, kanë siguruar të ardhura nga interesat prej 84 milionë dollarësh.

Transfertat korente, ashtu si edhe gjatë viteve të kaluara, kanë marrë formë prej prurjeve nga emigrantët. Këto të fundit përfaqësojnë burimin kryesor të financimit të deficitit në tregti mallrash dhe shërbimesh, dhe gjatë vitit 2003 janë vlerësuar në nivelin 778 milionë dollarë duke qenë 23 për qind më të larta se ato të vitit të kaluar. Megjithatë, duke pasur parasysh monedhat në të cilat kryhen këto transfertat, mund të themi se edhe në këtë zë, efekti i kursit të këmbimit është i ndjeshëm.

II.6.3 LLOGARIA KAPITALE DHE FINANCIARE


Deficiti korent u financua në masën 88 për qind nga flukset neto hyrëse të kapitaleve, të cilat në fund të vitit, regjistruan rreth 360 milionë dollarë amerikanë. Pas kësaj shifre pozitive,

¹⁷ E llogaritur si raport i vëllimit tregtar në mallra dhe shërbime ndaj PBB-së.

qëndrojnë transfertat kapitale prej 157 milionë dollarësh - 29 për qind më të mëdha se ato të vitit paraardhës - dhe bilanci pozitiv i llogarisë financiare prej 202 milionë dollarësh. Ky import kapitalesh, i realizuar kryesisht prej thithjes së investimeve të huaja direkte dhe prej lëvrimeve të kredive afatgjata dhe të zbutura nga jashtë, ka shkaktuar rritjen e detyrimeve financiare të Shqipërisë ndaj pjesës tjetër të botës me 328 milionë dollarë. Kjo rritje vlerësohet 22 për qind më e lartë se ajo e një viti më parë.

Rritja e detyrimeve financiare për vitin 2003 paraqitet kryesisht në formën e investimeve të huaja direkte, të huamarrjes së linjave të kredive të huaja, të depozitave të sistemit bankar në bankat dhe në institucionet jorezidente, si dhe në formën e kredive tregtare.

Grafik II.14. Struktura e bilancit të pagesave.



Investimet e huaja direkte për vitin 2003 vlerësohen në nivelin 178 milionë dollarë ose 32 për qind më të larta se ato të vitit 2002. Këto flukse kapitali janë shndërruar në një faktor dominues në rritjen e detyrimeve financiare dhe në zhvillimet e transaksioneve kapitale e financiare, duke zënë rreth 54 për qind të bilancit pozitiv të llogarisë financiare.

Faktor tjetër i rëndësishëm në rritjen e detyrimeve financiare gjatë vitit 2003 kanë qenë lëvrimet e kredive afatgjata dhe të atyre të buta nga jashtë, të cilat kanë shtuar borxhin e jashtëm të Shqipërisë me 155.5 milionë dollarë. Në këtë borxh përfshihet dhe përdorimi i huave dhe kredive në FMN prej 11 milionë dollarësh. Pjesa dërrmuese e këtyre huave është përdorur nga Qeveria Shqiptare. Financuesi kryesor i qeverisë, ashtu sikurse edhe më parë, mbetet Banka Botërore nëpërmjet Agjencisë Ndërkombëtare të Zhvillimit (IDA). Shërbimet e borxhit të jashtëm në formën e pagesave të principalit, gjatë vitit regjistruan rreth 43.6 milionë dollarë.

Detyrimet në formën e depozitave të jorezidentëve në sistemin tonë bankar për vitin 2003 janë rritur me 19 milionë dollarë, rritje kjo pothuajse 2.2 herë më e madhe se ajo e vitit të kaluar. Kjo rritje është pasojë edhe e një efekti të theksuar të kursit të këmbimit (12 milionë dollarë) duke patur parasysh që 80 për qind e këtyre depozitave është në euro, 15 për qind në usd dhe 5 për qind në monedha të tjera. Detyrimet në formën e kredisë tregtare gjatë vitit 2003 u rritën me 11 milionë dollarë ose 64 për qind më shumë se në vitin paraardhës. Kjo rritje është reflektuar edhe në rritjen e importit të mallrave për këtë periudhë.

Pretendimet financiare të Shqipërisë ndaj pjesës tjetër të botës, gjatë vitit 2003, janë rritur me 126 milionë dollarë amerikanë ose rreth dy herë më shumë se gjatë vitit 2002. Peshën

më të madhe në këtë rritje e mban rritja në mjetet valutore në *cash*. Ndryshe nga viti i kaluar kur ato patën rënie, zotërimet në mjete valutore të publikut këtë vit janë rritur me 35 milionë dollarë.


Edhe në këtë pikë, duhet përmendur efekti i kursit të këmbimit, pasi dihet që nga mjetet valutore të zotëruara nga sistemi bankar në vend, vetëm 28 për qind e tyre janë në dollarë, ndërkohë që pjesa tjetër është në euro (66 për qind), stërlina angleze (4 për qind) dhe franga zviceriane (2 për qind).

Në të njëjtën masë si mjetet valutore *cash*, janë rritur gjatë vitit edhe depozitat e sistemit bankar jashtë. Në përbërjen e tyre në fund të vitit 2003, depozitat në dollarë amerikanë zinin 52 për qind dhe ato në euro 46 për qind. Stoku i mjeteve financiare në formën e investimeve të portofolit kapi shumën 142 milionë dollarë, duke shënuar një rritje vjetore prej 26 milionë dollarësh.

II.6.4 REZERVAT

Flukset hyrëse në mjete valutore në formën e kapitaleve financiare (kryesisht disbursimet e kredive të huaja dhe përdorimi i kredive) u reflektuan në rritjen e rezervave valutore të autoritetit monetar me rreth 99 milionë dollarë për vitin 2003. Niveli i rezervave valutore bruto, në fund të vitit, u vlerësua 1025.6 milionë dollarë, i mjaftueshëm për të përballuar 4.7 muaj importe mallrash dhe shërbimesh.

Grafik II.15. Ecuria e rezervës valutore, në muaj importe.



Tabelë II.17. Bilanci i pagesave (në milionë usd).

	1998	1999	2000	2001	2002	2003
Llogaria korente	-65.0	-132.9	-163.1	-217.9	-420.8	-406.7
Eksporti i mallrave	208.0	275.1	255.4	304.6	330.2	447.2
Importi i mallrave	-811.7	-937.9	-1,076.4	-1,331.6	-1,485.4	-1,783.5
Bilanci tregtar	-603.6	-662.8	-821.0	-1,027.0	-1,155.1	-1,336.3
Shërbimet: Kredi	86.6	266.7	448.1	533.5	585.0	719.7
Shërbimet: Debi	-129.3	-165.4	-430.0	-444.2	-590.3	-802.4
Të ardhurat: Kredi	86.1	85.6	115.9	162.5	146.9	194.8
Të ardhurat: Debi	-8.7	-10.3	-9.1	-13.4	-20.6	-24.4
Transferta private pa shpërblim	421.3	188.4	438.6	542.6	575.0	781.7
Transferta shtetërore pa shpërblim	82.6	165.0	94.4	28.1	38.2	60.3
Llogaria kapitale	31.1	67.5	78.2	117.8	121.2	157.0
Llogaria financiare	16.0	36.8	182.5	109.0	206.9	202.0
Investime direkte	45.0	41.2	143.0	207.3	135.0	178.0
Investime portofoli	0.0	0.0	-25.0	-23.4	-36.8	-22.5
Kapitale të tjera*	-29.0	-4.4	64.5	-86.9	103.4	35.3
Gabime dhe harresa neto	69.4	131.3	15.0	136.1	121.3	147.4
Bilanci i përgjithshëm	59.4	123.5	131.9	145.0	28.6	99.6
Rezervat dhe zëra të lidhur me to.						
Mjetet e rezervës	-59.9	-123.6	-131.9	-145.0	-28.6	-99.6
Përdorim huash e kredish nga FMN	7.9	20.9	19.3	12.0	5.3	11.1
			
Për t'u mbajtur në vëmendje						
Ndryshimi total në rezerva	-75.9	-97.4	-130.5	-116.2	-109.9	-175.6
nga të cilat: ndryshim nga kursi i këmbimit	12.6	-26.2	-3.5	1.5	65.0	87.0

*/ nuk përfshihen përdorime huash e kredish nga FMN.
Burimi: Banka e Shqipërisë.

II.7 REZERVA VALUTORE DHE ADMINISTRIMI I SAJ

Në fund të muajit dhjetor 2003 vlera e rezervave valutore bruto arriti në 1.03 miliardë usd. Gjatë vitit 2003, rezerva valutore u rrit me 186.62 milionë dollarë ose rreth 22 për qind. Ndër faktorët që kanë ndikuar në rritjen e rezervës bruto përmendim hyrjet nga:

- lëvrimi i huave të dhëna nga Fondi Monetar Ndërkombëtar, nga IDA dhe nga institucione të tjera financiare ndërkombëtare (68.05 milionë dollarë);
- blerjet e valutës nga bankat e nivelit të dytë dhe nga Ministria e Financave (87.80 milionë dollarë);
- derdhje nga bankat e nivelit të dytë pranë Bankës së Shqipërisë për plotësimin e rezervës së detyruar (28.08 milionë dollarë);
- të ardhurat e siguruara nga investimi i rezervës valutore, të cilat për vitin 2003 llogariten të jenë 1.04 milionë dollarë më të larta krahasuar me nivelin e tyre në vitin paraardhës.

Blerjet e valutës nga bankat e nivelit të dytë janë bërë në përputhje me kuadrin e përgjithshëm të politikës monetare. Këto blerje, krahas atyre të realizuara me Ministrinë e Financave gjatë vitit 2003, përbëjnë zërin kryesor ndër faktorët me ndikim pozitiv në vëllimin e rezervës valutore.

Daljet nga rezerva valutore gjatë vitit 2003 arrijnë në 127.23 milionë dollarë. Ato përbëhen nga transfertat e kryera me urdhër të Ministrisë së Financave dhe të bankave të nivelit të dytë (83.65 milionë dollarë) si dhe nga pagesat e borxhit të jashtëm për Qeverinë Shqiptare (43.57 milionë dollarë).

Mbiçmimi me rreth 20 për qind i euros në raport me usd gjatë vitit 2003, ka ndikuar në rritjen e vlerës së rezervës valutore bruto me rreth 87 milionë usd.

Në muajin korrik 2003, pas rishikimit të përvitshëm, është miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë rregullorja "Mbi politikën dhe mënyrën e administrimit të rezervës valutore". Kjo rregullore parashikon një strategji të re për investimin e rezervës valutore dhe një riorganizim të portofoleve ekzistuese të investimit. Rishikimi periodik i këtij dokumenti synon krijimin e një shkalle më të lartë fleksibiliteti gjatë administrimit të rezervës valutore, nëpërmjet shtimit të alternativave të investimit. Ndryshimet në këtë rregullore, lidhen edhe me strategjinë e investimit dhe me ristrukturimin e portofoleve sipas praktikave dhe përvojës së bankave qendrore në vendet e tjera. Krahas një funksionimi gjithmonë e më aktiv të strukturave të kontrollit dhe mbikëqyrjes së rrezikut, këto ndryshime do të sjellin një përmirësim në cilësinë e procesit të administrimit të rezervës në drejtim të plotësimit të objektivave të përcaktuar, do të rrisin sigurinë, do të përmirësojnë likuiditetin dhe rezultatet e investimit.

KAPITULLI III. ZHVILLIMET MONETARE DHE TREGJET

III.1 PROGRAMI MONETAR DHE OBJEKTIVAT SASIORË

Politika monetare e Bankës së Shqipërisë është orientuar drejt realizimit të objektivit të inflacionit. Në përputhje me këtë politikë, Banka e Shqipërisë synon administrimin e kushteve monetare në ekonomi në funksion të përmbushjes së objektivit të inflacionit në një horizont afatmesëm. Parashikimet e zhvillimeve monetare përmbledhen në kornizën e programit monetar për një afat kohor prej një viti. Në këtë këndvështrim, programi monetar përcakton drejtimin në të cilin duhet të lëvizin treguesit monetarë për të përmbushur objektivin kryesor të Bankës së Shqipërisë. Gjithashtu, ai është edhe një instrument kontrolli për të vlerësuar ecurinë aktuale të treguesve monetarë dhe për të programuar ndërhyrjet e nevojshme.

Në hartimin e programit monetar për vitin 2003 u mbajtën parasysh ndryshimet e shpejta të raporteve të treguesve monetarë, pas tërheqjeve të depozitave në muajt mars-prill 2002. Këto ndryshime kanë konsistuar kryesisht në uljen e raportit të parasë jashtë bankave ndaj ofertës monetare dhe në zhvendosjen e depozitave drejt maturiteteve më të gjata. Gjithashtu, viti 2003 u karakterizua nga një diferencë e ndjeshme e normave të interesit në lekë dhe në valutë, një faktor ky i cili ka ndikuar në mbiçmimin e lekut.

Banka e Shqipërisë në muajin tetor, rishikoi programin monetar për vitin 2003 për ta përshtatur më mirë atë me zhvillimet makroekonomike në vend. Rritja e kërkesës së ekonomisë për mjete monetare çoi në ndryshimin e parashikimit të rritjes së ofertës monetare në fund të vitit 2003 nga 8.4 për qind në 9.5 për qind. Njëkohësisht, u pakësua parashikimi për raportin e parasë jashtë bankave ndaj ofertës monetare në fund të vitit. Parashikimi i programit monetar për raportin e parasë jashtë bankave ndaj M3 në fund të vitit u ul në 28.3 për qind. Gjithashtu, Banka e Shqipërisë rishikoi projeksionet e saj për kredinë e sistemit bankar ndaj qeverisë dhe përbërjen e rritjes së tepricës së kredisë në lekë dhe valutë.

Tabelë III.1. Krahasimi i agregatëve me programin (në miliardë lekë).

	Program	Aktuale
Paraja jashtë bankave	126.5	125.2
Depozita në lekë	223.5	226.0
Depozita në valutë	97.0	92.2
M1	144.5	142.0
M2	349.9	351.2
M3	446.9	443.4

Treguesit monetarë gjatë vitit 2003 kanë ecur sipas parashikimeve të programit. Ndryshimet midis vlerave aktuale dhe atyre të parashikuara në programin monetar janë minimale. Ndër to si më kryesorët mund të përmendim:

- *Rritja vjetore e ofertës monetare në fund të vitit 2003 rezultoi 8.7 për qind nga 9.5 për qind që ishte parashikuar në program.*

Rritja vjetore e ofertës monetare nën parashikimin e programit monetar është rezultat i mbiçmimit të lekut gjatë vitit 2003. Ky mbiçmim ka ndikuar në një vlerë më të ulët në lekë të depozitave në valutë në sistemin bankar. Ritmi i rritjes vjetore të depozitave në valutë rezultoi 6.6 për qind, nga 12.1 për qind i parashikuar. Efekti i kursit ka ulur me 13.4 miliardë lekë vlerën e depozitave në valutë.

- *Niveli i parasë jashtë bankave në fund të muajit dhjetor rezultoi lehtësisht më i ulët se parashikimi, duke bërë që niveli i depozitave në lekë të ishte mbi nivelin e parashikuar.*

Si rezultat i kthimit të parasë jashtë bankave në sistem, ecuria e likuiditetit ka qenë sipas parashikimeve ndërsa baza monetare dhe agregati M1 rezultuan nën nivelin e parashikuar të programit.

Objektivat sasiorë të Bankës së Shqipërisë janë përmbushur në vazhdimësi gjatë vitit 2003.


Tabelë III.2. Realizimi i objektivave sasiorë të Bankës së Shqipërisë.

	Mars'03	Qershor '03	Shtator '03	Dhjetor '03
Realizimi i objektivit të rezervës ndërkombëtare neto (milionë dollarë)				
Objektivi	560.6	582.2	576.2	583.2
Aktuale	596.2	607.3	614.3	673.9
Diferenca	35.6	25.2	38.2	90.7
Realizimi i objektivit të mjeteve të brendshme neto (miliardë lekë)				
Objektivi	97.1	98.1	89.1	93.1
Aktuale	76.5	68.8	73.3	68.5
Diferenca	-20.7	-29.4	-15.9	-24.6
Realizimi i objektivit të kredisë së brendshme neto për qeverinë (miliardë lekë)				
Objektivi	266.8	267.7	277.8	282.8
Aktuale	266.3	268.9	276.9	282.8
Diferenca	-0.5	1.2	-0.9	0.0

III.2 OFERTA MONETARE DHE PËRBËRËSIT E SAJ

Gjatë vitit 2003, ritmi vjetor i ndryshimit të ofertës monetare ka qenë vazhdimisht në rritje, duke u stabilizuar në nivele të qëndrueshme në muajt e fundit të vitit. Banka e Shqipërisë, nëpërmjet një politike monetare lehtësuese, ka ndikuar në rikthimin e ritmeve të rritjes së ofertës monetare më afër niveleve historike. Këto nivele sigurojnë një furnizim normal të ekonomisë me para.

Grafik III.1. Ecuria e ritmit vjetor të ofertës monetare.




III.2.1 ZHVILLIMET NË STRUKTURËN E OFERTËS MONETARE

Nga pikëpamja e likuiditetit, elementet përbërëse të ofertës monetare kanë manifestuar një ecuri të ndryshme, e cila ka reflektuar kryesisht rikthimin në ekuilibër të strukturës së deformuar kohore që la pas kriza e depozitave e vitit 2002.


Agregati monetar më likuid, M1, ka shënuar vazhdimisht norma negative të ndryshimit vjetor gjatë vitit 2003. Në fund të vitit, ai ka rezultuar me një normë negative vjetore prej -5.2 për qind. Një ecuri e tillë, është përcaktuar nga zhvillimet në parane jashtë bankave, e cila është edhe përbërësja kryesore e tij. Gjatë vitit 2003, raporti i parasë jashtë bankave ndaj ofertës monetare ka pësuar një rënie prej 3.5 pikësh përqindjeje, duke shënuar kështu nivelin e tij më të ulët në katër vitet e fundit.

Grafik III.2. Struktura kohore e ofertës monetare (raporti M1/M3).



Paraja e kthyer në sistem ka lëvizur në drejtim të depozitave me afat në lekë. Në fund të vitit, norma vjetore e rritjes së tyre arriti në 19.1 për qind, duke qenë ndjeshëm mbi normat vjetore të viteve të kaluara. Kjo ka bërë që depozitat me afat në lekë të jenë treguesi me kontributin më të madh në rritjen e ofertës monetare.

Grafik III.3. Ecuria e strukturës kohore të ofertës monetare dhe normat reale të interesit.



Një faktor që ka ndikuar pozitivisht në zhvendosjen e ofertës monetare drejt mjeteve më pak likuide, ka qenë edhe ruajtja në nivele relativisht të larta e normave reale të interesit për depozitat në lekë. Ecuria e këtyre normave është ndikuar nga tendenca në rënie e normës mesatare të inflacionit përgjatë vitit 2003.


Box III.1. Faktorët që ndikuan sjelljen e pazakontë të parasë jashtë bankave gjatë vitit 2003.

Paraja jashtë bankave ka paraqitur një sjellje të ndryshme gjatë vitit 2003 krahasuar me vitet e mëparshme. Ajo është ulur me rreth 5.6 miliardë lekë ose 4.3 për qind gjatë vitit 2003. Kjo ecuri "jonormale" e saj shpjegohet me rivendosjen e ekuilibrave të agregatëve monetarë, mbas tërheqjes masive të depozitave në periudhën mars-prill të vitit 2002.

Tërheqja e depozitave bëri që raporti i parasë jashtë bankave ndaj ofertës monetare të shënonte një rritje të ndjeshme. Ky raport reflekton një ekulibër të rëndësishëm monetar: atë të strukturës së portofolit të mjeteve financiare të ekonomisë shqiptare. Ndryshimet e këtij raporti duhet të jenë graduale. Ato duhet të reflektojnë një realitet të ri, në formën e inovacioneve financiare apo të rritjes së besimit të publikut ndaj sistemit bankar. Rritja e raportit nën nivelet historike ishte rrjedhojë e lëkundjes së besimit të publikut ndaj sistemit, për arsye spekulative. Për këtë arsye, gjysma e dytë e vitit 2002 dhe viti 2003 u karakterizuan nga kthimi i parasë në sistem. Ky kthim u shoqërua me uljen e nivelit absolut të parasë jashtë bankave dhe të raportit të saj ndaj ofertës monetare.

Pas kësaj shtate, në fund të vitit 2003 raporti i parasë jashtë bankave ndaj ofertës së parasë ishte 27.9 për qind, duke qëndruar pranë nivelit të mesatares historike të këtyre katër viteve të fundit (29.4 për qind). Ky raport është rreth 2.3 pikë përqindjeje më i ulët, krahasuar me të njëjtën periudhë para krizës.

Grafik 1: Raporti i parasë jashtë bankave ndaj M3 dhe rritja vjetore e saj.



Për vitin 2004 pritet që ecuria e parasë jashtë bankave të shënojë rritje. Ky është një fenomen normal për një ekonomi të stabilizuar. Rritja e ofertës monetare shfaqet në të gjithë komponentët përbërës të saj, por ajo që është e rëndësishme dhe në fokusin e çdo banke qendrore, është ruajtja e strukturës së likuiditetit dhe e strukturës valutore të ofertës monetare. Në këtë këndvështrim, viti 2004 parashikohet të ruajë relativisht të njëjtin raport të parasë jashtë bankave ndaj M3, duke kontribuar në kontrollin e presioneve inflacioniste.


Gjithsesi, në të ardhmen, pjesëmarrja më aktive e bankave në tregun bankar, duke prezantuar shërbime të reja (si për shembull përhapja gjerësisht e ATM-ve), përmirësimi i situatës së përgjithshme makroekonomike, forcimi i disiplinës fiskale dhe lufta më efektive ndaj evazionit fiskal do të bëjnë që tendenca e këtij raporti të jetë në rënie.

III.2.2 ZHVILLIMET NË STRUKTURËN VALUTORE

Ndryshe nga vitet e kaluara, kontributi i përbërësit valutor në rritjen e ofertës monetare ka rezultuar në nivele të ulëta. Gjatë vitit 2003, norma vjetore e rritjes së depozitave në valutë është luhatur rreth vlerës 12 për qind, nga 18 për qind që vlerësohet të jetë mesatarja e saj në pesë vitet e fundit. Mbiçmimi i lekut ndaj valutave gjatë vitit 2003 ka ndikuar në uljen e ritmit të rritjes së depozitave në valutë. Duke përjashtuar nga analiza efektin e kursit të këmbimit, ritmi i rritjes së depozitave në valutë gjatë vitit 2003 do të ishte 21.9 për qind.

Struktura e ofertës monetare ka vazhduar të zhvendoset drejt valutës, edhe gjatë vitit 2003. Por diferenca e normave të interesit midis lekut dhe valutës si dhe mbiçmimi i lekut ka bërë që depozitat me afat në lekë të jenë më të preferuara për individët. Riorganizimi i portofoleve ka ndikuar në forcimin e lekut në tregun valutor gjatë vitit 2003. Këta faktorë kanë ndikuar në zbutjen e zhvendosjes së mjeteve monetare drejt valutës gjatë gjysmës së dytë të vitit (grafiku III.4).


Grafik III.4. Ecuria e raportit të depozitave në valutë ndaj M3.



Për të ardhmen pritet një ecuri më e balancuar e strukturës valutore të ofertës monetare. Rritja e pritshme e kreditimit në lekë si pasojë e angazhimit të Bankës së Kursimeve në këtë proces, do të ndikojë në rritjen e peshës së lekut në ofertën monetare.

Nivelet e ulëta të normave të interesit të depozitave në usd dhe në euro nuk kanë qenë në nivele të mjaftueshme për t'i nxitur individët të vendosin kursimet e tyre në depozita bankare me afat. Një konkluzion i tillë mund të nxirret edhe nga grafiku i mëposhtëm, ku vihet re qartë ndërprerja e tendencës rritëse të raportit të depozitave me afat në valutë kundrejt depozitave në valutë gjithsej.

Grafik III.5. Ecuria e raportit të depozitave me afat në valutë ndaj depozitave totale në valutë dhe e normave të interesit bazë në usd dhe në euro.



Box III.2. Vrojtimi mbi aktivitetin depozitues dhe kreditues të bankave të nivelit të dytë gjatë vitit 2003.

Gjatë vitit 2003, Banka e Shqipërisë organizoi dy vrojtime në vazhden e përpjekjeve për të qenë më afër opinionit të specialistëve të bankave të nivelit të dytë mbi zhvillimet kryesore në aktivitetin depozitues dhe kreditues. Pjesë e të vrojtuarve ishin specialistë nga të gjitha bankat e nivelit të dytë (rreth 100 të tillë) në të gjitha rrethet ku këto banka ushtrojnë aktivitetin e tyre. Niveli i përgjigshmërisë në këto vrojtime ishte 95 për qind.

Aktiviteti depozitues:

Nga vrojtimet e zhvilluara gjatë vitit 2003 për aktivitetin depozitues të bankave të nivelit të dytë doli në pah se bankat e konsiderojnë në përmirësim aktivitetin depozitues nga gjashtëmujori në gjashtëmujor. Si faktorë kryesorë që kanë ndikuar pozitivisht në aktivitetin depozitues vlerësohen të jenë: rritja e besimit të publikut ndaj bankës, cilësia e lartë e shërbimit si dhe niveli i normës së interesit.

Diferenca e normave të interesit midis depozitave në lekë dhe në valutë mendohet të ketë favorizuar rritjen e depozitave në lekë ndërsa ka frenuar ritmet e rritjes së atyre në valutë përgjatë vitit 2003. Politika lehtësuese e Bankës së Shqipërisë, gjatë vitit 2003, ka ndikuar në uljen e normave të interesit të depozitave në lekë. Specialistët e bankave, kanë vlerësuar që politika e Bankës së Shqipërisë ka qenë e efektshme në rregullimin e deformimeve dhe në rritjen e eficiencës së sistemit bankar.

Në përgjithësi, bankierët janë shprehur optimistë për rritjen e mëtejshme të depozitave gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2004. Privatizimi i Bankës së Kursimeve pritet të rrisë konkurrencën në tregun bankar.

Aktiviteti kreditues:

Nga vrojtimi për aktivitetin kreditues të bankave në vitin 2003 u vu re se preferenca për kreditimin e biznesit të mesëm vazhdon të jetë më e lartë se sa për bizneset e tjera. Gjithësesi, në pjesën e parë të vitit u vu re një tendencë e rritjes së preferencës për biznesin e madh. Niveli mesatar i realizimit të planit, sipas vlerësimit të vetë bankave, ka qëndruar në të njëjtat nivele për gjithë vitin, rreth 92 për qind. Nga specialistët gjykohet se rritja e kërkesës për kredi nga ana e biznesit si dhe tejkalimi i planit për grumbullimin e depozitave kanë krijuar premisa për realizimin dhe tejkalimin e planit të kredidhënies.

Por, nga ana tjetër probleme të tilla si: kufizimet ligjore për bizneset, vështirësitë e bizneseve për të siguruar kolateralin e kërkuar si dhe mosfunksionimi i plotë i zyrave të hipotekës kanë përbërë pengesa për realizimin e planit.

Aktiviteti kreditues pritet të shënojë rritje dhe në të ardhmen dhe në veçanti te kredia për bizneset, ku më të preferuarit do të jenë bizneset e sektorit të tregtisë. Normat e larta të interesit si dhe mungesa e projekteve të vlefshme për kredinë në lekë janë arsyt kryesore që mbështesin kreditimin në valutë. Privatizimi i Bankës së Kursimeve mendohet të ndryshojë këtë preferencë në një periudhë afatmesme. Për të dyja rastet pritet që normat e interesit në lekë dhe në valutë të ulen. Ky fakt mbështetet në uljen e normës bazë të interesit nga banka qendrore, në rritjen e besimit në institucionet financiare, si dhe në rritjen e konkurrencës së sistemit bankar.

III.3 KËRKESA PËR PARA


III.3.1 MJETET VALUTORE NETO TË SISTEMIT BANKAR

Pozicioni valutor i sistemit bankar ka njohur përmirësime të dukshme gjatë vitit 2003. Mjetet valutore neto të sistemit janë rritur me rreth 314 milionë usd gjatë vitit të shkuar. Në terma vjetorë, rritja e këtyre mjeteve gjatë vitit 2003 është 26 për qind nga 3.2 për qind që ishte një vit më parë.

Rezerva valutore neto e Bankës së Shqipërisë ka dhënë kontributin më të madh në rritjen e mjeteve valutore neto të sistemit bankar, me një rritje prej 211.7 milionë usd. Faktori kryesor që ka ndikuar në këtë rritje është mbiçmimi i euros ndaj dollarit në tregun ndërkombëtar. Ky mbiçmim ka rritur vlerën në dollarë të pjesës së rezervës valutore të investuar në euro. Duke përjashtuar efektin e kursit të këmbimit, rritja e rezervës valutore neto të Bankës së Shqipërisë gjatë vitit 2003 do të ishte 123 milionë usd. Një faktor tjetër që ka ndikuar në rritjen e rezervës valutore janë ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në kahun e blerjes së valutës së huaj. Gjatë vitit 2003 këto blerje kapën shifrën 87.8 milionë usd. Ato kanë qenë të përqëndruara kryesisht në nëntëmujorin e parë të vitit. Rreth 56 për qind e blerjeve ishte me bankat e nivelit të dytë ndërsa pjesa tjetër me Ministrinë e Financave dhe të tjerë.

Bankat e nivelit të dytë kanë patur një normë më të ngadaltë rritjeje të mjeteve valutore neto. Gjatë vitit 2003 kjo normë llogaritet 20.9 për qind ose 102.7 milionë usd. Burimi kryesor i rritjes së mjeteve valutore neto të bankave të nivelit të dytë është rritja e depozitave të tyre në valutë. Por, viti 2003 ka shënuar një rritje të efektivitetit të bankave në kanalizimin e fondeve në valutë në drejtim të kreditimit të ekonomisë.

Grafik III.6. Kredia në valutë dhe depozitat në bankat e huaja si pjesë të depozitave në valutë të sistemit bankar (në përqindje).



Box III.3. Ecuria në vite e rezervës valutore të Bankës së Shqipërisë.

Ka shumë arsye që bankat qendrore mbajnë dhe përdorin rezervën valutore. Në përgjithësi, rezerva valutore mbahet për t'i shërbyer nevojave të tregtisë së jashtme dhe për të ruajtur stabilitetin e monedhës vendase në tregun valutor. Në kushtet e regjimeve të lira të kurseve të këmbimit, siç është edhe rasti i Shqipërisë, mbajtja e nivelit të rezervës valutore nuk përbën një objektiv madhor për bankën qendrore. Në të tilla raste, mbajtja dhe administrimi i saj do të ndihmojë në sheshimin e luhatjeve afatshkurtra në kursin e këmbimit.

Tabelë 1. Rezerva valutore bruto e Bankës së Shqipërisë në vite (milionë usd).

	1995	1996	1997	1998	1999	2000	2001	2002	2003
Rezerva valutore	490.3	547.6	566.7	642.8	520.8	642.5	763.5	852.1	1025.6
-në muaj importe	7.5	6.2	8.5	8.2	5.6	5.1	5.1	4.9	4.7

Përgjithësisht, rezerva valutore e Bankës së Shqipërisë ka ardhur në rritje. Duke përjashtuar vitin 1999, rezerva valutore bruto gjatë periudhës 1995-2003 ka patur një normë mesatare rritjeje prej 13.7 për qind. Në dhjetor të vitit 2003 kjo rezervë arriti nivelin 1.025 miliardë usd. Kjo rritje erdhi kryesisht si rezultat i rritjes së të ardhurave nga investimet e rezervës, i ndërhyrjeve të Bankës së Shqipërisë në tregun valutor, i hyrjeve nga institucione ndërkombëtare për Qeverinë Shqiptare për financim projektesh si edhe nga rritja e vlerës së investimeve në euro të konvertuara në usd si rezultat i mbiçmimit të euros ndaj dollarit.

Gjithashtu, niveli i rezervës valutore në muaj importe, si një tregues i përballueshmërisë së kërkesës për importe, mallrash dhe shërbimesh, në raste të paparashikuara krizash financiare, ka qenë në nivele të kënaqshme.

III.3.2 KREDIA PËR QEVERINË


Financimi i brendshëm i deficitit buxhetor ndaj PBB-së gjatë vitit 2003 shënoi vlerën 2.7 për qind, vlerë kjo më e ulëta e arritur në gjashtë vitet e fundit. Sistemi bankar ka qenë financuesi i brendshëm kryesor i deficitit duke dhënë një kontribut prej më shumë se 90 për qind në këtë financim. Format e financimit të brendshëm të deficitit të përdorura gjatë vitit 2003 janë blerjet e bonove të thesarit dhe blerjet e obligacioneve dyvjeçare.

Tabelë III.3. Financimi i brendshëm i deficitit buxhetor në përqindje të PBB-së.

	1998	1999	2000	2001	2002	2003
Financimi i brendshëm	7.2	5.6	3.2	3.0	3.2	2.7

Gjatë vitit 2003 bankat e nivelit të dytë kanë rritur portofolin e bonove të thesarit me rreth 17.5 miliardë lekë, ndërsa Banka e Shqipërisë ka ulur portofolin e saj të bonove me 4 miliardë lekë. Aktivë në blerjen e bonove të thesarit janë paraqitur edhe individët, me një rritje të portofolit të tyre me 5.4 miliardë lekë ndryshe nga institucionet, të cilat kanë ulur portofolin e tyre në masën 1.7 miliardë lekë.

Grafik III.7. Financimi i brendshëm bruto i deficitit buxhetor gjatë vitit 2003 (miliardë lekë).




Bankat e nivelit të dytë kanë investuar edhe në obligacionet qeveritare. Qeveria ka emetuar rreth 4.2 miliardë obligacione dyvjeçare gjatë vitit 2003, një formë tjetër kjo e financimit të brendshëm të deficitit buxhetor, prezantuar në tetor të një viti më parë.

III.3.3 KREDIA PËR EKONOMINË

Sistemi bankar gjatë vitit 2003 ka shënuar arritje dhe përmirësime të dukshme dhe të vazhdueshme në drejtim të financimit të ekonomisë nëpërmjet kredisë bankare. Gjatë vitit 2003, teprica e kredisë u rrit me 11.9 miliardë lekë duke realizuar 92 për qind të nivelit të parashikuar në programin monetar për këtë vit. Ky kreditim i ekonomisë ka përbërë 37.5 për qind të burimit të rritjes së parasë gjithsej gjatë vitit 2003. Kredia e re lëvruar gjatë vitit 2003 ishte 92.6 miliardë lekë ose 48 për qind më shumë se në vitin 2002. Në mungesë të mbiçmimit të lekut ndaj euros dhe usd gjatë vitit 2003, kjo shifër do të regjistronte 100.1 miliardë lekë. Duke qenë se ekonomia kreditohet më shumë në valutë, rritja e tepricës së kredisë përballet edhe me efektin e kursit të këmbimit. Mbiçmimi i lekut gjatë vitit 2003, ka ndikuar në uljen me 5.3 miliardë lekë të tepricës së kredisë. Duke eliminuar këtë efekt kursi, teprica e kredisë për ekonominë është rritur me 17.2 miliardë lekë, duke tejkaluar me 33 për qind parashikimin e programit monetar.

Grafik III.8. Norma e rritjes vjetore të tepricës së kredisë dhe kredisë së re të lëvruar.



Duke mbajtur inflacionin në kufij të pranueshëm, politika monetare e Bankës së Shqipërisë gjatë vitit 2003 ka dhënë ndihmën e saj në krijimin e një klime të favorshme në financimin e biznesit privat. Politika monetare lehtësuese e Bankës së Shqipërisë u shoqërua me uljen e normave të interesit të kredive në lekë. Gjithashtu, përmirësimi i likuiditetit të bankave ndikoi në uljen e kostos së ndërmjetësimit të tyre (ulje e spredit kredi-depozita).

Tabelë III.4. Ecuria e disa treguesve kryesorë të kredisë për ekonominë.

	2001	2002	T-1 '03	T-2 '03	T-3 '03	T-4 '03
Kredi e brendshme (në % ndaj M3)	67.5	70.8	71.2	71.4	70.9	71.5
-Kredi për qeverinë (në % ndaj M3)	60.4	61.5	61.6	61.0	60.1	60.2
-Kredi për ekonominë (në % ndaj M3)	7.1	9.3	9.6	10.4	10.8	11.3
Kredi për ekonominë (në % ndaj PBB)	4.7	5.9	5.6	6.0	6.4	6.8
Kredi për ekonominë (në % ndaj aktiveve)	8.9	11.5	11.6	12.5	12.9	13.7
Raporti kredi/depozita (në %)	10.2	13.5	13.5	14.5	14.9	15.6

Teprica e kredisë për ekonominë, në fund të vitit 2003, arriti 50.6 miliardë lekë. Struktura e portofolit të saj shënoi një zhvendosje drejt kredisë afatmesme dhe asaj afatgjatë. Teprica e kredisë afatmesme dhe afatgjatë shënoi 54 për qind të totalit të kredisë në fund të vitit 2003, duke shënuar një rritje prej 8.5 pikësh përqindjeje krahasuar me vitin 2002. Kjo tregon se bankat janë duke u prirur gjithnjë e më shumë drejt financimeve të projekteve afatgjata, me efekte pozitive në ekonomi.

Struktura e portofolit të kredisë sipas monedhave (lekë/valutë) rezultoi në 20 me 80 për qind në fund të muajit dhjetor të vitit 2003, nga 21 me 79 për qind që ishte në fund të vitit 2002.

Tabelë III.5. Ecuria e treguesve të tepricës së kredisë, në përqindje.

	Viti 2001	Viti 2002	T-1	T-2	T-3	T-4
Kredi afatshkurtër	61.3	53.8	53.2	53.4	51.4	45.5
Kredi afatmesme	26.5	30.1	30.4	30.7	30.5	37.0
Kredi afatgjatë	12.2	16.1	16.4	15.9	18.1	17.5
Sektori privat	98.0	99.8	99.8	100.0	100.0	100.0
Sektori shtetëror	2.0	0.2	0.2	0.0	0.00	0.0
Lekë	18.3	21.3	21.5	21.2	19.3	19.6
Valutë	81.7	73.7	78.5	78.8	80.7	80.4
Teprica e kredisë (në mld lekë)	27.9	38.7	40.4	44.5	48.0	50.6

STRUKTURA E TEPRICËS SË KREDISË SIPAS DEGËVE TË EKONOMISË

Sektori i tregtisë vazhdon të mbetet sektori më i preferuar për kreditim nga bankat e nivelit të dytë. Ky sektor vazhdon të zërë pjesën më të madhe në portofolin e kredisë si sistem bankar në fund të vitit 2003. Aktivitetet bujqësore vazhdojnë të mbeten larg preferencave të bankave për kreditim. Gjithësesi, gjatë vitit 2003 ka një përmirësim të lehtë në drejtim të kreditimit të kësaj dege të ekonomisë dhe të industrisë përpunuese. Po ashtu, është rritur kreditimi i individëve për blerje të pasurive të patundshme.

Tabelë III.6. Teprica e kredisë sipas degëve të ekonomisë (në përqindje).

Degët e ekonomisë	Viti	Viti	Viti 2003			
	2001	2002	T I	T II	T III	T IV
1 Bujqësia, gjuetia dhe silvikultura	1.0	0.8	1.1	1.2	1.3	1
2 Peshkimi	0.1	0.2	0.2	0.2	0.2	0
3 Industria nxjerrëse	1.6	0.2	0.2	0.2	0.2	1
4 Industria përpunuese	19.5	17.0	14.9	16.0	17.1	17
5 Prodhimi, shpërndarja e energjisë elektrike e gazit dhe e ujit	3.0	3.3	3.1	2.8	3.1	3
6 Ndërtimi	12.5	8.6	8.1	8.4	9.1	10
7 Tregtia, riparimi i automobilitave dhe artikujve shtëpiakë	41.3	40.4	40.5	38.4	35.9	34
8 Hotele dhe restorante	4.3	6.0	6.3	6.2	6.2	6
9 Transporti dhe telekomunikacioni	4.6	2.4	2.1	1.8	1.8	1
10 Aktivitete financiare	0.1	-	0.0	0.0	0.0	0
11 Pasuritë e patundshme	6.3	9.1	5.6	10.2	12.5	13
12 Shëndeti dhe veprimtaritë sociale	1.2	0.5	0.5	0.5	0.5	0
13 Shërbime kolektive, sociale dhe personale	3.3	4.2	7.8	7.0	8.1	8
14 Të tjera	1.2	7.3	9.5	7.1	6.1	4
Totali	100	100	100	100	100	100

KREDIA E RE GJATË VITIT 2003

Gjatë vitit 2003, sistemi bankar ka akorduar kredi të re në nivel mesatar mujor 7.7 miliardë lekë në muaj, ndërsa muaji dhjetor shënoi shifrën më të lartë të lëvrimit të kredive të reja, 14.4 miliardë lekë. Në strukturën e kredisë së re sipas afateve mbizotëron kredia afatshkurtër (68 për qind) dhe në strukturën sipas monedhave mbizotëron kredia në valutë (67 për qind). Dominimi i kredisë në valutë, si në portofolin e kredisë ashtu edhe në totalin e kredive të reja, është pasojë e diferencës së normave të interesit midis kredive në lekë dhe kredive në valutë. Kjo diferencë vazhdon të favorizojë kreditimin në valutë. Megjithatë, kjo diferencë ka ardhur në rënie, duke rritur atraktivitetin e kredive në lekë.

Për vitin 2003 kredia e re e akorduar ka qenë më tepër e orientuar për qëllime tregtare (56 për qind), për industrinë përpunuese (11 për qind) dhe për blerje të pasurive të patundshme nga individët (8 për qind).

Tabelë III.7. Ecuria e kredisë së re në vite, në miliardë lekë.

	Viti 2001	Viti 2002	Viti 2003	Viti 2003 sipas tremujorëve			
				T-1 2003	T-2 2003	T-3 2003	T-4 2003
Kredi afatshkurtër	27.6	44.7	63.1	11.6	17.5	15.6	18.3
Kredi afatmesme	10.4	13.0	22.2	4.3	5.6	4.2	8.0
Kredi afatgjatë	2.6	4.8	7.4	1.5	1.5	1.8	2.6
Sektori shtetëror	0.5	0.06	0.04	0.05	0.0	0.0	0.0
Sektori privat	40.1	62.5	92.6	17.4	24.6	21.6	28.9
Lekë	10.0	20.8	30.8	7.1	8.0	7.4	8.3
Valutë	30.6	41.8	61.8	10.4	16.6	14.2	20.6
Kredi e re (në mld lekë)	40.6	62.6	92.6	17.5	24.6	21.6	28.9

Box III.4. Përqëndrimi i tregut të huadhënies bankare gjatë vitit 2003.

Sistemi bankar shqiptar është karakterizuar nga rritja e konkurrencës bankare gjatë viteve të fundit. Prania e bankave private dhe shtimi i tyre është shoqëruar me zbehjen e përqëndrimeve monopoliste në tregun bankar shqiptar.

Gjatë vitit 2003, përqëndrimi në tregun e huadhënies po zbehet. Numri i bankave pjesëmarrëse në këtë treg ka ardhur në rritje. Vlerat e indeksit H, i cili mat se sa i përqëndruar është tregu i huadhënies bankare për tregues të ndryshëm, gjatë vitit 2003, kanë tentuar drejt rënies. Kështu, ka një rënie të përqëndrimit të kreditimit në lekë dhe të kreditimit afatgjatë. Kjo është shoqëruar me përfshirjen e një numri më të madh të bankave si në kreditimin në lekë ashtu dhe në terma kohorë afatgjatë.

Tabelë 1. Indeksi i Herfindalit për disa tregues të tepricës së kredisë.

	Totali i kredive	Kredi afatshkurtër	Kredi afatmesme	Kredi afatgjatë	Kredi në lekë	Kredi në valutë	Konkurrencë e pastër (1/nr e bankave)
dhjetor'00	0.23	0.28	0.18	0.44	0.72	0.28	0.08
dhjetor'01	0.21	0.31	0.18	0.21	0.22	0.22	0.08
dhjetor'02	0.17	0.32	0.17	0.15	0.34	0.17	0.08
mars'03	0.17	0.32	0.17	0.13	0.33	0.16	0.08
qershor '03	0.17	0.29	0.19	0.14	0.30	0.16	0.07
shtator 2003	0.15	0.26	0.19	0.13	0.24	0.14	0.07
dhjetor 2003	0.15	0.25	0.17	0.13	0.21	0.14	0.07

Kreditë e reja të lëvruara gjatë tre viteteve të fundit janë shoqëruar me ritme të larta rritjeje. Por, edhe pse numri i bankave ka ardhur në rritje dhe pjesëmarrja e tyre në tregun e huadhënies është përmirësuar, përsëri katër banka janë dominuese në lëvrimin e kredive të reja. Krahasuar me vitin 2002 ka një rënie prej 2 pikë përqindjeje të kredive të reja të lëvruara nga katër bankat më aktive. Gjithashtu, fenomeni i përqëndrimit në treguesin e kredive të reja afatshkurtra dhe të kredive në lekë është shoqëruar me tendenca rënieje, duke e krahasuar me fundin e vitit 2002.


Tabelë 2. Ecuria e indeksit N, në përqindje (pesha e 4 bankave më aktive në akordimin e kredive të reja).

Periudha	Totali i kredive	Kredi afatshkurtër	Kredi afatmesme	Kredi afatgjatë	Kredi në setorin privat	Kredi në lekë	Kredi në valutë
dhjetor'00	83	81	90	51	83	90	81
dhjetor'01	83	83	87	72	84	92	81
dhjetor'02	82	85	75	54	82	94	74
mars '03	81	84	85	60	81	94	72
qershor'03	79	83	75	47	79	94	71
shtator'03	80	84	77	54	80	93	73
dhjetor '03	80	83	79	57	80	93	74

Box III.5. Përqëndrimi i depozitave, viti 2003.


Përqëndrimi i tregut të depozitave edhe gjatë vitit 2003 u shoqërua nga tendenca rënëse në pëgjithësi. Kjo, e shpjeguar si me shtimin e bankave të reja ashtu edhe me zgjerimin e degëve të bankave ekzistuese.

Grafik 1. Indeksi i Herfindalit për totalin e depozitave si sistem bankar.



Ndryshe paraqitet situata në treguesin e depozitave në lekë, përqëndrimi i të cilave vazhdon të mbetet i lartë. Banka e Kursimeve, edhe gjatë vitit 2003, ruajti pozitën dominuese në aktivitetin depozitues në lekë. Tregu i depozitave në valutë nuk paraqet dukuri përqëndrimi por është duke u shndërruar në një treg ku vepron konkurrenca e pastër.

Grafik 2. Indeksi i Herfindalit për depozitat në lekë dhe në valutë.



III.4 ECURIA E KURSIT TË KËMBIMIT GJATË VITIT 2003

Gjatë vitit 2003 në tregun e brendshëm valutor kanë mbizotëruar prirjet mbiçmuese të lekut. Në krahasim me fundin e vitit 2002, në fund të vitit 2003 leku u paraqit i mbiçmuar me rreth 20.85 për qind kundrejt dollarit dhe 3.60 për qind kundrejt monedhës së përbashkët evropiane.

Faktori kryesor në forcimin e lekut kundrejt monedhave të tjera ka qenë ndryshimi i ndjeshëm midis normave të interesit të ofruara nga investimet në monedhën vendase (depozita në lekë dhe bono thesari) kundrejt atyre në valutë, e gjitha kjo në kushtet e një inflacioni të ulët brenda kufijve të synuar nga Banka e Shqipërisë. Rritja e importeve gjatë vitit 2003 ka mbështetur kërkesën për valutë, por oferta e lartë e valutës ka qenë e mjaftueshme për të nxitur mbiçmimin e lekut.

Në dallim nga vitet e tjera, prirjet forcuese të lekut qenë të pranishme edhe gjatë pjesës së parë të vitit, një periudhë që tradicionalisht është karakterizuar nga nënçmim i lekut kundrejt valutave. Njëkohësisht, dobësimi i ndjeshëm i dollarit amerikan në tregjet ndërkombëtare rriti volatilitetin në tregun e brendshëm, duke qenë se dollari amerikan është një monedhë psikologjikisht e rëndësishme në tregun vendas. Banka e Shqipërisë, duke patur parasysh këta faktorë, në përputhje edhe me politikën e saj monetare zbutëse, ka qenë e pranishme në tregun valutor, veçanërisht në gjysmën e parë të vitit. Të gjitha ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë gjatë vitit 2003 kanë qenë në kahun e blerjes, duke synuar zvogëlimin e ofertës së valutës dhe rritjen e asaj të lekut në treg, për të zbutur presionet mbiçmuese të lekut.


Në gjysmën e dytë të vitit, prania e Bankës së Shqipërisë në tregun valutor ka qenë më e ulët. Gjatë kësaj periudhe u vu re një mbiçmim më i fortë i lekut ndaj euros, i shoqëruar me një luhatshmëri më e lartë të raportit euro/lek. Ky mbiçmim ishte kryesisht rrjedhojë e ecurisë pozitive të monedhës së përbashkët evropiane në tregun ndërkombëtar. Në përgjithësi, monedha e përbashkët evropiane është më pak volatile se dollari amerikan, si pasojë e rëndësisë gjithnjë në rritje që ka marrë euro në tregun e brendshëm. Kjo dukuri është e kuptueshme në kushtet kur euro është monedha kryesore e hyrjes së valutës në vend dhe e pagesës në tregtinë ndërkombëtare.

Ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në gjysmën e dytë të vitit qenë të përqëndruara në periudhat kur leku tradicionalisht tenton të mbiçmohet më shumë. Kështu, gjatë muajit gusht u blenë rreth 3.0 milionë usd, ndërkohë që në dhjetor mungesa e agresivitetit të Bankës së Shqipërisë në treg (u blenë rreth 3.3 milionë usd) solli vlerat e të dy valutave kryesore, euro dhe dollar amerikan, në nivelet më të ulëta për vitin 2003. Në fund të vitit, euro tregtohej me 133.6 lekë, ndërsa dollari amerikan me 106.2 lekë.

Tabelë III.8. Ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e brendshëm valutor gjatë vitit 2003 (sipas tremujorëve).

	Total (në mijë USD)	% usd	Kursi mesatar	%euro	Kursi mesatar
T1	28,338	100	129.89	0	-
T2	11,326	49.27	124.17	50.73	140.52
T3	6,596	3.24	121.45	96.76	134.90
T4	3,346	0	-	100	132.45

Grafik III.9. Ecuria e raporteve euro/lek dhe usd/lek gjatë vitit 2003.



III.5 INSTRUMENTET E POLITIKËS MONETARE

Politika monetare e Bankës së Shqipërisë ka patur natyrë lehtësuese gjatë vitit 2003. Trendi rënës i normës bazë të interesit ka qenë në të njëjtin kah me atë të një pjese të mirë të vendeve të rajonit dhe të Eurozonës.

Në pjesën më të madhe të vitit 2003, zbatimi i politikës monetare u krye në kushtet e tepricës së likuiditetit në sistemin bankar. Për këtë arsye, operacionet e Bankës së Shqipërisë kanë patur për qëllim tërheqjen e likuiditetit. Instrumentet monetare të përdorura për zbatimin e saj kanë vijuar të jenë ato indirekte. Operacionet kryesore të përdorura kanë qenë ankandet e repove njëjavore, ankandet e repove njëmujore dhe tremujore dhe shitjet me të drejta të plota të bonove të thesarit.

Këto instrumente janë përdorur në mënyrë fleksibile në varësi me kushtet e tregut të parasë. Ndërkohë, janë bërë edhe përmirësime në bazën rregullatore të tyre si në llogaritjen dhe në remunerimin e rezervës së detyruar dhe me normën e depozitës njëditore të Bankës së Shqipërisë.

Tabelë III.9. Format e përdorura në ankandin e repove njëjavore për vitin 2003.


	R/repo me çmim fiks	Repo me çmim fiks	Repo me çmim fiks	Repo me çmim fiks	Repo me çmim fiks	Repo me shumë çmime
Data e aplikimit	1 janar – 19 mars	20 mars- 1 maj	2 maj – 16 korrik	17 korrik – 5 nentor	6 nëntor – 17 dhjetor	18 dhjetor -30 dhjetor
Norma bazë e interesit	8.5%	8.5%	8%	7.5%	7.0%	.0%

III.5.1 ANKANDET E MARRËVESHJEVE TË RIBLERJES

Në tremujorin e parë të vitit 2003, Banka e Shqipërisë vijoi me operacionet për injektimin e likuiditetit në sistem. Që prej fundvitit 2002, ishte vënë re rikthimi i depozitave në sistem dhe përmirësimi i likuiditetit të bankave. Për këtë arsye u veprua me instrumentin e repove të anasjellta njëjavore me shumë të pakufizuar dhe me çmim fiks. Kjo formë ankandi u përdor deri në muajin mars 2003, duke injektuar mesatarisht 1.6 miliardë lekë likuiditet në javë.

Përmirësimi i qëndrueshëm i gjendjes së likuiditetit të bankave dhe frenimi i tendencës rritëse të *yield*-it të bonove të thesarit bëri që në muajin mars Banka e Shqipërisë të ndryshonte formën e instrumenteve monetare. Deri në fund të vitit, ajo ka ndërhyrë në treg për tërheqjen e likuiditetit me anë të repove.

Grafik III.10. Gjendja e likuiditetit të sistemit bankar gjatë vitit 2003.



Ankandet e repove njëjavore janë organizuar kryesisht të formës me çmim fiks dhe me shumë të pakufizuar. Mesatarisht, vëllimi i tyre ka qenë 3.2 miliardë lekë në javë, krahasuar me 2.3 miliardë lekë që ka qenë vëllimi mesatar i repove të anasjellta njëjavore gjatë vitit 2002.

Në javët e fundit të muajit dhjetor, Banka e Shqipërisë ndryshoi formën e ankandit duke ndërhyrë me marrëveshje riblerjeje me shumë çmime dhe me shumë të shpallur, dhe duke lejuar bankat të përcaktojnë normën e interesit.

III.5.2 INSTRUMENTET STRUKTURORE

Për administrimin e likuiditetit gjatë vitit 2003, Banka e Shqipërisë ka përdorur edhe operacionet strukturore, si: marrëveshjet repo njëmujore dhe tremujore dhe transaksionet e shitjeve me të drejta të plota.

Gjatë vitit 2003 u organizuan 11 ankande reposit njëmujore, në dy prej të cilave nuk pati

pjesëmarrje nga bankat. Ndërhryrjet janë bërë gjatë periudhës mars-korrik dhe më pas në muajin nëntor për shuma që kanë variuar nga 1 deri në 3 miliardë lekë. Ndërkohë, shumat e pranimit nga bankat kanë variuar në kufij më të ngushtë, nga 0.1 deri në 2.4 miliardë lekë.

Ndërhryrje me ankande reposit tremujore ka patur vetëm në një rast, në muajin maj, për një shumë rreth 1 miliard lekë.


Ndërkohë, tërheqje të pakthyeshme të likuiditetit (strukture) janë realizuar nëpërmjet 4 ankandeve të shitjeve me të drejta të plota, përkatësisht në muajt qershor, korrik dhe shtator 2003. Shuma e tërhequr nga Banka e Shqipërisë nëpërmjet këtyre ankandeve në total arriti rreth 4 miliardë lekë.

III.5.3 LEHTËSITË MBËSHTETËSE

Ndryshe nga një vit më parë, bankat janë treguar aktive në përdorimin e *depozitës njëditore*, si pasojë edhe e përmirësimit të gjendjes së tyre të likuiditetit. Vëllimi mesatar i përdorimit të saj ishte 1.1 miliardë, krahasuar me 0.5 miliardë lekë gjatë vitit 2002.

Në muajin dhjetor 2003, Banka e Shqipërisë rriti me 0.5 pikë përqindjeje diferencën e interesit të depozitës njëditore me atë të reposit. Ky ndryshim u bë për të nxitur vëmendjen e bankave në drejtim të administrimit të likuiditeteve në treg. Ndërkohë, korridori i sipërm - diferenca midis interesit të kredisë njëditore me atë të marrëveshjeve repo – ka mbetur i pandryshuar.

Grafik III.11. Normat e interesit të instrumenteve të Bankës së Shqipërisë.



Kredia njëditore është tërhequr shumë rrallë gjatë vitit 2003, ndërkohë që vitin paraardhës ajo u lëvrua gjerësisht si instrument mbështetës për përballimin e mungesës së likuiditetit. Niveli mesatar i saj gjatë vitit 2003 ka qenë rreth 0.03 miliardë lekë, krahasuar me 2.1 miliardë lekë që ishte në vitin 2002. Kredia lombard nuk është përdorur në asnjë rast gjatë vitit 2003.

III.5.4 PËRMIRËSIMET E BËRA GJATË VITIT 2003 NË KUADRIN OPERACIONAL TË BANKËS SË SHQIPËRISË

Viti 2003 shënoi përmirësime të rëndësishme të instrumentit të *rezervës së detyruar*. Përmirësimet e rregullores në muajin mars, bënë që ky instrument për nga struktura dhe funksionimi t'i afrohet mjaft modelit të Bankës Qendrore Evropiane. Këto ndryshime ishin:

- përcaktimi i bazës së llogaritjes së rezervës së detyruar mbështetur në të dhënat e bilanceve mujore të bankave të nivelit të dytë;
- aplikimi i sistemit të mesatarizimit mujor dhe vendosja e mobilizimit të rezervës së detyruar në baza mujore;
- ndryshimi i periudhës së mbajtjes së rezervës së detyruar, duke e bërë të ngjashme me standardet e Bankës Qendrore Evropiane;
- llogaritja e remunerimit të rezervës së detyruar në lekë mbi normën bazë të interesit;
- përafrimi i masave që merren për mosplotësimin e rezervës së detyruar me ato të zbatuara nga Banka Qendrore Evropiane;
- rritja e përqindjes së remunerimit të rezervës së detyruar nga 50 në 70 për qind të normës bazë të interesit në lekë dhe euriborit dhe të liborit; dhe
- rritja e kufirit të përdorimit të saj nga 5 për qind në 20 për qind.

Këto përqindje dhe norma e rezervës së detyruar, do të vazhdojnë të jenë nën vëmendjen e Bankës së Shqipërisë për të vlerësuar nevojën e ndryshimit të tyre. Ato do të përbëjnë sfidën kryesore në drejtim të përafrimit të instrumentit të rezervës së detyruar me modelin e Bankës Qendrore Evropiane.

Gjithashtu, Banka e Shqipërisë ka përmirësuar edhe rregulloren e kolateralit të përdorur gjatë operacioneve të saj. Përmirësimet konsistojnë në mënyrën e vlerësimit të kolateralit me qëllim rritjen e eficiencës së kuadrit operacional të Bankës së Shqipërisë. Masat e përcaktuara synojnë të reduktojnë rrezikun e tregut dhe rrezikun e kreditit që përfshin operacionet kredituese dhe të sanksionojnë marrjen e masave administrative në rastet e mosplotësimit të kolateralit.


III.6 TREGJET FINANCIARE

Në kushtet kur sistemi rezultoi me teprica likuiditeti, huamarrja në *tregun ndërbankar*, Ndonëse e shpeshtë, ka qenë për nevoja afatshkurtra (kryesisht njëditore). Vëllimi mesatar ditor i transaksioneve ka qenë 0.5 miliardë lekë, krahasuar me rreth 1 miliard në vitin 2002.

Në *tregun primar*, kërkesa e qeverisë për mjete monetare është plotësuar kryesisht nga bankat e nivelit të dytë dhe nga individët. Oferta e pjesëmarrësve në tregun primar ka qenë në mjaft raste, më e lartë se shumica e shpallur nga Ministria e Financave, sidomos në gjysmën e dytë të vitit 2003. Kjo ka ndikuar kështu në uljen e vazhdueshme të *yield*-it të bonove të thesarit.

Kërkesa më e lartë nga bankat ka qenë për maturimet më të gjata, ato dymbëdhjetëmujore. Në fakt, gjatë vitit 2003, edhe pesha që kanë zënë bonot e thesarit dymbëdhjetëmujore në totalin e bonove të emetuara nga qeveria është rritur në 31 për qind nga 22 për qind që ishte në vitin 2002.


Grafik III.12. Vëllimi i bonove të thesarit të kërkuara nga qeveria.



Krahas tregtimit të bonove të thesarit në treg primar, qeveria ka emetuar në frekuenca mujore edhe obligacione me afat dyvjeçar, në shuma që varionin nga 300 deri në 500 milionë lekë. Norma e interesit për këto letra me vlerë ka rënë gradualisht përgjatë gjithë vitit. Në fund të dhjetorit 2003 ajo rezultoi në vlerën 10.2 për qind, nga 14.10 në dhjetor 2002.

Në tregun e brendshëm valutor, gjatë vitit 2003, veçanërisht në gjysmën e dytë të tij, leku ka patur tendencë të mbigmohej ndjeshëm kundrejt dollarit amerikan, ndikuar kjo dhe nga zhvillimet në tregjet ndërkombëtare. Banka e Shqipërisë ka ndërhyrë në *tregun valutor* me synim stabilitetin e kursit të këmbimit. Në tremujorin e parë të vitit 2003, ndërhyrjet janë bërë për pakësimin e dollarit në treg, ndërsa në periudhën maj-gusht dhe në muajin dhjetor, ato kanë ndikuar në pakësimin e euros. Në këto raste, luhatjet e lekut kundrejt monedhave të euros dhe usd kanë ardhur si pasojë e prurjeve të emigrantëve në kohë pushimesh.


Grafik III.13. Ecuria e kursit të brendshëm të këmbimit.



III.7 NORMAT E INTERESIT

Normat e interesit në të gjitha tregjet kanë patur një tencencë rënëse gjatë vitit 2003, duke reflektuar politikën monetare të Bankës së Shqipërisë. Në fund të vitit 2003, normat e interesit të transaksioneve njëditore në *tregun ndërbankar* shënuan 3.92 për qind. Kjo normë është pothuajse e përgjysmuar krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Norma e interesit në tregun ndërbankar është ndikuar jo vetëm nga uljet në normën e interesit bazë, por dhe nga ulja e normës së interesit të depozitës njëditore në fillim të dhjetorit.

Grafik III.14. Ecuria e normave të interesit në tregun ndërbankar.




Në fund të vitit 2003, *yield*-i i bonove të thesarit arriti pothuajse në nivelet e parakrizës së likuditetit. Krahasuar me një vit më parë, uljen më të lartë e kanë paraqitur bonot e thesarit me maturitet tremujor, me 3.85 pikë përqindje. *Yield*-i për këtë maturitet pësoi një rënie të theksuar që pas sinjalit të parë lehtësues të dhënë nga banka qendrore, ndërsa për dy maturitetet e tjera ndryshimet kanë qenë të shpërndara njëtrajtësisht nga sinjali në sinjal. Faktor tjetër ndikues në rënien e *yield*-it të bonove të thesarit ka qenë rritja e kërkesës së bankave për të blerë bono, krahasuar me ofertën e qeverisë.

Tabelë III.10. Ndryshimet e normave të interesit të bonove të thesarit.

Bono thesari	Dhjetor 2002	Ndryshimi në pikë përqindje krahasuar me dhjetor 2002			
		Maj 2003 ¹	Korrik 2003	Tetor 2003	Dhjetor 2003
3-mujore	11%	-2.45	-3.4	-3.57	-3.87
6-mujore	12%	-1.52	-2.1	-2.78	-3.25
12-mujore	13%	-2.02	-2.4	-2.62	-3.13

¹ Sinjali nga Banka e Shqipërisë është dhënë në fund të muajit prill 2003.

Grafik III.15. Ecuria e normave të interesit në tregun primar sipas maturiteteve.




Normat e interesit të depozitave dhe të kredive kanë rënë përgjatë gjithë vitit 2003, gjë që është reflektuar edhe në rënien e kostos së ndërmjetësimit të sistemit bankar² nga 7.9 pikë përqindjeje në fund të vitit 2002, në 5.05 pikë përqindjeje në fund të vitit 2003. Kjo diferencë është më e ulëta historike e tij.

Tabelë III.11. Ndryshimet e normave të interesit të depozitave dhe kredive.

Depozita	Dhjetor 2002 (në %)	Ndryshimi në pikë përqindje krahasuar me dhjetor 2002			
		Maj 2003	Korrik 2003	Nëntor 2003	Dhjetor 2003
3-mujore	9.25	-0.45	-1.4	-1.64	-1.63
6-mujore	8.89	-0.59	-1.28	-1.79	-1.82
12-mujore	7.98	-0.97	-1.74	-2.47	-2.49
Kredi					
0- 6 muaj	14.63	-0.89	-1.03	-0.83	-2.82
6 muaj - 1 vit	15.98	-3.82	-4.82	-4.93	-5.46
1- 3 vjet	17.88	2.20	1.16	0.96	2.45
Mbi 3 vjet	17.71	-5.12	-3.05	-3.88	-2.01

Tendenca rënëse e normave nominale të interesit ka ndikuar në rënien e normës reale të interesit. Megjithatë, ajo ka mbetur në nivele pozitive.

Grafik III.16. Interesat realë dhe nominalë të depozitave me afat dymbëdhjetëmujor në lekë.




² Diferencës së normës së interesit të kredive dhe depozitave.

Megjithë luhatjet e vërejtura, mund të themi që në gjysmën e dytë të vitit 2003 interesat realë janë karakterizuar nga stabiliteti i tyre rreth një niveli mesatar prej 4 për qind.

Normat e interesit në valutë gjatë vitit 2003 kanë patur tendencë rënëse, ndikuar nga niveli rënës i interesave në tregjet ndërkombëtare.


Grafik III.17. Normat e interesit për fluksin e ri të depozitave në valutë.



Lehtësimi i politikës monetare në mes të vitit 2003, fillimisht nga Banka Qendrore Evropiane e më pas nga Rezerva Federale, ndikoi në uljen e ndjeshme të interesave të depozitave në valutë. Më pas, normat e interesit janë karakterizuar nga një stabilitet relativ.

Në tregun e kredive në valutë, normat e interesit kanë qenë në përgjithësi stabël. Në gjysmën e dytë të vitit, ato janë luhatur rreth nivelit 7 për qind.

Grafik III.18. Normat e interesit për kredinë e dhënë në valutë.



Në këtë treg vërehen më tepër luhatje të normës së interesit sesa tek depozitat në valutë. Këtu, ndikim ka edhe ndryshimi i strukturës së dhënies së kredisë nga njëri muaj në tjetrin.

Tabelë III.12. Normat e interesit mesatar të ponderuar të kredive për fundin e vitit.

	dhjetor-01	dhjetor-02	dhjetor-03
int. mes. i pond. i kredisë në usd	8.36%	7.41%	7.12%
int. mes. i pond. i kredisë në euro	7.26%	7.49%	7.59%

KAPITULLI IV. MBIKËQYRJA BANKARE

IV.1 ECURIA E SISTEMIT BANKAR GJATË VITIT 2003

ECURIA E SISTEMIT BANKAR GJATË VITIT 2003

Tregu bankar pësoi zhvillime të rëndësishme gjatë vitit 2003. Hyrja e një banke të re me kapital vendas si dhe dhënia e lejes paraprake për një tjetër u shoqëruan nga përfundimi i suksesshëm i shitjes së Bankës së Kursimeve. Pas disa tentativash të pasuksesshme në dhjetorin e kaluar Banka e Kursimeve iu shit, në masën 100 për qind, investitorit strategjik Raiffeisen Bank. Pas këtyre ndryshimeve sistemi bankar shqiptar numëron 15 banka gjithsej, detaje të të cilave jepen në tabelën e mëposhtme:

Tabelë IV.1. Tregues për sistemin bankar.

Bankat	Nr.i degëve	Nr. i agjencive	Kapitali paguar / Totali i bilancit (%)	Totali i depozitave / Totali i bilancit (%)	Totali i kredive / Totali i bilancit (%)	Bono thesari në % ndaj sistemit bankar
1. Banka Italo-Shqiptare		3	10.0	84.6	37.7	1.6
2. Banka e Kursimeve	14	83	0.4	94.9	0.3	76.1
3. Banka e Bashkuar e Shqipërisë	2		50.0	51.8	15.5	0.0
4. Banka Dardania			91.6	17.9	0.0	0.0
5. Banka Kombëtare Tregtare	15	1	5.6	91.8	8.5	10.4
6. Banka Tirana	12	2	5.9	86.3	27.1	4.7
7. Banka Ndërkombëtare Tregtare	1		40.0	63.0	44.7	0.2
8. Banka Amerikane e Shqipërisë	4		6.3	87.3	22.3	2.8
9. Banka Procredit	12		5.0	86.8	44.9	1.6
10. Banka Tregtare e Greqisë-Shqipëri			38.6	56.6	57.4	0.3
11. Banka Kombëtare Greke – dega Tiranë		4	15.5	86.6	22.6	0.8
12. Banka Alfa – dega Tiranë	7		5.2	54.7	47.2	1.6
13. Banka e Parë e Investimeve – dega Tiranë			36.8	16.1	1.2	0.0
14. Banka e Kreditit të Shqipërisë			81.1	37.9	0.0	0.0
15. Banka Credins		1	19.5	77.3	31.3	0.0

Gjendja financiare e sistemit bankar në fundin e vitit 2003 vlerësohet e kënaqshme. Sistemi bankar evidenton të ardhura neto pozitive rreth 4.45 miliardë lekë ose 0.6 për qind e PBB-së. Krahasuar me fundvitin 2002, të ardhurat neto të sistemit janë 0,6 miliardë lekë (ose 14,4 për qind) më të larta.

Tabelë IV.2. Të ardhurat, shpenzimet dhe rezultati financiar (në miliardë lekë).

	Dhjetor '99	Dhjetor '00	Dhjetor '01	Dhjetor '02	Dhjetor '03
Totali i të ardhurave	39.1	31.0	29.2	28.0	32.0
Totali i shpenzimeve	37.9	25.7	24.9	24.1	27.6
E ardhura neto (fitimi)	1.2	5.3	4.3	3.9	4.4

E ardhura neto¹ nga aktiviteti kryesor i sistemit bankar rezulton 13.3 miliardë lekë dhe krahasuar me fundvitin 2002 është rritur 2,1 miliardë lekë ose 18.8 për qind. Nga këto të ardhura rreth 84 për qind e përbëjnë të ardhurat neto nga interesat, të cilat vazhdojnë të japin kontributin kryesor në të ardhurën neto, ndërsa pjesa tjetër rrjedh kryesisht nga komisionet dhe veprimtaria valutore.

Gjendja e mirë e sistemit bankar gjen pasqyrim edhe në treguesit e rentabilitetit, të cilët siç vihet re nga tabela e mëposhtme janë në nivele më të mira se ato të viteve të mëparshme.

Tabelë IV.3. Tregues të rentabilitetit, ecuria në vite (në përqindje).

	Dhjetor '99	Dhjetor '00	Dhjetor '01	Dhjetor '02	Dhjetor '03
ROA ²	0.5	2.1	1.5	1.2	1.24
ROE ³	15.7	20.6	21.6	19.2	19.5

Aktivitetet e sistemit bankar janë rritur 34.3 miliardë lekë ose 10.1 për qind në krahasim me fundvitin 2002. Kjo rritje i atribuohet jo vetëm zërit "Veprime me thesarin dhe ndërbankare", por edhe zërit "Kredidhënie" dhe "Investime në letrat me vlerë". Megjithatë, raporti i aktiveve ndaj PBB-së ka pësuar një rënie të lehtë duke manifestuar më së shumti një aktivitet të kurrur të Bankës së Kursimeve në prag të privatizimit të saj.

Tabelë IV.4. Totali i aktiveve, ecuria në vite (në miliardë lekë).

	Dhjetor '99	Dhjetor '00	Dhjetor '01	Dhjetor '02	Dhjetor '03
Totali i aktiveve	249.5	270.8	318.5	339.3	373.6
Në % ndaj PBB	49.2	50.2	53.5	51.6	50.2

Nga ana tjetër, struktura e aktiveve është e diversifikuar në mënyrë më të përshtashme, fakt që evidentohet në reduktimin e përqëndrimit të aktivitetit bankar, prezantuar nëpërmjet vlerave në rënie të indeksit H (tabela në vijim):

Tabelë IV.5. Indeksi H (Herfindahl) i përqëndrimit të aktiveve.

	Dhjetor 2000	Dhjetor 2001	Dhjetor 2002	Dhjetor 2003
Indeksi H	0,44	0,37	0,32	0,30

¹ Të dhëna më të detajuara në lidhje me ecurinë dhe me gjendjen e sistemit bankar jepen në Raportin Vjetor të Mbikëqyrjes që publikohet në formë të veçantë nga ana e Bankës së Shqipërisë.

² Kthyeshmëria nga aktivitetet.

³ Kthyeshmëria nga fondet e veta.

Gjatë vitit 2003 aktiviteti kreditues i bankave të sistemit u rrit me 30.5 për qind në krahasim me fundvitin 2002. Megjithëse, ky aktivitet përbën vetëm 13.5 për qind të totalit të aktiveve të sistemit, nëse përjashtojmë nga llogaritjet Bankën e Kursimeve, kredidhënia llogaritet 27.9 për qind e aktiveve të pjesës së mbetur të sistemit bankar. Ky fakt, është një mbështetje e mirë për zgjerimin e mëtejshëm të kreditimit gjatë vitit 2004, duke konsideruar edhe privatizimin e Bankës së Kursimeve dhe ndikimin e këtij zhvillimi në orientimin e bankës drejt aktivitetit kreditues. Treguesi i cilësisë së kreditimit (raporti i kredive me probleme ndaj tepricës së kredisë) llogaritet 4.6 për qind nga 5.6 për qind në fundvitin 2002. Niveli më i ulët i këtij treguesi evidenton përmirësim të cilësisë së kreditimit.

Tabelë IV.6. Tregues të portofolit të kredive (në përqindje ndaj kredive të klasifikuara).

Treguesi	2000 ⁴	2001	2002	2003
1. Kredi të klasifikuara	100.0	100.0	100.0	100.0
standarde	59.1	88.3	89.8	92.3
në ndjekje	7.4	4.6	4.7	3.1
nënstandarde	3.3	4.0	3.0	1.9
të dyshimta	4.1	1.7	0.7	0.5
të humbura	26.0	1.3	1.9	2.1
2. Mbulimi me provigjone	29.7	3.1	2.9	2.9

Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit për sistemin bankar në fund të vitit 2003, vazhdon të evidentojë një nivel të kënaqshëm prej 28,5 për qind, ndonëse krahasuar me vitin 2002⁶ ky raport shënon rënie. Ndikimin kryesor në rënie e niveleve të këtij treguesi e jep rritja e nivelit të aktiveve të klasifikuara sipas rrezikut me 12,3 për qind ose rreth 7 miliardë lekë, ndërkohë që niveli i kapitalit rregullator njih një rritje modeste prej 1,3 për qind ose 222 milionë lekë.

Tabelë IV.7. Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit në vite (në milionë lekë).

	Dhjetor 2001	Dhjetor 2002	Dhjetor 2003
Kapitali rregullator	16 392	17 525	17 747
Aktivitet e klasifikuara sipas rrezikut	46 424	55 422	62 238
Mjaftueshmëria e kapitalit (në %)	35,3	31,6	28,5

Gjatë vitit 2003 bankat e sistemit evidentuan nivel të kënaqshëm të aktiveve likuide në totalin e aktiveve të tyre (mbi 32 për qind), ndërkohë që edhe të dhënat operative për tregun ndërbankar dhe lehtësitë kredituese të Bankës së Shqipërisë flasin për një sistem me tepricë likuiditeti. Treguesit e likuiditetit në nivele të kënaqshme nuk e ekspozojnë sistemin dhe bankat e tij ndaj rrezikut të likuiditetit.

⁴ Vitet 1999 dhe 2000 përfshijnë kreditë me probleme të Bankës së Kursimeve, të cilat kaluan pranë Agjencisë së Trajtimit të Kredive në fundvitin 2001.

⁵ Kreditë standarde dhe ato në ndjekje klasifikohen si kredi të rregullta, ndërkohë që tre grupet e tjera të kredive trajtohen si kredi me probleme.

⁶ Në fund të vitit 2002 ky tregues evidentohet 31,6 për qind.

IV.2 LICENCIMI DHE KUADRI RREGULLATOR

Viti 2003, regjistroi zhvillime të reja në përmirësimin e rregullave të licencimit të subjekteve banka në Shqipëri nëpërmjet miratimit të dokumentit të "Parimeve të licencimit të bankave". Në këtë dokument, përcaktohen qartë parimet kryesore në procesin e licencimit të bankave dhe në marrjen e vendimeve nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, të cilat shkurtimisht do të listoheshin si: e drejta e barabartë për aplikim, trajtimi i barabartë i aplikimeve, ruajtja e besimit të publikut, mbrojtja e konkurrencës dhe transparencja e procesit të licencimit dhe e marrjes së vendimeve.

Përmirësimet e vazhdueshme të sistemit rregullativ të mbikëqyrjes bankare kanë patur për qëllim përafrimin e tij me rregullat e Bashkimit Evropian, me standardet ndërkombëtare për një mbikëqyrje efektive dhe të kujdesshme si dhe përshtatjen me zhvillimet e sistemit bankar, të legjislacionit dhe të ekonomisë në tërësi në Shqipëri.

IV.2.1 LICENCIMI

Në vitin 2003 aktiviteti licencues i Bankës së Shqipërisë njohu zhvillime të reja të cilat shkurtimisht mund të përmbliidhen si në vijim:

80

- Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë mori vendimin për dhënien e licencës për Bankën "Credins", për të ushtruar veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë. Gjithashtu, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, miratoi dhënien e licencës paraprake "Bankës Popullore sh.a".
- Gjatë këtij viti, Banka e Shqipërisë ka dhënë një leje për hapjen e një dege banke jashtë vendit, kërkuar nga Banka Amerikane e Shqipërisë në funksion të synimit për marrjen e licencës për hapjen e një dege të bankës në Athinë, Greqi. Gjithashtu, për herë të parë gjatë vitit 2003 është dhënë një licencë për hapjen e një zyre përfaqësimi në Tiranë të një banke të huaj, dhe pikërisht të Bankës Popullore Pulieze.
- U shtua numri i subjekteve jobanka me dy subjekte të reja: "Albacredit Sh.p.k" dhe "AK- Invest sh.a.", licencuar për të ushtruar kryesisht veprimtaritë e shërbimit të pagesave dhe arkëtimit; të ndërmjetësimit në transaksionet monetare (duke përfshirë valutat).
- Numri i shoqërive të kursim-kreditit u shtua me 20 shoqëri të reja, të cilat janë anëtare përkatësisht të dy unioneve ekzistuese. Njëkohësisht është revokuar licenca e dy shoqërive të kursim-kreditit, për arsye të parashikuar nga ligji.
- Banka e Shqipërisë ka dhënë miratimin për ndryshim në strukturën e aksionerëve të Bankës Tirana, si dhe ka ndjekur praktikatat e ndryshimit të aksionerit të Bankës Dardania, të Bankës Kombëtare Tregtare dhe të Bankës së Kursimeve, të cilat janë akoma në proces.
- Po ashtu, gjatë vitit 2003 është dhënë miratimi për ndryshime të emrave të disa bankave: Bankës Arabo-Shqiptare Islamike në Banka e Bashkuar e Shqipërisë, Bankës FEFAD në Banka ProCredit (të cilat janë realizuar edhe ligjërisht) si edhe të Bankës Tregtare të Greqisë (Shqipëri) në Banka EMPORIKI (që është akoma në proces).

Pas këtyre zhvillimeve lista e subjekteve të licencuara nga ana e Bankës së Shqipërisë e ndarë sipas viteve jepet si më poshtë:

Tabelë IV.8. Lista e subjekteve të licencuara nga Banka e Shqipërisë.

Nr.	Subjektet	2000	2001	2002	2003
1	Banka dhe degë të bankave të huaja	13	13	14	15
2	Subjekte financiare jobanka	2	4	5	7
3	Zyra të këmbimit valutor	19	38	58	58
4	Shoqëri të kursim-kreditit			113	131
5	Unione të shoqërive të kursim-kreditit			2	2

IV.2.2 RREGULLIMET

Paketa rregullatore e mbikëqyrjes bankare vazhdoi të plotësohet dhe të përmirësohet më tej gjatë vitit 2003. Duke u ndalur shkurtimisht në përmirësimet e bëra do të veçonim:

- Rregullorja **“Për ekspertët kontabël të autorizuar të bankave”**. Ndryshimi i rregullores së mëparshme u diktua nga rekomandimet e vendosura në Planin e Zhvillimit të Mbikëqyrjes. Në këto ndryshime, komitetit të kontrollit i është dhënë një rol më i madh për vlerësimin e ekspertit kontabël të autorizuar.
- Përmirësime në udhëzimin **“Për likuiditetin e bankave”**. Ndryshimet synojnë të krijojnë më shumë fleksibilitet dhe hapësira për bankat për të llogaritur raporte shtesë për administrimin e likuiditetit të bankës, kur e gjykojnë të arsyeshme.
- Ndryshime në rregulloren **“Për licencimin e shoqërive të kursim-kreditit”**. Synimi është për t’i paraprirë tendencës së re të institucioneve të mikrofinancës, për konsolidim ose për transformim nëpërmjet bashkimit.
- Rregullorja **“Për dhënien e licencës për të ushtruar veprimtari financiare nga subjektet jobanka në Republikën e Shqipërisë”**, e cila ka realizuar përmirësime në drejtim të plotësimin të dokumentacionit dhe saktësime për kapitalin e paguar, kur subjekti kërkon të kryejë më shumë se një veprimtari të lejuar, si dhe të përshtatjes me rregulloren **“Për dhënien e licencës për të ushtruar veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë”**.
- Rregullorja **“Për veprimtarinë valutore”**. Rregullorja e re përshtatet më mirë me rekomandimet e Komunitetit Evropian, me detyrimet që rrjedhin nga marrëveshjet ndërkombëtare për liberalizimin e llogarisë së kapitalit si edhe përmirësimin e saktësimin e disa elementeve të tjera, të dala nga zbatimi në praktikë i rregullores së mëparshme. Ndryshimi më thelbësor ka të bëjë me heqjen e kufizimit të miratimit të veprimeve në llogarinë korente dhe të kapitalit nga ana e bankave me miratim të Bankës së Shqipërisë, verifikueshmëria e dokumentacionit nga vetë bankat, si edhe thjeshtime, pa çenuar përmbajtjen, të dokumentacionit që duhet plotësuar në kryerjen e veprimeve.

- Rregullorja **“Për marrëdhëniet e bankës me personat e lidhur me të”**, e cila plotëson kuadrin rregullator të mbikëqyrjes duke përcaktuar më mirë konceptin e personave të lidhur dhe duke normuar dhe mbikëqyrur veprimet e bankës me personat e lidhur.
- Rregullorja **“Për administratorët e bankave”**, e cila saktëson konceptin e administratorëve, cilësitë që ata duhet të plotësojnë dhe marrëdhëniet midis kategorive kryesore të administratorëve.

IV.3 INSPEKTIMET NË VEND

Realizimi i inspektimeve në vend është bërë në bazë të planit të miratuar vjetor duke synuar kryerjen e inspektimeve të plota të të gjitha bankave gjatë vitit, të alternuar me inspektime të pjesshme për probleme të veçanta që do të dilnin. Në vitin 2003 u realizuan 15 inspektime të plota dhe 7 të pjesshme.

Në përgjithësi, gjendja në sistemin bankar, e vlerësuar nga ekzaminimet në vend, paraqitet e mirë. Disa nga gjetjet e dala nga procesi i inspektimit në vend gjatë vitit 2003 mund të përmbliidhen si më poshtë:

- Rritje e ndjeshme e aktiveve në disa banka të veçanta, që tregojnë për një afrim më të madh të klientëve dhe për një politikë më agresive nga ana e bankave. Kjo rritje ka ardhur dhe si rezultat i zgjerimit të bankave me degë apo me agjenci të reja.
- Ndryshime në strukturën e aktiveve të bilancit në disa banka, ku paraqitet në rritje zëri “Kredi për klientët”. Kjo tregon se bankat po fillojnë të dalin nga gjendja vrojtuese dhe pasive, duke u bërë më aktive në drejtimin e aktivitetit të tyre dhe duke ndikuar më drejtpërdrejt në rritjen e ekonomisë së vendit. Ashtu siç mund të pritet, zgjerimi i aktivitetit kreditues është shoqëruar në disa raste edhe me rritje të vlerës absolute të kredive të këqija.
- Në sistemin bankar ka patur një gjendje likuiditeti të mirë, përgjithësisht si rezultat i investimit në zëra likuidë si: vendosje në bankat e tjera, bono thesari të Qeverisë së Shqipërisë apo letra me vlerë të qeverive të tjera të vendeve të Zonës A.
- Përgjithësisht, bankat kanë dalë me rezultat pozitiv dhe me fitim në rritje krahasuar me një vit më parë. Kjo ka ardhur si rezultat i zgjerimit të tyre, i mbulimit të shpenzimeve të hapjes së veprimtarisë dhe i përmirësimit të strukturës së aktivitetit të bilancit me investime në zëra më fitimprurës. Prirja e të ardhurave për shumicën e bankave, paraqitet e qëndrueshme.
- Bankat vazhdojnë të zgjerojnë aktivitetin e tyre nëpërmjet hapjes së degëve apo të agjencive të reja në qytete të ndryshme në jug dhe në veri të vendit, dhe në disa prej tyre vihet re një përpjekje për aplikimin e produkteve të reja bankare si për shembull, tërheqjen e *cash*-it nëpërmjet përdorimit të makinave automatike (ATM), përdorimin e kartës së kreditit etj..

- Shkalla e reagimit nga drejtuesit e bankave të nivelit të dytë ndaj problemeve të ngritura në ekzaminimet e kryera, në përgjithësi ka qenë e pëlqyeshme. Megjithatë ende ka vonesa në:
 - zbatimin e saktë dhe në kohën e duhur të rekomandimeve të Bankës së Shqipërisë;
 - përmirësimin e politikave dhe të procedurave të aktivitetit të bankës;
 - plotësimin e kuadrit rregullativ të aktivitetit të bankës;
 - zbatimin e planbiznesit të bankës.

- Janë konstatuar shkelje të ligjit “Për kontabilitetin”, të ligjit “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit “Për parandalimin e pastrimit të parave” (përfshirë dhe udhëzimet përkatëse të Bankës së Shqipërisë dhe të Ministrisë së Financave).

- Moszbatim i saktë i kuadrit rregullator të hartuar prej Bankës së Shqipërisë. Kështu, në disa raste janë konstatuar:
 - klasifikime të kredive jo në përputhje me rregulloren e Bankës së Shqipërisë “Për administrimin e rrezikut të kredisë”;
 - emërimet administratorësh pa marrë miratimin paraprak të Bankës së Shqipërisë;
 - mungesa të dokumentacionit shoqërues në transfertat e valutore;
 - mangësi në kontrollin e brendshëm etj..

Bankat në mbështetje të kërkesave dhe të rekomandimeve të dhëna në raportet e ekzaminimit (në krahasim me vitin e kaluar) i kanë kushtuar kujdes rregullimit të procesit të punës dhe të përmirësimit të akteve të brendshme të tyre në të gjitha fushat e veçanërisht, në veprimtarinë e investimeve në letrat me vlerë, në atë kredituese, në administrimin e rreziqeve të ndryshme etj..

KAPITULLI V. AKTIVITETE TË TJERA TË BANKËS SË SHQIPËRISË

V.1 SISTEMI I PAGESAVE

Banka e Shqipërisë ka si detyrim ligjor nxitjen dhe mbështetjen e sistemit të pagesave. Për këtë, ajo është e angazhuar si në planin operacional, duke qenë i vetmi institucion pastrimi dhe rregullimi për transaksionet në lekë, ashtu edhe në drejtim të nxitjes së reformave në sistemin e pagesave.

V.1.1 ZHVILLIMET NË SISTEMIN E PAGESAVE

Implementimi i sistemit të ri kontabël ATM (Accounting and Treasury Management) për automatizimin e operacioneve në Bankën e Shqipërisë, i përfunduar në tremujorin e katërt të vitit 2002, mundësoi kalimin në fazën përfundimtare të realizimit të projektit **AIPS (Albanian Interbank Payment System)**, një projekt i rëndësishëm në krijimin e infrastrukturës financiare të vendit. Projekti i implementimit të këtij sistemi u shtri në një periudhë kohore prej 7 muajsh dhe në të u përfshinë intensivisht jo vetëm personeli i Bankës së Shqipërisë, por edhe ai i bankave të nivelit të dytë, përfitueset e drejtpërdrejta të këtij sistemi. Projekti u realizua nën asistencën dhe konsulencën e Bankës Botërore.

Sistemi i ri AIPS është një sistem me funksione standarde të tipit RTGS (Real Time Gross Settlement). Ai shlyen në kohë reale dhe në mënyrë të përvokueshme të gjitha pagesat ndërbankare me vlerë të madhe dhe mundëson monitorimin e likuiditetit dhe administrimin e radhës së pagesave nga ana e pjesëmarrësve.

Banka e Shqipërisë mban jo vetëm rolin e pronarit dhe të operatorit të sistemit, por ajo është gjithashtu një nga përdorueset e tij. Pjesëmarrës në sistemin AIPS janë 12 banka të nivelit të dytë, nga 15 banka të licencuara deri në fund të vitit 2003. Të gjitha bankat e licencuara kanë të drejtën e pjesëmarrjes në AIPS, pas certifikimit që u bëhet nga Banka e Shqipërisë. Tarifat e pjesëmarrjes dhe të shërbimit në AIPS janë ndërtuar sipas parimit të mbulimit të kostove operative; ndërkohë që koston e investimit e përballon plotësisht Banka e Shqipërisë si një kontribut për reformën e sistemit kombëtar të pagesave.

Sistemi AIPS bashkëjeton edhe me sisteme të tjera pagesash siç është ai i kleringut të urdhërpagesave e çeqeve, që ofron Banka e Shqipërisë për klerimin dhe shlyerjen e instruksioneve të pagesave me vlerë të vogël dhe të instrumenteve letër. Nëpërmjet këtij sistemi shlyhen pagesat ndërbankare të iniciuara nga klientët. Banka e Shqipërisë organizon seanca të përditshme të klerimit të këtyre instrumenteve, rezultatet neto të të cilave shlyhen në sistemin AIPS si një grup transaksionesh të lidhura me përparësi maksimale.

Për automatizimin e këtij shërbimi, Banka e Shqipërisë ka në projektet e saj zbatimin e një sistemi të tipit **ACH (Automated Clearing House)**, i cili do të shërbejë për klerimin dhe shlyerjen e pagesave me vlerë të vogël dhe do të jetë i integruar me sistemin AIPS.

V.1.2 INSTRUMENTET E PAGESAVE

Ashtu si dhe vitet e mëparshme vazhdoi dominimi i urdhërpagesës, si instrumenti më i përdorur me 77 për qind të vëllimit të përgjithshëm të pagesave dhe 53 për qind të vlerës totale të pagesave për klientë.

Përdorimi i çekut si instrument pagese përsëri mbeti i kufizuar, duke dëshmuar faktin se ende përdorimi i tij në Shqipëri nuk po gjen veten. Tipi më i përdorur është çeku i garantuar nga banka (çeku bankar).

Gjatë vitit 2003 pati përpjekje nga sistemi bankar për të përmirësuar infrastrukturën e pagesave duke investuar kryesisht në drejtim të përdorimit të mjeteve elektronike të pagesës. Vetëm gjatë vitit 2003 janë instaluar dhe janë në përdorim 12 pajisje të reja ATM, të cilat janë vendosur jo vetëm në Tiranë por edhe në qytete të tjera të Shqipërisë.

Në fund të vitit 2003, në Shqipëri numëroheshin rreth 4300 karta debiti e krediti të përdorshme në Lek, por megjithatë numri i pagesave elektronike përbën vetëm 3 për qind të vëllimit të përgjithshëm të pagesave për klientë.

V.2 INTEGRIMI DHE BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

86

V.2.1 INTEGRIMI

Viti 2003 ishte një vit i veçantë dhe i rëndësishëm për Shqipërinë, në procesin e integritimit Evropian, pasi shënoi çeljen, në fund të muajit janar, të bisedimeve zyrtare për nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit midis Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian. Banka e Shqipërisë ka qenë një anëtare aktive e grupit negociator të Qeverisë Shqiptare, i cili koordinon punën e institucioneve të vendit në procesin e negociimit të marrëveshjes.

Në këtë kuadër, Banka e Shqipërisë ka diskutuar nënë të marrëveshjes që kanë lidhje me:

- krijimin e institucioneve bankare dhe aktivitetet e lejuara financiare që kryejnë këto institucione,
- liberalizimin e lëvizjeve të kapitalit, si kusht i domosdoshëm për integrimin ekonomik me tregun unik evropian,
- problemet e parandalimit të pastrimit të parave.

Një pjesë e rëndësishme e kontributit të Bankës së Shqipërisë ka qenë dhe informimi i Komisionit Evropian në lidhje me: zhvillimet ekonomike në vend, hartimin dhe ndjekjen e politikës monetare në respektim të realizimit të objektivit kryesor të stabilitetit të çmimeve, llojin e politikës monetare dhe kuadrin operacional, sistemin bankar dhe funksionin mbikëqyrës të saj etj..

Nga ana e Bankës së Shqipërisë i është bërë e qartë përfaqësuesve të Bashkimit Evropian se qëllimi i saj strategjik është përafrimi me Bankën Qendrore Evropiane. Ky objektiv madhor ka gjetur pasqyrim dhe në marrëveshjet dypalëshe të Shqipërisë me Republikën e Gjermanisë, një pikë e veçantë e së cilës është asistimi i Bankës së Shqipërisë për përafrimin me Bankën Qendrore Evropiane.

V.2.2 BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

MARRËDHËNIET ME FONDIN MONETAR NDËRKOMBËTAR

Viti 2003 shënoi një ecuri të kënaqshme në drejtim të zbatimit të Nenit IV të Neneve të Marrëveshjes me FMN-në. Në kuadër të konsultimeve për vlerësimin e ecurisë së zbatimit të këtij neni, tre misione rishikuese të FMN-së vizituan Shqipërinë në muajt prill, korrik e tetor. Konsultimet u fokusuan në evidentimin e zhvillimeve monetare dhe të atyre në sektorin real si dhe në parashikimet lidhur me to, në inflacionin e rritjen ekonomike dhe në faktorët që ndikojnë në ta, në gjendjen e sistemit bankar (gjendja e likuiditetit në sistem, rreziqet më domethënëse dhe metodat për matjen e tyre, cilësia e protofolit të kredive si sistem, kreditimi etj.).

Në vijim të shqyrtimit të raporteve të konsultimeve dhe të objektivave të shprehur nga Qeveria Shqiptare në Memorandumin e Politikave Ekonomike dhe Financiare, Bordi Ekzekutiv i Fondit Monetare Ndërkombëtar pasi vlerësoi se *"...ecuria e Shqipërisë gjatë vitit të parë të marrëveshjes trevjeçare të huasë PRGF, me një inflacion të ulët, me një kurs këmbimi të qëndrueshëm dhe efikas dhe me një konsolidim fiskal gradual, konsiderohet e kënaqshme..."*¹ konfirmoi rishikimin e parë dhe të dytë dhe miratoi, përkatësisht në muajt mars e korrik, dy transhe huaje të tjera nga 4,000,000 sdr secili, në kuadrin e marrëveshjes trevjeçare të Huasë për Zbutjen e Varfërisë dhe Rritjen Ekonomike (PRGF) të nënshkruar një vit më parë.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm i marrëdhënieve të Bankës së Shqipërisë me Fondin Monetare Ndërkombëtar është edhe Programi i Asistencës Teknike, i cili ka vijuar gjatë vitit 2003 me dy misione asistence në nivel ekspertësh, përkatësisht në muajt korrik dhe nëntor, si dhe me takime të nivelit të lartë. Asistenca teknike e Fondit për Bankën e Shqipërisë, e cila vlerësohet të jetë efikase, ka ndihmuar në zgjidhjen e mjaft çështjeve të bankingut qendror, të hartimit të politikave monetare dhe të parashikimit të regjimit të inflacionit.

87

MARRËDHËNIET ME GRUPIN E BANKËS BOTËRORE

Bashkëpunimi pozitiv midis Bankës së Shqipërisë dhe Grupit të Bankës Botërore ishte i pranishëm edhe gjatë vitit 2003. Ajo që vlen të theksohet ka të bëjë me faktin se asistenca e Bankës Botërore ishte shumë e vlefshme në mbështetjen financiare që i dha sistemit të ri të pagesave, të pagëzuar me shkurtimin AIPS, ndërkohë që, nga ana tjetër, vazhdoi të këshillonte Bankën e Shqipërisë në lidhje me zbatimin e Planit të Zhvillimit të Mbikëqyrjes. Ajo që përbën interes nga këndvështrimi i Bankës së Shqipërisë ka të bëjë me faktin se angazhimi i Bankës Botërore, për të mbështetur financiarisht projekte të zbatuara nga ana jonë, ka ardhur duke u rritur. Pas zbatimit me sukses të sistemit AIPS, Banka Botërore është shprehur e gatshme të kontribuojë financiarisht në projekte të tjera si ai për *clearing house*, për qendrën e informacionit të kredive etj..

MARRËDHËNIET ME BANKËN EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

Banka e Shqipërisë, në cilësinë e mbikëqyrësit të sistemit bankar dhe të vlerësuesit të pavarur të zhvillimeve ekonomike në Shqipëri, ka bashkëpunuar me BERZH-in duke mbajtur kontakte të rregullta për dërgimin e informacionit; veç kësaj, janë zhvilluar takime të nivelit të lartë me zyrtarë të Bankës, të cilat i kanë shërbyer njohjes më të mirë me kriteret e vlerësimit dhe forcimit të marrëdhënieve. Përfundimi i procesit të privatizimit të Bankës së Kursimeve konsiderohet se do të ndikojë në rritjen e pikëve të klasifikimit.

¹ Njoftimi për shtyp i Departamentit të Marrëdhënieve me Jashtë të FMN-së, Nr. 03/102.

MARRËDHËNIET ME BANKAT QENDRORE DHE ME INSTITUCIONE TË TJERA

Marrëdhëniet e Bankës së Shqipërisë me **bankat qendrore**, në përgjithësi kanë vazhduar me po të njëjtat ritme si edhe gjatë vitit paraardhës, sidomos në drejtim të këmbimit të informacionit e eksperiencave dhe të organizimit të veprimtarive trainuese. Vlejnë të përmenden marrëdhëniet me Bankën Qendrore Evropiane, si dhe me bankat qendrore të Gjermanisë, të Francës, të Çekisë, të cilat kanë qenë të fokusuara kryesisht në asistencën teknike, nëpërmjet kurseve të trainimit afatshkurtra dhe asistencës me dokumentacion. Po në këtë drejtim, një rritje të ndjeshme njohu edhe bashkëpunimi me Bankën Kombëtare të Çekisë dhe me Bankën e Italisë.

Rritje të bashkëpunimit ka pasur edhe me Autoritetin për Banka dhe Pagesa të Kosovës ku përveç vizitave të punës dhe takimeve të nivelit të lartë, për herë të parë Banka e Shqipërisë ka ofruar eksperiencën e saj në fushën e Arshivës dhe të Protokollit, duke realizuar një vizitë pune disaditore në ambientet e saj. Në bisedimet e zhvilluara me Drejtorin Ekzekutiv të Autoritetit Kosovar është rënë dakord që ky bashkëpunim të intensifikohet edhe më shumë duke ndarë eksperiencat më të mira, gjë e cila do të vijojë në vitin 2004 me një program asistence.


V.3 EMISIONI I MONEDHËS

88

V.3.1 ECURIA E MONEDHËS NË QARKULLIM


Viti 2003 u karakterizua nga zhvillime pozitive në fushën e emisionit dhe të administrimit të monedhës shqiptare. Këto zhvillime pozitive janë reflektuar në ecurinë e monedhës në qarkullim, e cila e mbylli vitin 2003 në nivelin 127.7 miliardë lekë ose 5.34 miliardë lekë më pak se viti 2002.

Grafik V.1. Ecuria e parasë në qarkullim (në milionë lekë).




Gjashtëmujori i parë i vitit është karakterizuar nga arkëtime më të mëdha se pagesat, megjithëse me tendencë rënëse. Arkëtimet më të larta janë shënuar në muajin janar, duke u ulur gradualisht deri në muajin qershor. Në gjysmën e dytë të vitit, megjithëse arkëtimet mbetën sërish të larta, ato janë shoqëruar me rritjen e pagesave, si rrjedhojë kryesisht e rritjes së shpenzimeve të buxhetit në mënyrë të moderuar në muajt korrik e gusht dhe e rritjes më të lartë të tyre në muajin dhjetor.

Grafik V.2. Arkëtimet dhe pagesat e sistemit bankar gjatë vitit 2003 (në miliardë lekë).




Lidhur me strukturën e kartëmonedhave dhe të monedhave në qarkullim, përgjithësisht është ruajtur struktura e parashikuar. Bankat e nivelit të dytë janë furnizuar me fonde duke mbajtur parasysh si strukturën e parasë në qarkullim ashtu dhe kërkesën e tyre. Gjatë muajit dhjetor, vlen të përmendet rritja e pranisë në qarkullim të monedhës metalike 100 lekë, duke iu afruar shumë strukturës së parashikuar.

Grafik V.3. Monedha në qarkullim (në milionë copë).



Grafik V.4. Kartëmonedha në qarkullim (në milionë copë).



Përsa i përket përpunimit të fondeve të arkëtuara në arkat e Bankës së Shqipërisë, ai është bërë në përputhje me ruajtjen e autenticitetit të monedhës shqiptare, duke i përzgjedhur kartëmonedhat sipas cilësisë së tyre, për të ndaluar riqarkullimin e kartëmonedhave që nuk janë të përshtatshme për qarkullim (pasi mund të jenë të grisura, të ndotura etj.). Në të njëjtën kohë, i është kushtuar kujdes i veçantë mbajtjes së rezervave monetare, për të plotësuar shpejt dhe në çdo kohë kërkesat e ekonomisë për kartëmonedhë e monedhë.

Gjithashtu, vëmendje i është kushtuar mbrojtjes së kartëmonedhës shqiptare nga falsifikimi. Historikisht, kartëmonedhat e falsifikuara kanë qenë dhe janë të papërfillshme në tërësinë e kartëmonedhave në qarkullim.

V.3.2 NUMIZMATIKA

Banka e Shqipërisë, gjatë vitit 2003, ka zhvilluar më tej aktivitetin e saj në fushën e numizmatikës. Gjatë këtij viti është realizuar shtypja e disa monedhave metalike kryesisht për qëllime numizmatike, por dhe për t'u hedhur në qarkullim. Kështu, u shtyp monedha metalike për qëllime numizmatike me tematikë "90-Vjetori i Shpalljes së Pavarësisë", 50 lekë, pa kurs ligjor.

Monedha përkujtimore "90-vjetori i Shpalljes së Pavarësisë", 100 Lekë, pa kurs ligjor.



Monedha përkujtimore "90-vjetori i Shpalljes së Pavarësisë", 50 Lekë, pa kurs ligjor.



Monedha përkujtimore "Antikiteti Shqiptar", 20 Lekë, pa kurs ligjor.



Gjithashtu, janë shtypur edhe dy monedha të tjera me tematikë "Antikiteti Shqiptar", 20 lekë, pa kurs ligjor dhe 50 lekë, me të njëjtën tematikë, por me kurs ligjor. Për t'u afruar me përvojat më të zhvilluara ndërkombëtare në këtë fushë, për herë të parë në vitin 2003, është synuar që monedhave të shtypura për qëllime numizmatike t'u jepet kurs ligjor gjatë vitit 2004. Monedhë tjetër e shtypur gjatë vitit 2003 për qëllime numizmatike ishte ajo me tematikë "100-Vjetori i vdekjes së Jeronim De Radës, 1903-2003", përkujtimore, pa kurs ligjor, 50 lekë.

Monedha përkujtimore "Antikiteti Shqiptar", 50 Lekë, me kurs ligjor.



Vlen të përmendet fakti, se viti 2003 ka shënuar rritje të interesimit të numizmatëve të huaj e shqiptarë për të blerë e për të koleksionuar kartëmonedha shqiptare, që aktualisht janë në qarkullim.

Monedha përkujtimore "100-vjetori i vdekjes së Jeronim De Radës, 1903-2003", 50 Lekë, pa kurs ligjor.



Për herë të parë gjatë vitit 2003 u bë publikimi i katalogut "Monedhat dhe Kartëmonedhat e Shqipërisë", botim i Bankës së Shqipërisë, i cili mund të quhet si enciklopedia e monedhës dhe e kartëmonedhës shqiptare.

V.4 KONTROLLI I BRENDSHËM GJATË VITIT 2003

Funksioni i kontrollit të brendshëm të Bankës së Shqipërisë ushtrohet në zbatim të kërkesave të nenit 54, të ligjit "Për Bankën e Shqipërisë".

Auditet dhe kontrollat kryera gjatë vitit 2003 kanë vlerësuar punën e kryer nga strukturat e tjera të Bankës së Shqipërisë, bazuar në metodat që përdoren aktualisht edhe në bankat e tjera qendrore. Për këtë qëllim, shërben edhe anëtarësimi në Institutin e Auditorëve të Brendshëm (IIA në SHBA), që u mundësua gjatë vitit 2003.

Gjatë vitit 2003, është realizuar një numër total prej 43 auditesh. Mesatarja mujore e auditeve është 3.6 në muaj. Prej tyre, në zbatim të planit vjetor, janë realizuar 40 kontrolle të funksioneve dhe vetëm 3 janë procedura të veçanta, të realizuara me sugjerim të administratorëve të bankës, që kryesisht kanë të bëjnë me kontrolle të specializuara me temë të veçantë.

Gjatë vitit 2003, në përputhje me rekomandimet e institucioneve ndërkombëtare, janë kryer audite edhe në sektorin e statistikës, për të verifikuar saktësinë e shifrave që i përkasin bilancit të Bankës së Shqipërisë për çdo tremujor. Karakteristikë për këtë vit është edhe rritja e kontrollit të teknologjisë së informacionit nga Departamenti i Kontrollit.

Të gjitha rekomandimet e dhëna, të dala si rezultat i auditeve të ushtruara, kanë pasur për qëllim forcimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në bankë, duke ndikuar në këtë mënyrë në rritjen e rolit parandalues të auditit. Nga kontrollat e ushtruara në vitin 2003, janë konstatuar tre raste me dëm ekonomik dhe janë arkëtuar shumat respektive nga personat përgjegjës.

KAPITULLI VI. PASQYRAT FINANCIARE DHE BUXHETI I BANKËS SË SHQIPËRISË

RAPORTI I AUDITORËVE TË PAVARUR

KËSHILLIT MBIKËQYRËS TË BANKËS SË SHQIPËRISË

Ne kemi audituar bilancin e Bankës së Shqipërisë ("Banka") më 31 dhjetor 2003 dhe 2002, si dhe pasqyrën e të ardhurave dhe të shpenzimeve, pasqyrën e ndryshimeve të kapitalit të vet dhe pasqyrën e fluksit të parasë. Drejtimi i Bankës është përgjegjës për përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare. Përgjegjësia jonë është të japim opinion mbi këto pasqyra bazuar në auditimin tonë.

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të planifikojmë dhe të zbatojmë procedurat e auditimit për të dhënë një siguri të arsyeshme, nëse pasqyrat financiare janë pa gabime materiale. Një audit përfshin ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështetin shifrat dhe informacionet e tjera të pasqyrave financiare. Auditimi, gjithashtu, përfshin vlerësimin e parimeve kontabël të përdorura dhe të parashikimeve kryesore të bëra nga Drejtimi, si dhe jep një opinion të përgjithshëm mbi paraqitjen e pasqyrave financiare. Ne besojmë se auditimi ynë ofron baza të arsyeshme për dhënien e opinionit.

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Bankës më 31 dhjetor 2003 dhe 2002 dhe rezultatet e aktiviteteve të saj, ndryshimet në kapitalin e vet dhe fluksin e parasë për fundin e vitit, në përputhje me politikat kontabël të përshtatura nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, të paraqitura në notën 2 të pasqyrave financiare.

Deloitte & Touche sh.p.k.
Tiranë, Shqipëri
25 mars 2004

BANKA E SHQIPËRISË
BILANCI
PËR FUNDVITET 31 DHJETOR 2003 DHE 31 DHJETOR 2002
(TË GJITHA BALANCAT JANË NË MILIONË LEKË)

	Shënim nr.	Fund viti 31 dhjetor 2003	Fund viti 31 dhjetor 2002
AKTIVET			
Aktive të huaja			
Ari dhe metale të çmuara	3	593	1,182
Depozita tek Fondi Monetar Ndërkombëtar	4	18,056	19,861
Depozita në bankat e huaja	5	10,553	5,450
Letra me vlerë të disponueshme për shitje	6	86,875	95,184
Aktive të tjera të huaja	7	588	652
Totali i aktiveve të huaja		116,665	122,329
Aktive vendase			
Ari dhe metale të çmuara	3	43	40
Kredi tranzite	8	384	7,323
Kredi ndaj bankave vendase		-	3,405
Kredi ndaj qeverisë		-	1,150
Letra me vlerë të disponueshme për shitje	9.1	71,687	74,436
Investime të mbajtura deri në maturim	9.2	1,573	1,449
Aktive të tjera vendase	10	2,635	2,900
Totali i aktiveve vendase		76,322	90,703
Totali i aktiveve		192,987	213,032
DETYRIMET			
Detyrime të huaja			
Detyrime ndaj Fondit Monetar Ndërkombëtar	11	17,478	19,147
Detyrime ndaj institucioneve financiare jovendase	12	1,747	8,775
Totali i detyrimeve të huaja		19,225	27,922
Detyrime vendase			
Para në qarkullim	13	127,774	133,115
Detyrime ndaj bankave vendase	14	33,970	30,697
Detyrime ndaj qeverisë	15	5,464	3,024
Të ardhura për t'u shpërndarë	16	117	151
Detyrime të tjera vendase	17	389	328
Totali i detyrimeve vendase		167,714	167,315
KAPITALI I VET			
Kapitali themeltar		750	750
Rezerva ligjore		3,750	3,750
Rezerva e rivlerësimit	18	(6,330)	5,468
Rezerva të tjera	19	7,878	7,827
Totali i kapitalit të vet		6,048	17,795
Totali i detyrimeve dhe kapitalit i vet		192,987	213,032

Shënimet mbi pasqyrat financiare, nga faqja 99 deri në faqen 122, janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

BANKA E SHQIPËRISË
PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE E SHPENZIMEVE
PËR FUNDVITET 31 DHJETOR 2003 DHE 31 DHJETOR 2002
(TË GJITHA BALANCAT JANË NË MILIONË LEKË)

	Shënim nr.	Viti që përfundon më 31 dhjetor 2003	Viti që përfundon më 31 dhjetor 2002
Veprime me jo rezidentë			
Të ardhura nga interesa dhe komisione		3,515	4,076
Shpenzime interesi dhe komisioni		(1,033)	(814)
Fitime nga rivlerësimi i letrave të huaja me vlerë		963	758
Humbje nga rivlerësimi i letrave të huaja me vlerë		(1,139)	(435)
Totali neto nga veprimet me jo rezidentë, neto		2,306	3,585
Veprime me rezidentë			
Të ardhura nga interesa dhe komisione	20	7,567	7,819
Shpenzime interesi dhe komisioni		(1,353)	(1,015)
Fitime nga rivlerësimi i letrave me vlerë vendase		796	205
Humbje nga rivlerësimi i letrave me vlerë vendase		(765)	(215)
Totali neto nga veprime me rezidentë, neto		6,245	6,794
Të ardhura operative të tjera, neto	21	322	146
Totali neto i të ardhurave operative		8,873	10,525
Shpenzime të tjera operative			
Shpenzime personeli	22	(377)	(304)
Shpenzime amortizimi		(186)	(120)
Shpenzime amortizimi të shtypjes dhe prerjes së parasë		(253)	(202)
Shpenzime të përgjithshme dhe administrative		(204)	(169)
Totali i shpenzimeve të tjera operative		(1,020)	(795)
FITIMI NETO		7,853	9,730

Shënimet mbi pasqyrat financiare, nga faqja 99 deri në faqen 122, janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

BANKA E SHQIPËRISË
PASQYRA E NDRYSHIMEVE TË KAPITALIT TË VET
PËR FUNDVITET 31 DHJETOR 2003 DHE 31 DHJETOR 2002
(TË GJITHA BALANCAT JANË NË MILIONË LEKË)

	Kapitali themeltar	Rezerva ligjore	Rezerva e rivlerësimit	Rezerva të tjera	Fitimi i pashpërndarë	Totali
Gjendja më 31 dhjetor 2001	750	3,750	57	7,588	-	12,145
Fitimi neto i vitit	-	-	-	-	9,730	9,730
Rivlerësimi i valutave të huaja dhe i arit	-	-	5,526	-	-	5,526
Rivlerësimi i bonove të thesarit	-	-	(119)	-	-	(119)
Rimarrja e tepricës nga rivlerësimi i aktiveve fikse	-	-	(28)	-	28	-
Rritja e fondit të pensionit	-	-	-	22	-	22
Rivlerësimi i numizmatikës	-	-	32	-	-	32
Shpërndarja e fitimit të vitit	-	-	-	217	(9,758)	(9,541)
Gjendja më 31 dhjetor 2002	750	3,750	5,468	7,827	-	17,795
Fitimi neto i vitit	-	-	-	-	7,853	7,853
Netimi i fondit të pensionit	-	-	-	(128)	-	(128)
Rivlerësimi i valutave të huaja dhe i arit	-	-	(12,040)	-	-	(12,040)
Rivlerësimi i letrave me vlerë	-	-	270	-	-	270
Rimarrja e tepricës nga rivlerësimi i aktiveve fikse	-	-	(28)	-	28	-
Rritja në planin e fondit të pensionit	-	-	-	20	-	20
Shpërndarja e fitimit të vitit	-	-	-	179	(7,881)	(7,702)
Gjendja më 31 dhjetor 2003	750	3,750	(6,330)	7,878	-	6,048

Shënimet mbi pasqyrat financiare, nga faqja 99 deri në faqen 122, janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

BANKA E SHQIPËRISË
PASQYRA E FLUKSIT TË PARASË
PËR FUNDVITET 31 DHJETOR 2003 DHE 31 DHJETOR 2002
(TË GJITHA BALANCAT JANË NË MILIONË LEKË)

Shënim nr.	Viti që përfundon më 31 dhjetor 2003	Viti që përfundon më 31 dhjetor 2002
Fluksi i parasë nga operacionet		
Fitimi neto i vitit	7,853	9,730
Zëra jomonetarë në pasqyrën e operacioneve		
Zhvlërësimi dhe amortizimi	439	322
Amortizimi i letrave me vlerë	955	725
Të ardhurat nga interesat dhe komisionet	(11,067)	(11,895)
Shpenzimet për interesat dhe komisionet	3,356	1,100
Fitim/humbje nga shitja e letrave me vlerë të vlefshme për shitje	(59)	507
Fluksi i parasë para lëvizjeve në kapitalit punues	1,477	493
Ndryshime në aktivet dhe në detyrimet operacionale		
Ulja në depozita me Fondin Monetar Ndërkombëtar	1,794	1,006
Ulja në depozita me bankat e huaja	-	18,805
Ulja në aktive të tjera të huaja	55	350
Ulja (rritja) në kreditë tranzite	6,939	(1,069)
Ulja (rritja) në kredi ndaj bankave vendase	3,405	(2,929)
Ulja në kredi ndaj qeverisë	1,150	1,562
(Rritja) ulja në aktive të tjera vendase	(25)	821
Ulja në detyrimet ndaj FMN	(1,669)	(1,347)
Rritja (ulja) në detyrime ndaj institucioneve financiare	(7,028)	1,233
Ulja në pasive të tjera të huaja jorezidente	-	3
Rritja (ulja) në detyrimet ndaj bankave vendase	2,093	(571)
Rritja në detyrimet ndaj qeverisë	2,440	290
Rritja në detyrime të tjera vendase	60	221
Ulja në të ardhurat për t'u shpërndarë	(33)	-
Fluksi i parasë i gjeneruar nga operacionet	9,181	18,369
Interesa të marra	9,692	2,120
Interesa të paguara	(1,094)	(2,056)
Efkti i ndryshimit të kurseve të këmbimit në aktivet dhe në pasivet operative	(11,798)	(11,554)
Paraja neto e përdorur në aktivitete operacionale	7,458	7,372
Fluksi i parasë nga investimet		
Blerja e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara	(114)	(138)
Blerja e aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara	(35)	(617)
Blerja e letrave me vlerë të huaja	(85,507)	(123,780)
Blerja e letrave me vlerë vendase	(195,468)	(210,181)
Shitja dhe maturimi i letrave me vlerë të huaja	81,843	99,692
Shitja dhe maturimi i letrave me vlerë vendase	209,641	211,043
Rritja në marrëveshjet e riblerjes	1,204	-
Fluksi neto i përdorur në investime	11,564	(23,981)

BANKA E SHQIPËRISË
PASQYRA E FLUKSIT TË PARASË (VAZHDIM)
PËR FUNDVITET 31 DHJETOR 2003 DHE 31 DHJETOR 2002
(TË GJITHA BALANCAT JANË NË MILIONË LEKË)

	Shënim nr.	Viti që përfundon më 31 dhjetor 2003	Viti që përfundon më 31 dhjetor 2002
Fluksi i parasë prej financimit			
Rritja në rezerva të tjera		51	
Ulja/rritja në emetimin e parasë në qarkullim		(5,341)	14,500
Shpërndarja e fitimit qeverisë		(7,881)	(7,924)
Fluksi neto prej financimit		(13,171)	6,766
Rritja (rënia) në para gjatë vitit		5,851	(9,843)
Paraja dhe ekuivalentet e saj në fillim të vitit	23	16,075	25,918
Paraja dhe ekuivalentet e saj në fund të vitit	23	21,926	16,075

Shënimet mbi pasqyrat financiare, nga faqja 99 deri në faqen 122, janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

BANKA E SHQIPËRISË
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE
PËR FUNDVITET 31 DHJETOR 2003 DHE 31 DHJETOR 2002
(TË GJITHA BALANCAT JANË NË MILIONË LEKË)

BANKA E SHQIPËRISË

SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

PËR FUNDVITIN 31 DHJETOR 2003 DHE 31 DHJETOR 2002

1. INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME

Banka e Shqipërisë ("Banka") është banka qendrore e Republikës së Shqipërisë, që ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me ligjin nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë" dhe në zbatim të këtij ligji, detyrat kryesore të Bankës së Shqipërisë janë si vijon:

- arritja dhe ruajtja e stabilitetit të çmimeve;
- nxitja dhe mbështetja e zhvillimit të një regjimi të këmbimeve valutore;
- administrimi i parasë në qarkullim;
- administrimi i normave të interesit;
- hartimi, miratimi dhe zbatimi i politikës monetare të Republikës së Shqipërisë;
- mbikëqyrja e aktiviteteve të bankave të nivelit të dytë, përfshirë dhënien e licencave të të gjitha bankave;
- dhënia e licencave për ushtrimin e aktivitetit brenda territorit të Republikës së Shqipërisë të institucioneve bankare ndërkombëtare.

Banka i nënshtrohet ligjeve të miratuara nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë dhe ligjit "Për Bankën e Shqipërisë".

2. PËRMBLEDHJE E DISA PARIMEVE TË RËNDËSISHME KONTABËL

(A) BAZAT E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me ligjin shqiptar "Për kontabilitetin" dhe në përputhje me parimet kontabël të përshtatura nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë. Kjo politikë kontabël është gjerësisht në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF") të miratuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ("BSNK") me përjashtim të SNK 16, SNK 21, SNK 19, SNK 26 dhe SNK 27. Këto standarde dhe interpretime njiheshin më parë si Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit ("SNK"). Sipas rregulloreve vendase, SNRF përdoren në përgatitjen e pasqyrave financiare të bashkëngjitura, deri në fazën ku nuk bien në kundërshtim me ligjin shqiptar "Mbi kontabilitetin" dhe rregulla të tjera vendase.

Parimet kontabël më domethënëse që janë përdorur nga Banka në pasqyrat financiare, janë si më poshtë:

Pasqyrat financiare të paraqitura përfshijnë llogaritë e Bankës, përgatitur mbi bazën e kostos historike të kontabilitetit, përshtatur për të përfshirë rivlerësimin e portofolit të letrave me vlerë, të valutave të huaja, të arit, të ndërtesës qendrore, si dhe të aktiveve dhe të detyrimeve të tjera financiare (të mbajtura për shitje).

Pasqyrat financiare paraqiten në monedhën vendase të Republikës së Shqipërisë, Lek Shqiptar ("Lekë").

Banka kontrollon aktivitetin e Shtypshkronjës, një njësi biznesi e cila merret me shtypshkrimin e materialeve të qeverisë që përmbajnë elemente të sigurisë së lartë dhe të publikimeve të Bankës së Shqipërisë. Aktiviteti financiar i Shtypshkronjës nuk është konsoliduar me ato të Bankës, për shkak të paaftësisë së Shtypshkronjës për të kryer rivlerësimin e mjeteve financiare dhe të ndërtesave të saj në përputhje me rivlerësimin e mjeteve financiare dhe të ndërtesave të Bankës. Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë në mbledhjen e datës 1 prill 2003, vendosi që Shtypshkronja duhet të jetë nën mbikëqyrjen e Bankës së Shqipërisë, si një pjesë e veçantë e strukturës organizative të saj.

Pozicioni financiar i Shtypshkronjës në 31 Dhjetor 2003, është i pasqyruar në notën 24 të këtyre pasqyrave financiare.

(B) SHMANGIE NGA STANDARDET NDËRKOMBËTARE TË RAPORTIMIT FINANCIAR

Më poshtë është paraqitur një përmbledhje e shmangieve më të rëndësishme nga SNRF :

- SNK 16: "Pasuria, toka dhe pajisjet".

Metodologjia e zbatuar për rivlerësimin e ndërtesës qendrore, siç është detajuar në shënimin 10, nuk është në përputhje me kërkesat e SNK 16 mbi pasurinë, tokën dhe pajisjet, në faktin se rivlerësimi nuk u krye nga vlerësues të pavarur profesionalisht të kualifikuar, flukset e ardhshme të parasë nuk u skontuan dhe nuk u rivlerësuan të gjitha njësitë përbërëse të kategorisë së ndërtesave.

- SNK 21: "Efektet e ndryshimit të kurseve të këmbimit".

Ligji mbi Bankën e Shqipërisë kërkon njohjen e fitimit/humbjes së realizuar nga rivlerësimi i kursit të këmbimit në bilanc në llogarinë "Kapitali dhe rezervat" dhe jo si e ardhur/shpenzim për periudhën në të cilën rivlerësimi ka ndodhur.

- SNK 19: "Përfitimet e punonjësve" dhe SNK 26 "Kontabiliteti dhe Raportimi i Planit të Pensionit".

Raportimi dhe kontabilizimi i planit të pensionit nuk është bërë në përputhje me SNK 19 dhe SNK 26. Detyrimi ndaj planit të pensionit është shprehur si vlerë neto, por përlllogaritja e këtij detyrimi nuk i është përmbajtur specifikimeve të standardit, në faktin se asnjë vlerësim aktual nuk është bërë.

- SNK 27: "Pasqyrat financiare të konsoliduara dhe kontabiliteti i investimit në filiale".

Në pasqyrat financiare të Bankës nuk është bërë konsolidimi i raporteve financiare në lidhje me aktivitetin e shtypshkronjës, njësi që administrohet nga Banka, siç sqarohet më poshtë.

(C) NDRYSHIME NË PARIMET KONTABËL

Të ardhura nga interesat mbi aktivitetet e administruara

Gjatë periudhës 1992 - 2002, Banka ka njohur si të ardhura nga interesat në pasqyrën e të ardhurave dhe të shpenzimeve, të gjitha të ardhurat për llogaritë "Depozita në ar", përfshirë

edhe depozitat e arit që përfaqësojnë aktive të administruara në emër të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë ("Qeveria") (shih shënimin 2 (m)).

Gjatë vitit 2003, u bë përlllogaritja e interesave të realizuar nga depozitat e arit që i përkasin aktiveve të administruara në emër të qeverisë për periudhën në fjalë. Ky detyrim u përlllogarit rreth 843 onz ar (rreth 37 milionë lekë), në favor të qeverisë, duke dhënë efekte në uljen e aktiveve të arit të Bankës si dhe në uljen e rezervës së rivlerësimit të pozicionit të Bankës kundrejt arit.

Riklasifikimi i planit të pensionit

Gjatë vitit 2003, Banka harmonizoi politikën e saj kontabël me SNK 26 "Kontabiliteti dhe Raportimi i Planit të Pensionit". Si rrjedhojë u bë netimi i planit të pensionit duke riklasifikuar investimet në bonot e thesarit 12-mujore nga "Letra vendase me vlerë të disponueshme për t'u shitur" dhe "Rezervat e tjera" në zërin "Detyrime ndaj planit të pensionit, neto".

Plani i pensionit u njoh si "Detyrim neto ndaj planit të pensionit" me një vlerë prej 1 milion lekë për vitin 2003 (2002: 6 milionë lekë).

Rivlerësimi i letrave me vlerë

Gjatë vitit 2003, Banka zbatoi SNK 39 "Instrumentet financiare: Njohja dhe matja". Fitimi ose humbja e përealizuar nga rivlerësimi i letrave me vlerë të disponueshme për shitje, pasqyrohet në bilanc në zërin "Rezerva e rivlerësimit të letrave me vlerë" deri në datën e shitjes së letrës me vlerë. Efekti i kësaj politike është rritja e rezervave të rivlerësimit me 270 milionë lekë për vitin 2003, si dhe rritja respektive e portofolit të letrave me vlerë.

(D) INTERESA DHE KOMISIONE

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat njihen sipas kontabilitetit të të drejtave të konstatuara.

Të ardhurat nga komisionet regjistrohen kur të ardhurat janë marrë. Shpenzimet e komisionit regjistrohen kur shpenzimet janë paguar.

(E) KONVERTIMI I VALUTAVE TË HUAJA

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në Lekë, me kursin zyrtar të këmbimit të Bankës, në datën e kryerjes së transaksionit.

Aktivitet dhe pasivitet në monedhë të huaj konvertohen në Lekë, me kursin zyrtar të këmbimit të Bankës në datën e bilancit. Fitimi ose humbja e përealizuar nga konvertimi i kurseve të këmbimit njihen në llogarinë "Rezerva e rivlerësimit".

Kurset zyrtare të këmbimit të përdorura nga Banka (njësi e monedhës së huaj përkatëse e shprehur në Lekë) për monedhat e huaja më kryesore, më 31 dhjetor 2003 dhe 2002 paraqiten si më poshtë :

	31 dhjetor 2003	31 dhjetor 2002
Dollari amerikan ("Usd")	106.58	133.74
Monedha evropiane ("Euro")	134.32	140.18
Sterlina angleze ("Gbp")	189.92	215.31
Të drejta të veçanta tërheqjeje ("Sdr")	157.81	181.16

Të ardhurat dhe shpenzimet në valutë për vitin konvertohen me kursin mesatar vjetor të Bankës së Shqipërisë.

	2003	2002
Dollari amerikan ("Usd")	108.69	134.97
Monedha evropiane ("Euro")	133.65	137.90
Sterlina angleze ("Gbp")	190.25	214.38
Të drejta të veçanta tërheqjeje ("Sdr")	159.37	180.80

(F) INVESTIMET

Investimet e mbajtura nga Banka janë të kategorizuara në portofole, në përputhje me qëllimet e Bankës në momentin e blerjes së investimeve dhe në përputhje me strategjinë mbi investimet në letra me vlerë. Këto investime klasifikohen si më poshtë:

- letra me vlerë të mbajtura deri në maturim;
- letra me vlerë të disponueshme për shitje.

Të gjitha investimet shprehen fillimisht me kosto, që konsiderohet çmimi i blerjes përfshirë shpenzimet e lidhura me blerjen e investimit.

Letra me vlerë të mbajtura deri në maturim

Letrat me vlerë të mbajtura deri në maturim janë mjete financiare, të cilat mbartin pagesa fikse ose të përcaktuara dhe me maturime fikse, për të cilat Banka ka qëllimin pozitiv dhe mundësinë për t'i mbajtur deri në maturim. Ky portofol përbëhet nga obligacione të lëshuara nga qeveria për rikapitalizimin e Bankës Kombëtare Tregtare.

Letrat me vlerë të mbajtura deri në maturim njihen duke u bazuar në datën e tregtimit dhe fillimisht janë të matura me kosto. Në datat e mëpasshme të raportimit, ato janë të mbartura me vlerën e amortizuar, duke zbritur humbjen nga rënia në vlerë, që njihet për të reflektuar shumat e humbura. Amortizimi vjetor i çdo uljeje ose primi në blerjen e letrave me vlerë të mbajtura deri në maturim është i kombinuar me të tjera të ardhura nga investimet, që priten të përfitohen gjatë periudhës së instrumentit, në mënyrë që e ardhura e njohur në secilën periudhë të përfaqësojë një *yield* konstant në investime.

Letra me vlerë të disponueshme për shitje

Pas njohjes së parë, letrat me vlerë të cilat klasifikohen si të disponueshme për shitje, rivlerësohen me vlerën reale. Ndryshimet në vlerën reale pasqyrohen si një komponent i veçantë i kapitalit derisa investimi shitet, arkëtohet ose nuk zotërohet më.

Vlera reale

Për letrat me vlerë që tregtohen në tregje financiare të organizuara, vlera reale përcaktohet duke iu referuar çmimeve të kuotuar në bursë, në momentin e mbylljes së aktivitetit të biznesit në datën e bilancit.

Për letrat me vlerë, për të cilat nuk ekziston një çmim i kuotuar në bursë, një vlerësim i arsyeshëm i vlerës reale përcaktohet duke iu referuar vlerës aktuale të tregut të një letre tjetër me vlerë, e cila është e përafërt në natyrë.

Rënia në vlerë dhe paarkëtueshmëria e aktiveve financiare

Në çdo datë bilanci bëhet një vlerësim për të përcaktuar nëse ekziston një provë objektive që një aktiv financiar ose një grup aktivesh financiare mund të ketë pësuar rënie në vlerë. Në qoftë se një evidencë e tillë ekziston, shuma që vlerësohet të merret nga ai aktiv dhe ndonjë humbje nga rënia në vlerë, përcaktohet bazuar në vlerën neto aktuale të fluksit të ardhshëm të parasë që pritet të merret, dhe njihet si diferencë midis shumës që vlerësohet të merret dhe vlerës së mbartur si më poshtë:

- për aktivet financiare të regjistruara me kosto të amortizuara – vlera e mbartur e aktivitetit ulet deri në shumën që vlerësohet të merret në mënyrë direkte ose nëpërmjet përdorimit të një llogarie provigjoni dhe shuma e humbjes përfshihet në pasqyrën e të ardhurave dhe të shpenzimeve; dhe
- për aktivet financiare të regjistruara me vlerë reale – në qoftë se humbja është kaluar direkt në kapital, si rezultat i uljes së vlerës së aktivitetit në shumën që vlerësohet të merret prej tij, humbja neto e akumuluar, e kaluar në kapital transferohet në pasqyrën e të ardhurave dhe të shpenzimeve.

(G) MARRËVESHJET E RIBLERJES DHE MARRËVESHJET E ANASJELLTA TË RIBLERJES

103

Letrat me vlerë, blerë nën marrëveshje për t'i rishitur (marrëveshje riblerjeje e anasjelltë) dhe letrat me vlerë shitur nën marrëveshje për t'i riblerë (marrëveshjet e riblerjes) janë trajtuar përgjithësisht si transaksione financuese të kolateralizuara dhe regjistrohen me shumën e parave të dhëna në avancë apo të marra, plus interesin e përlllogaritur.

Marrëveshjet e riblerjes regjistrohen në bilanc në zërin "Detyrime ndaj bankave vendase". Në bazë të rregullores së Bankës mbi marrëveshjet e riblerjes, Banka nuk vendos letra me vlerë si kolateral për këto detyrime.

Interesi i fituar mbi marrëveshjet e anasjellta të riblerjes dhe interesi i pësuar mbi marrëveshjet e riblerjes njihen si të ardhura ose si shpenzime nga interesi gjatë jetëgjatësisë së çdo marrëveshjeje, duke përdorur normën bazë të interesit të shpallur me vendim të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës.

(H) AKTIVE TË QËNDRUESHME

Aktivet e qëndrueshme shprehen me koston historike, zvogëluar me amortizimin e akumuluar, me përjashtim të ndërtesës qendrore të Bankës, e cila është vlerësuar më 29 mars 2000 (Shënimi 10).

Në qoftë se vlera e tregut e një aktivi të qëndrueshëm është më e vogël sesa vlera kontabël, për shkak të rrethanave të konsideruara jo të përkohshme, aktivi zvogëlohet deri në vlerën e tregut.

Fitimet ose humbjet nga heqja (shitjet ose nxjerrjet jashtë përdorimit) e aktiveve të qëndrueshme regjistrohen në llogarinë humbje-fitim të vitit në të cilin aktivi është hequr.

Amortizimi llogaritet mbi të gjitha aktivet e qëndrueshme, bazuar në koston historike. Amortizimi vjetor llogaritet me metodën lineare, duke përdorur normat specifike të amortizimit për çdo aktiv të amortizueshëm, bazuar në jetëgjatësinë e vlerësuar të aktivit. Jetëgjatësia në vite e zbatuar në vitin 2003 është e njëjtë me atë të vitit 2002:

	2003
Ndërtesa – godina qendrore	40 vjet
Ndërtesat – në degë	25 vjet
Mjete transporti	5 – 10 vjet
Pajisje zyre	3 – 20 vjet
Programe kompjuteri	2 vjet

(I) KOSTO TË SHTYPJES DHE TË PRERJES SË PARASË

Kostot e printimit të kartëmonedhave dhe të prerjes së monedhave kapitalizohen si aktive të qëndrueshme të patrupëzuara dhe amortizohen respektivisht me 2.5 vjet dhe 10 vjet.

(J) TATIMI DHE SHPËRNDARJA E FITIMIT

Banka është e përjashtuar nga tatimi mbi fitimin në bazë të ligjit “Për Bankën e Shqipërisë” dhe kërkohet me ligj që 100 për qind e fitimit të kalojë direkt në buxhetin e Shtetit, pas plotësimit të niveleve të fondeve rezervë të kërkuara nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë.

(K) REZERVA LIGJORE

Në përputhje me ligjin “Për Bankën e Shqipërisë”, Banka ka krijuar një rezervë ligjore në të cilën, 25 për qind e fitimit neto të vitit, transferohet derisa shuma e rezervës arrin 500 për qind të kapitalit themeltar.

(L) PËRDORIMI I PARASHIKIMEVE

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga drejtimi i Bankës që të bëjë parashikime dhe supozime, që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve dhe të detyrimeve dhe paraqitjen e aktiveve dhe detyrimeve, llogaritur në datën e përgatitjes së pasqyrave financiare dhe shumat e raportuara të të ardhurave dhe të shpenzimeve gjatë periudhave të raportuara. Ky parashikim bëhet sepse rezultatet faktike mund të ndryshojnë nga ato të parashikuara.

(M) AKTIVE TË ADMINISTRUARA

Më 31 dhjetor 2003, Banka mbante në kujdestari bono thesari afatshkurtra, të emetuara nga Ministria e Financave si edhe ar dhe metale të tjera të çmuara në emër të qeverisë.

Më 31 dhjetor 2003, vlera e arit në emër të qeverisë, e vendosur në llogari rrjedhëse jashtë vendit, është 2,484 milionë lekë (2002 – 2,523 milionë lekë), që përfaqësojnë 55,876.42 onz ar (2002 – 55,036.5 onz ar). Po më 31 dhjetor 2003, gjendja e arit dhe e metaleve të tjera të çmuara është 1,430 milionë lekë (2002 – 1,467 milionë lekë), që përfaqësojnë gjendjen e platinut, të argjendit dhe të metaleve të tjera të çmuara në kasafortë me një shumë prej 119 milionë lekësh si dhe ar i pastandardizuar në 1,309 milionë lekë. Meqë Banka luan rolin e një kujdestari për këto aktive, ajo nuk mbart asnjë lloj rreziku krediti.

Interesat e marra nga depozitimi i rezervave të arit të qeverisë njihen si të ardhura nga interesat për qeverinë duke rritur detyrimin ndaj qeverisë.

Llogaritë ar të qeverisë si dhe interesat përkatës janë përjashtuar nga pasqyrat financiare të Bankës.

(N) GRANTE

Grantet regjistrohen fillimisht në bilanc me shumën e marrë. Grantet që lidhen me zëra të shpenzimeve të kryera, merren si të ardhura në periudhën e lidhur me shpenzimin. Grantet që lidhen me blerjen e pasurive të patundshme, të pajisjeve dhe të programeve kompjuterike, merren si të ardhura gjatë jetës së aktivitetit përkatës, me një shumë që i korrespondon shumës së amortizimit të atij aktivi.

105

(O) KRAHASUESHMËRIA

Disa shuma në pasqyrat financiare të vitit të mëparshëm janë riklasifikuar që t'i përshtaten prezantimit të vitit aktual.

3. ARI DHE METALE TË ÇMUARA

Më 31 dhjetor 2003, vlera e arit e vendosur në llogari rrjedhëse dhe në depozita jashtë vendit, pronë e Bankës, ishte 593 milionë lekë (2002 – 1,182 milionë lekë), e cila përbëhet prej 13,322 onz në shufra prej ari (2002 – 245,782 onz shufra).

11,608 onz ar u shit në janar 2003 për të plotësuar kërkesat e administrimit të rezervës valutore.

Ari është vlerësuar me kursin e këmbimit fiks të Londrës në datën e bilancit. Diferencat që rezultojnë nga rivlerësimi i arit, janë regjistruar në rezervën e rivlerësimit. Më 31 dhjetor 2003, një onz ar u vlerësua me 417.25 dollarë amerikanë (2002 – 342.75 dollarë).

“Ari dhe metale të tjera të çmuara” të përfshira në aktive vendase përfshin gjendjet e platinut dhe të argjendit në kasafortë, të vlerësuara me kursin e këmbimit fiks të Londrës, në datën e bilancit, me një shumë totale prej 39 milionë lekësh më 31 dhjetor 2003 (2002 – 36 milionë lekë) si edhe ar i pastandardizuar në 4 milionë lekë (2002 – 4 milionë lekë).

4. DEPOZITA TEK FONDI MONETAR NDËRKOMBËTAR

	Fund viti 31 dhjetor 2003	Fund viti 31 dhjetor 2002
Fondi Monetar Ndërkombëtar	8,407	8,951
Të drejta të veçanta tërheqjeje ("sdr")	9,623	10,873
Interes i përllogaritur	26	37
Totali	18,056	19,861

Depozitat tek Fondi Monetar Ndërkombëtar ("FMN") rezultojnë prej anëtarësisë së Republikës së Shqipërisë në FMN dhe kjo shumë është e garantuar me një notë premtimi emetuar nga qeveria. Depozitat në sdr janë të përafërta me kuotën e anëtarësisë së Republikës së Shqipërisë paguar FMN-së në sdr dhe në lekë, e cila ka si kundërparti huatë e dhëna Republikës së Shqipërisë, siç paraqitet në shënimin 11.

Depozitat në sdr kanë një interes, i cili është i përcaktuar në bazë javore. Norma e interesit më 31 dhjetor 2003, ishte 1.57 për qind (2002 – 1.91 për qind).

5. DEPOZITA NË BANKAT E HUAJA

	Fund viti 31 dhjetor 2003	Fund viti 31 dhjetor 2002
Llogari rrjedhëse	8,753	2,537
Depozita afatshkurtra	1,797	2,909
Interes i përllogaritur	3	4
Totali	10,553	5,450

Depozitat me afat të shkurtër maturohen në janar të vitit 2004 dhe kanë një normë interesi që varion nga 0.93 për qind në 3.63 për qind (2002 – nga 1.2 për qind në 3.76 për qind). Depozitat dhe llogaritë rrjedhëse në bankat e huaja janë në euro, dollarë amerikanë dhe sterlina angleze, të cilat sipas çdo monedhe të huaj u përgjigjen gjendjeve të mëposhtme:

	Fund viti 31 dhjetor 2003	Fund viti 31 dhjetor 2002
Euro	41	17
Usd	44	19
Gbp	2	2

6. LETRAT ME VLËRË TË DISPONUESHME PËR SHITJE

	Fund viti 31 dhjetor 2003	Fund viti 31 dhjetor 2002
Nota të skontuara thesari të Qeverisë Amerikane	33,587	23,905
Nota thesari të Qeverisë Franceze	32,612	22,021
Investime afatmesme të Bank for International Settlements	4,046	17,849
Nota të skontuara të agjencive amerikane	7,567	12,436
Bono thesari të Qeverisë Franceze	2,662	8,773
Investime me kurs fiks (FIX BIS)	6,401	5,530
Bono thesari të agjencive amerikane	-	2,669
Bono thesari të Qeverisë Amerikane	-	2,001
Totali	86,875	95,184

Portofoli i letrave me vlerë të huaja, i paraqitur në vlerë tregu dhe sipas llojit të valutës, është si më poshtë:

	Fund viti 31 dhjetor 2003	Fund viti 31 dhjetor 2002
USD		
Nota të skontuara të Qeverisë Amerikane	315	180
Nota të skontuara të agjencive amerikane	71	93
Investime afatmesme të Bank for International Settlements	5	42
Investime me kurs fiks (FIX BIS)	5	5
Bono thesari të Qeverisë Amerikane	-	15
Letra me vlerë të agjencive amerikane	-	20
Totali	396	355
EURO		
Obligacione thesari të Qeverisë Franceze	243	158
Investime afatmesme të Bank for International Settlements	26	89
Investime me kurs fiks (FIX BIS)	20	11
Bono thesari të Qeverisë Franceze	20	63
Totali	309	321
GBP		
Investime me kurs fiks (FIX BIS)	16	15
Totali	16	15

Notat e skontuara të Qeverisë Amerikane janë të shprehura në dollarë amerikanë dhe kanë kurse kuponash që variojnë nga 1.125 për qind në 5.75 për qind. Interesi paguhet në baza gjashtëmujore dhe maturimet variojnë nga shkurti i vitit 2004 në nëntor të vitit 2008. *Yield*-i varion nga 0.95 për qind në 4.65 për qind (2002 – 0.97 për qind në 4.75 për qind).

107

Obligacionet e thesarit të Qeverisë Franceze janë të shprehura në euro me kurse kuponash nga 3 për qind në 8.25 për qind. Interesi është i pagueshëm në baza vjetore dhe maturimet variojnë nga janari i vitit 2004 në korrik të vitit 2008. *Yield*-i është nga 2.06 për qind në 4.53 për qind (2002 - nga 2.60 për qind në 4.53 për qind).

Investimet afatmesme të Bank of International Settlements përbëhen nga letra me kupona fikse, të përcaktuara në dollarë amerikanë dhe në euro, me kurse që variojnë nga 5 për qind në 5.5 për qind. Interesi është i pagueshëm në baza vjetore për investimet në euro dhe gjashtëmujore për investimet në dollarë amerikanë dhe maturimet variojnë midis qershorit 2004 dhe dhjetorit të vitit 2005. *Yield*-i varion nga 3.11 për qind në 4.72 për qind (2002 - nga 2.34 për qind në 4.72 për qind).

Notat e skontuara të agjencive amerikane janë të shprehura në dollarë amerikanë me kurse kuponi që variojnë midis 1.875 për qind dhe 5.25 për qind. Interesi është i pagueshëm në baza gjashtëmujore dhe kufijtë e maturimit janë janar 2004 dhe maj 2006. *Yield*-et variojnë nga 1.14 për qind në 4.71 për qind (2002 – nga 1.59 për qind në 4.71 për qind).

Bonot e thesarit të Qeverisë Franceze janë të shprehura në euro dhe maturohen në data të ndryshme midis marsit dhe gushtit të vitit 2004. Ato janë blerë me *yield*-e që variojnë midis 1.86 për qind dhe 2.18 për qind (2002 – nga 3.04 për qind në 3.82 për qind).

Investime me kurs fiks (FIX BIS) të emetuara nga Bank of International Settlements janë të shprehura në dollarë amerikanë, në euro dhe në sterlina angleze me *yield*-e nga 1.02 për qind në 4.16 për qind, me kufij maturiteti nga janari në dhjetor të vitit 2004 (2002 sterlina angleze nga 1.21 për qind në 4.53 për qind).

7. AKTIVE TË TJERA TË HUAJA

Më 31 dhjetor 2003, aktivet e tjera të huaja përbëhen nga arka në valutë me një vlerë 13 milionë lekë (2002 – 22 milionë lekë) si dhe nga kuotizacionet për pjesëmarrjen në Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (“BERZH”), në Bankën Botërore, si dhe në Bankën Islamike të Zhvillimit.

	Fund viti 31 dhjetor 2003	Fund viti 31 dhjetor 2002
Arka në valutë	13	22
Të tjera		
Kuotizacion në Bankën Botërore	362	372
Kuotizacion IDA	36	37
Kuotizacion MIGA	13	14
Kuotizacion IFC	78	98
Kuotizacion në BERZH	62	78
Kuotizacion në IDB	24	31
Totali i të tjerave	575	630
Totali	588	652

8. KREDI TRANZITE

108

Kreditë tranzite, sipas sektorëve të industrisë, ndahen si më poshtë:

	Fund viti 31 dhjetor 2003	Fund viti 31 dhjetor 2002
Bujqësi	-	1,475
Industri	-	4,966
Sektori i shërbimeve dhe të tjera	384	882
Totali	384	7,323

Kreditë tranzite për sektorët e bujqësisë dhe të industrisë përfaqësonin shërbime krediti pa interes, akorduar institucioneve të kreditit për t’iu shpërndarë huamarrësve, me qëllim të mbështetjes së programeve qeveritare (Shënimi 12). Të gjitha huatë ishin të garantuara nga qeveria.

Sipas shkresës nr. 6779, datë 19 dhjetor 2003, Banka i transferoi Ministrisë së Financave të gjitha principalet e kredive “bujqësi” dhe “industri” të dhëna nga Kreditanstalt für Wiederaufbau (“KfW”) me shumën 48 milionë euro (6,441 milionë Lekë). Banka do të vazhdojë të kryejë transferimin e pagesave dhe të shlyerjeve të kredive deri në përfundimin e tyre.

9. INVESTIME NË LETRA ME VLERË VENDASE

9.1 LETRA ME VLERË TË DISPONUESHME PËR SHITJE

	Fund viti 31 dhjetor 2003	Fund viti 31 dhjetor 2002
Bono thesari afatshkurtra	71,687	74,436
Totali	71,687	74,436

Bonot e thesarit afatshkurtra, më 31 dhjetor 2003, lidhen kryesisht me bono thesari zero kupon të qeverisë, të cilat maturohen në periudhën janar - dhjetor 2004. *Yield*-i i tyre në blerje varion nga 7.25 për qind deri në 12.95 për qind (2002 – nga 10.30 për qind në 12.51 për qind).

9.2 LETRA ME VLERË TË MBAJTURA DERI NË MATURIM

	Fund viti 31 dhjetor 2003	Fund viti 31 dhjetor 2002
Obligacione zero kupon për kapitalizimin e Bankës Kombëtare Tregtare ("BKT")	1,573	1,449
Totali	1,573	1,449

Letrat me vlerë për kapitalizimin e Bankës Kombëtare Tregtare kanë të bëjnë me obligacione zero kupon, të cilat janë lëshuar nga qeveria për të zëvendësuar pjesëmarrjen në kapital në Bankën Kombëtare Tregtare. Letrat me vlerë fitojnë një interes prej 6 për qind në vit dhe maturohen në janar të vitit 2006.

10. AKTIVE TË TJERA VENDASE

	Fund viti 31 dhjetor 2003	Fund viti 31 dhjetor 2002
Debitorë të tjerë	84	112
Kredi punonjësve	491	435
Aktive të qëndrueshme, neto	1,449	1,455
Inventari	22	18
Aktive të patrupëzuara, neto	549	834
Të tjera	40	46
Totali	2,635	2,900

109

Vlera neto kontabël e aktiveve të qëndrueshme për çdo kategori paraqitet si më poshtë:

Në Lekë (mln)	Toka, ndërtesa dhe konstruksiione të përgjithshme	Pajisje të përgjithshme	Mjete transporti	Totali i aktiveve të qëndrueshme
Kosto/Vlerësimi				
Gjendja më 1 janar 2003	1,337	454	160	1,951
Shtesat	84	28	1	114
Pakësimet	-	-	-	114
Gjendja më 31 dhjetor 2003	1,421	482	161	2,065
Amortizimi i akumuluar				
Gjendja më 1 janar 2003	113	280	103	496
Shpenzimi vjetor	34	71	14	119
Pakësimet	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2003	147	351	117	615
Vlera kontabël neto				
Gjendja më 31 dhjetor 2003	1,274	131	44	1,449
Gjendja më 31 dhjetor 2002	1,224	174	57	1,455

10. AKTIVE TË TJERA VENDASE (VAZHDIM)

Ndërtesa qendrore e Bankës, e përfshirë nën kategorinë “Toka, ndërtesa dhe konstruksione të përgjithshme” u rivlerësua në vitin 2000 në shumën 1,143 milionë lekë, nga kosto historike plotësisht e amortizuar prej 7 milionë lekë. Rivlerësimi u bë më 29 mars 2000, me datë efektive 1 janar 2000, nga një komision i brendshëm vlerësuesish. Vlerësimi nuk u bë mbi bazën e flukseve të ardhshme të parasë të skontuara, por bazuar mbi vlerën e përafërt të tregut të dhënie/marrje me qira të pronësisë së patundshme me jetëgjatësi mbi 50 vjet. Ndërtesat e tjera në pronësi të Bankës nuk u vlerësuan. Rivlerësimi prej 1,143 milionë lekë pasqyrohet tek rezerva e rivlerësimit dhe amortizohet çdo muaj në përputhje me normën e amortizimit përkatëse.

Sipas ligjit shqiptar, titulli i pronësisë së ndërtesës së Bankës është i paqartësuar. Banka është në proces për zgjidhjen e statutit të pronësisë me Ministrinë e Financave për objektet që administrohen prej saj.

Totali neto i aktiveve të patrupëzuara përbëhet si më poshtë:

	Fund viti 31 dhjetor 2003	Fund viti 31 dhjetor 2002
Programe kompjuterike dhe të tjera	166	145
Kartëmonedha dhe monedha të shtypura	2,397	2,383
Amortizimi i akumuluar	(2,014)	(1,694)
Totali	549	834

11. DETYRIME NDAJ FONDIT MONETAR NDËRKOMBËTAR

	Fund viti 31 dhjetor 2003	Fund viti 31 dhjetor 2002
Lehtësira për rregullime strukturore intensive (“ESAF”)	9,599	10,803
Letra me vlerë tek Fondi Monetar Ndërkombëtar	6,032	6,497
Llogari e Fondit Monetar Ndërkombëtar në lekë	1,847	1,847
Totali	17,478	19,147

Huatë ESAF janë të lidhura me kuotizacionin e Republikës së Shqipërisë në FMN dhe janë tërhequr në emër të qeverisë për reformat makroekonomike. Këto hua përbëhen nga këta tre komponentë:

Huaja fillestare ESAF, e tërhequr në vitin 1993, e cila pritët të shlyhet brenda 10 vjetëve duke filluar që nga viti 1999. Gjendja e kësaj huaje më 31 dhjetor 2003 ishte 4,377,000 sdr (2002 – 10,589,000 sdr) dhe kjo hua shlyhet çdo gjashtë muaj me interes 0.5 për qind.

Një hua shtesë nën këtë marrëveshje, e njohur si “Huaja për zbutjen e varfërisë dhe rritjen ekonomike” (“PRGF 1”), u tërhoq gjatë periudhës 1999 dhe 2001. Gjendja më 31 dhjetor 2003 ishte 44,451,500 sdr (2002 - 45,040,000 sdr). Kjo, gjithashtu, është një hua dhjetëvjeçare, e kthyeshme deri në vitin 2009, në 10 këste çdo gjashtë muaj duke filluar që nga viti 2004. Norma e interesit për t’u paguar pas periudhës pa interes është 0.5 për qind dhe është e pagueshme çdo gjashtë muaj.

Huaja "Lehtësi për zbutjen e varfërisë dhe rritjen" ("PRGF 2") për Shqipërinë, në shumën prej 28,000,000 sdr, u miratua me vendimin e Bordit Ekzekutiv të Fondit Monetar Ndërkombëtar të datës 21 qershor 2002. Nga disbursimi i transheve, gjatë vitit 2003, gjendja në fund të vitit është 12,000,000 sdr (2002 - 4,000,000 sdr) me një interes vjetor prej 0.5 për qind për qind i pagueshëm çdo gjashtë muaj. Principali i huasë do të fillojë të shlyhet pas pesë vjet e gjysëm, brenda pesë vjetëve me dhjetë këste të barabarta.

12. DETYRIME NDAJ INSTITUCIONEVE FINANCIARE JOVENDASE

	Fund viti 31 dhjetor 2003	Fund viti 31 dhjetor 2002
Detyrime tranzite (Shënimi 8)	384	7,326
Hua e Bankës së Greqisë	1,183	1,234
Detyrim ndaj Bankës Botërore	175	210
Interes i përlogaritur	5	5
Totali	1,747	8,775

Detyrimi në lidhje me "Hua për zhvillim" prej 384 milione lekësh përbëhet nga Banka Evropiane e Investimeve në rreth 1.7 milionë dollarë amerikanë dhe 1.7 milionë euro (shënimi 8). Interesi paguhet nga përfituesit e këtyre kredive tranzite (bankat dhe kompanitë vendase) drejtpërsëdrejti tek siguruesit e financimit.

Huaja e Bankës së Greqisë (hua e Republikës Greke) është dhënë me qëllim të financimit të bilancit të pagesave të Republikës së Shqipërisë. Norma vjetore e interesit është 1.17 për qind dhe është e pagueshme çdo 6 muaj. Huaja maturohet në vitin 2018.

111

13. PARAJA NË QARKULLIM

Banka ka të drejtën ekskluzive të emetimit të monedhës kombëtare. Ky zë përfshin kartëmonedha dhe monedha vendase në qarkullim të emetuara nga Banka.

Më 31 dhjetor 2003, struktura e monedhave dhe e kartëmonedhave, që ishin në qarkullim është si më poshtë:

Vlera nominale	31 dhjetor 2003		31 dhjetor 2002	
	Numri në mijë	Vlera Lekë (mIn)	Numri në mijë	Vlera Lekë (mIn)
100	18,441	1,844	19,724	1,972
200	18,596	3,719	19,407	3,881
500	62,049	31,025	67,382	33,691
1,000	60,563	60,563	62,067	62,067
5,000	5,875	29,375	6,080	30,400
Monedha metalike		1,248		1,104
Totali		127,774		133,115

14. DETYRIME NDAJ BANKAVE VENDASE

	Fund viti 31 dhjetor 2003	Fund viti 31 dhjetor 2002
Në monedha të huaja		
Llogari të bankave të nivelit të dytë	9,191	9,208
Depozita të marra si garanci	-	669
	9,191	9,877
Në monedhë vendase		
Llogari të bankave të nivelit të dytë	22,899	20,764
Marrëveshjet e riblerjes	1,204	-
Depozita njëditore	652	8
Totali	24,755	20,772
Interes i përllogaritur	24	48
Totali	33,970	30,697

Banka paguan interes mbi llogarinë e rezervave të detyrueshme. Interesi llogaritet si më poshtë:

gjendjet në lekë: 70 për qind e *yield*-it të marrëveshjeve repo: 4.9 për qind më 31 dhjetor 2003 (50 për qind e *yield*-it të bonove të thesarit tremujore: 5.6 për qind më 31 dhjetor 2002);

gjendjet në usd: 70 për qind e normës së usd libor një mujore: 0.8 për qind më 31 dhjetor 2003 (50 për qind e normës së usd libor një mujore: 0.69 për qind më 31 dhjetor 2002);

gjendjet në euro: 70 për qind e normës së euro libor një mujore: 1.49 për qind më 31 dhjetor 2003 (50 për qind e normës së euro libor një mujore: 1.45 për qind më 31 dhjetor 2002).

Banka nuk paguan interes mbi llogaritë rrjedhëse të bankave të nivelit të dytë dhe depozitat e marra si garanci.

Depozitat me afat njëditor janë me normë interesi prej 3.5 për qind (6 për qind më 31 dhjetor 2002).

15. DETYRIMI NDAJ QEVERISË

Detyrimi ndaj qeverisë më 31 dhjetor 2003 dhe 31 dhjetor 2002 përfshin si më poshtë:

	Fund viti 31 dhjetor 2003	Fund viti 31 dhjetor 2002
Fitim për t'iu derdhur qeverisë	200	1,350
Depozita në emër të qeverisë	5,230	1,543
Të tjera	34	131
Totali	5,464	3,024

"Fitimi për t'iu derdhur qeverisë" lidhet me pjesën e mbetur të fitimit të vitit 2003, i cili nuk i është shpërndarë akoma qeverisë, bazuar në vendimin nr.12 të datës 25 shkurt 2004, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

“Depozita në emër të qeverisë” përfshin llogarinë kryesore prej 3,552 milionë lekësh, si dhe fonde të donatorëve ndërkombëtarë të depozituara në Bankë për transferim të mëtejshëm në projektet e ndihmës në Shqipëri, prej 1,678 milionë lekësh.

Zëri “Të tjera” përfaqëson fonde të marra nga Banka për një hua të dhënë qeverisë nga Banka Islamike e Zhvillimit prej 24 milionë lekësh, si dhe marrëveshja e nënhuasë së sistemit korrier prej 10 milionë lekësh.

16. TË ARDHURA PËR T’U SHPËRNDARË

	Fund viti 31 dhjetor 2003	Fund viti 31 dhjetor 2002
Ndihma nga Banka Botërore	157	157
Amortizimi i ndihmës nga Banka Botërore	(76)	(6)
Të tjera	36	-
Totali	117	151

“Ndhma nga Banka Botërore” i referohet ndihmës së përfituar nga Banka gjatë vitit 2002, për blerjen e pajisjeve dhe të programeve kompjuterike për zbatimin e projektit ATM “Manaxhimi i Kontabilitetit dhe i Thesarit”.

113

17. DETYRIME TË TJERA VENDASE

	Fund viti 31 dhjetor 2003	Fund viti 31 dhjetor 2002
Detyrimi ndaj Shtypshkronjës	176	104
Depozita të individëve nga pjesëmarrja në bono thesari	177	129
Detyrimi ndaj planit të pensionit, neto	1	6
Të tjera	35	89
Totali	389	328

“Detyrimi ndaj planit të pensionit, neto” për fundvitet 31 dhjetor 2003 dhe 31 dhjetor 2002 përbëhet si më poshtë:

	Fund viti 31 dhjetor 2003	Fund viti 31 dhjetor 2003
Detyrimi neto ndaj planit të pensionit për kontributin 2 %	1	1
Detyrimi neto ndaj planit të pensionit për fondin 15 %	-	5
Detyrimi ndaj planit të pensionit, neto	1	6

Skema e planit të pensionit përbëhet nga kontributi i punonjësve në vlerën 2 për qind të pagës së tyre bruto si dhe nga plani i pensionit të punëdhënësit në vlerën 15 për qind të fondit të përgjithshëm të pagave për punonjësit.

	Fund viti 31 dhjetor 2003	Fund viti 31 dhjetor 2002
Vlera e detyrimit në lidhje me kontributin prej 2 për qind	12	9
Rezultati nga investimi i kontributit 2 për qind	1	-
Vlera reale e portofolit të letrave me vlerë	(12)	(8)
Detyrimi neto ndaj planit të pensionit për kontributin 2 për qind	1	1

	Fund viti 31 dhjetor 2003	Fund viti 31 dhjetor 2002
Vlera e detyrimit në lidhje me fondin e pensionit prej 15 për qind	137	107
Rezultati nga investimi i fondit 15 për qind	28	12
Vlera reale e portofolit të letrave me vlerë	(165)	(114)
Detyrimi neto ndaj planit të pensionit për fondin 15 për qind	-	5

18. REZERVAT E RIVLERËSIMIT

Përbërësit e rezervës së rivlerësimit janë si më poshtë:

	Fund viti 31 dhjetor 2003	Fund viti 31 dhjetor 2002
Rivlerësimi i monedhës së huaja dhe i arit	(7,672)	4,367
Rezerva e rivlerësimit të letrave me vlerë	270	-
Rivlerësimi i numizmatikës	32	32
Rivlerësimi i amortizuar i ndërtesës në qendër (Shënim 10)	1,040	1,069
Totali	(6,330)	5,468

“Rezervat për rivlerësimin e monedhave të huaja dhe të arit” kanë ndryshuar për efekt të rivlerësimit të valutave gjatë vitit me një vlerë prej 12,003 milionë lekësh, si dhe për efekt të zvogëlimit të pozicionit të Bankës në ar, për vlerën e interesave të depozitave që iu kaluan qeverisë prej 37 milionë lekësh (shih shënimin 2(b) dhe 2(m)).

19. REZERVA TË TJERA

Përbërësit e rezervave të tjera janë si më poshtë:

	Fund viti 31 dhjetor 2003	Fund viti 31 dhjetor 2002
Rezervë speciale për Bilancin e Pagesave	7,209	7,209
Fondi i investimit	301	301
Fondi i pensionit	-	127
Rezerva të tjera	368	190
Totali	7,878	7,827

“Rezerva speciale” ka të bëjë me fonde të dhëna nga Komuniteti Evropian për Bilancin e Pagesave dhe nuk ka patur lëvizje në këtë rezervë që nga viti 1995.

“Fondi i investimit” përbëhet nga një fond i krijuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës me qëllim blerjen e një godine të re për Bankën.

“Të tjera” i referohet fondit rezervë prej 368 milionë lekësh, të krijuar nga transferimi i 193 milionëve lekësh nga fitimi i vitit 2003, bazuar në vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës nr.12, datë 25 shkurt 2004.

20. TË ARDHURA NGA INTERESAT DHE KOMISIONET (REZIDENTËT)

	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2003	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2002
Interesa nga huatë qeveritare	54	186
Të ardhura nga interesat e letrave me vlerë	7,484	7,263
Të tjera	29	370
Totali	7,567	7,819

21. TË ARDHURA TË TJERA OPERATIVE, NETO

	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2003	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2002
Fitimi neto nga shitja e letrave me vlerë të disponueshme për shitje	246	115
Rimarrje të ardhurash nga ndihmat	70	6
Të tjera	6	25
Totali	322	146

115

22. SHPENZIME TË PERSONELIT

“Shpenzime të personelit” përfshijnë pagat e personelit, shpenzimet sociale, kontributet për planin e pensionit dhe shpenzime të tjera.

“Shpenzimet sociale” përfaqësojnë kryesisht kontributin e detyrueshëm ndaj Fondit të Sigurimeve Shoqërore. Më 31 dhjetor 2003, Banka ka patur 304 punonjës (2002- 245 punonjës).

23. PARAJA DHE EKUIVALENTET E SAJ

	Fundviti 31 dhjetor 2003	Fundviti 31 dhjetor 2002
Depozita në bankat e huaja (Shënimi 5)	10,551	5,446
Monedha vendase	10,726	9,385
Monedha të huaja (Shënimi 10)	13	22
Ari i mbajtur jashtë (Shënimi 3)	593	1,182
Ari dhe metalet e tjera të çmuara të mbajtura në vend (Shënimi 3)	43	40
Totali	21,926	16,075

24. SHTYPSHKRONJA

Siç është detajuar në shënimin 2(c), Banka kontrollon aktivitetin e Shtypshkronjës. Pozicioni financiar i Shtypshkronjës më 31 dhjetor 2003 dhe 2002 paraqitet si më poshtë:

	Fund viti 31 dhjetor 2003	Fund viti 31 dhjetor 2002
AKTIVET		
Aktive të qëndrueshme të trupëzuara	30	38
Inventari	41	48
Klientë	10	49
Për t'u arkëtuar nga Banka (Shënimi 17)	176	104
Totali i aktiveve	257	239
KAPITALI I VET		
Kapitali themeltar	52	52
Rezerva ligjore	19	19
Rezerva e investimit	24	24
Rezerva të tjera	6	6
Fitimi i pashpërndarë	156	134
Totali i kapitalit të vet	257	235
Detyrime të tjera	-	4
Totali i kapitalit të vet dhe detyrimeve	257	239

25. ANGAZHIME PËR NGJARJE TË PAPANASHIKUARA

Banka është e përfshirë në një numër çështjesh gjyqësore dhe procedurash ligjore, të ngritura gjatë aktivitetit të zakonshëm të biznesit. Drejtimi është i mendimit se këto procedura nuk do të kenë një efekt material në pozicionin financiar apo në rezultatet operative të Bankës.

Më 31 dhjetor 2003, Banka ka të regjistruar si element jashtë bilancit vetëm vlerën e kolateralit të kredive afatgjata, dhënë punonjësve të bankës me shumën 537 milionë Lekë.

26. PALËT E LIDHURA

Palët konsiderohen si të lidhura, në qoftë se njëra palë ka aftësinë të kontrollojë tjetrën apo të ushtrojë një influencë domethënëse mbi palën tjetër në marrjen e vendimeve financiare apo të tjera.

Në marrjen në konsideratë të çdo marrëdhënieje të mundshme me palët e treta, vëmendja përqëndrohet në substancën e marrëdhënies dhe jo thjesht mbi formën ligjore të saj.

Më 31 dhjetor 2003 dhe 31 dhjetor 2002, transaksionet e bëra me palët e lidhura përbëhen nga:

	Fund viti 31 dhjetor 2003	Fund viti 31 dhjetor 2002
Kredi të tjera vendase		
Kredi për punonjësit		
- Drejtues	40	40
Totali i kredive	40	40

	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2003	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2002
Të ardhurat nga interesat		
Të ardhurat nga interesat - Drejtues	-	-
Totali i të ardhurave	-	-
Shpenzime administrative		
Shpenzime celulari		
- Drejtues	2	1
Paga dhe shpërblime		
- Drejtues	40	28
Totali i shpenzimeve	42	29

27. ADMINISTRIMI I RREZIKUT

Rreziku i likuiditetit

Politikat e monitorimit dhe të adresimit ndaj rrezikut të likuiditetit përcaktohen nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës. Departamenti i Operacioneve Monetare të Bankës monitoron rrezikun e likuiditetit në mënyrë të vazhdueshme duke analizuar treguesit e likuiditetit, boshllëqet dhe skenarët ekonomike.

Politikat e administrimit të likuiditetit vendosen për të siguruar që edhe në kushte të vështira, Banka të jetë në gjendje të përmbushë detyrimet e saj.

Rreziku i kreditit

Departamenti i Operacioneve Monetare të Bankës, nën kontrollin e Këshillit Mbikëqyrës, është përgjegjës për përcaktimin e rrezikut të kreditit, që shoqëron operacionet e Bankës. Rreziku i kreditit zbutet nga ana e Bankës duke kryer transaksione të shumta me institucione qeveritare dhe ndërkombëtare. Kreditë për bankat vendase sigurohen nga bonot e thesarit të qeverisë.

Rreziku i çmimeve

Faktorët kyç të rrezikut të çmimeve, që ndikojnë Bankën janë:

- rreziku i monedhave, i shoqëruar me ndryshime në vlerën e instrumenteve financiare për shkak të ndryshimeve në kurset e këmbimit; dhe
- rreziku i normave të interesit, i shoqëruar me ndryshime në vlerën e instrumenteve financiare për shkak të ndryshimeve në normat e interesave të tregut.

Ekspozimi i Bankës ndaj rrezikut të monedhave monitorohet vazhdimisht nga Departamenti i Operacioneve Monetare. Aktivet financiare, të mbajtura në monedhë të huaj, janë paraqitur në secilën prej shënimeve korresponduese në pasqyrat financiare.

Rreziku i normave të interesit monitorohet nga Departamenti i Operacioneve Monetare të Bankës. Banka e zbut këtë rrezik duke mbajtur një tepricë të konsiderueshme të aktiveve interesprurëse mbi pasivet që paguajnë interes (siç detajohet në shënimin 28 më poshtë). Banka mban një portofol aktivesh dhe pasivesh financiare me interes, të tillë që e ardhura e gjeneruar nga interesi neto është në mënyrë të ndjeshme më e lartë se kërkesat operative,

gjë që minimizon efektet e mundshme negative të ndryshimeve në normat e interesit. Normat e interesit që zbatohen mbi aktivet dhe detyrimet financiare, paraqiten në çdo shënim korrespondues të pasqyrave financiare.

28. NDJESHMËRIA E NORMAVE TË INTERESIT

	Deri në një muaj	Një deri në tre muaj	Tre deri në gjashtë muaj	Gjashtë deri në një vit	Një deri në pesë vjet	Mbi pesë vjet	Jo të ndjeshëm ndaj interesit	Totali
Aktivët								
Ari dhe metalet e çmuara	593	-	-	-	-	-	-	593
Depozita tek Fondit Monetar Ndërkombëtar	-	-	-	-	9,649	-	8,407	18,056
Depozita në banka të huaja	10,553	-	-	-	-	-	-	10,553
Letra me vlerë të disponueshme për shitje	5,351	6,920	7,655	17,593	49,356	-	-	86,875
Aktive të tjera të huaja	-	-	-	-	-	-	588	588
Ari dhe metalet e çmuara	-	-	-	-	-	-	43	43
Kredi tranzite	-	-	-	-	-	-	384	384
Letra me vlerë të disponueshme për shitje	22,078	30,820	18,789	-	-	-	-	71,687
Investime të mbajtura deri në maturim	-	-	-	-	1,573	-	-	1,573
Aktive të tjera vendase	-	-	-	84	-	491	2,060	2,635
	38,575	37,740	26,444	17,677	60,578	491	11,482	192,987
Detyrimet dhe kapitali								
Detyrime ndaj Fondit Monetar Ndërkombëtar	-	-	-	-	9,599	-	7,879	17,478
Detyrime ndaj institucioneve financiare jovendase	-	-	-	5	-	1,183	559	1,747
Paraja në qarkullim	-	-	-	-	-	-	127,774	127,774
Detyrime ndaj bankave vendase	33,970	-	-	-	-	-	-	33,970
Detyrime ndaj qeverisë	-	-	-	-	-	-	5,464	5,464
Të ardhura për t'u shpërndarë	-	-	-	-	-	-	117	117
Detyrime të tjera vendase	-	-	-	-	-	-	389	389
Kapitali dhe rezervat	-	-	-	-	-	-	6,048	6,048
	33,970	-	-	5	9,599	1,183	148,230	192,987
Ndryshimi i bilancit më 31 dhjetor 2003	4,605	37,740	26,444	17,672	50,979	(692)	(136,748)	-
Ndryshimi i akumuluar nga ndjeshmëria e normave të interesit	4,605	42,345	68,789	86,461	137,440	136,748	-	-

	Deri në një muaj	Një deri në tre muaj	Tre deri në gjashtë muaj	Gjashtë deri në një vit	Një deri në pesë vjet	Mbi pesë vjet	Jo të ndjeshëm ndaj interesit	Totali
Aktivët								
Ari	1,182	-	-	-	-	-	-	1,182
Depozita tek Fondi Monetar Ndërkombëtar	-	-	-	-	10,873	-	8,951	19,824
Depozita në banka të huaja	5,446	-	-	-	-	-	-	5,446
Letra me vlerë të disponueshme për shitje	3,438	-	-	-	34,887	-	631	95,814
Aktive të tjera të huaja	26	11,555	13,017	32,286	-	-	-	63
Ari dhe metalet e çmuara	-	-	-	37	-	-	40	40
Kredi tranzite	-	-	-	-	-	-	7,323	7,323
Kredi bankave vendase	3,402	-	-	-	-	-	-	3,402
Kredi për Qeverinë	1,148	-	-	-	-	-	-	1,148
Letra me vlerë	22,170	31,527	20,783	38	1,367	-	-	75,885
Aktive të tjera vendase	5	-	-	112	-	435	2,353	2,905
	36,817	43,082	33,800	32,473	47,127	435	19,298	213,032
Detyrimet dhe kapitali								
Detyrime ndaj Fondit Monetar Ndërkombëtar	-	-	-	-	10,803	-	8,344	19,147
Detyrime ndaj institucioneve financiare jovendase	-	-	-	-	1,234	-	7,536	8,770
Të tjera detyrime të huaja	-	-	-	5	-	-	-	5
Paraja në qarkullim	-	-	-	-	-	-	133,115	133,115
Detyrime ndaj bankave vendase	30,649	-	-	-	-	-	-	30,649
Detyrime ndaj qeverisë	-	-	-	-	-	-	3,024	3,024
Të ardhura për t'u shpërndarë	-	-	-	-	-	-	151	151
Detyrime të tjera vendase	376	-	-	-	-	-	-	376
Kapitali dhe rezervat	-	-	-	-	-	-	17,795	17,795
	31,025	-	-	5	12,037	-	169,965	213,032
Ndryshimi i bilancit më 31 dhjetor 2002	5,792	43,082	33,800	32,468	35,090	435	(150,667)	-
Ndryshimi i akumuluar nga ndjeshmëria e normave të interesit	5,792	48,874	82,674	115,142	150,232	150,667	-	-

29. POZICIONI NETO I MONEDHËS

	LEK	USD	EURO	GBP	Të tjera	Totali
Aktivitet						
Ari	-	-	-	-	593	593
Depozita tek Fondi Monetar Ndërkombëtar	7,879	-	-	-	10,177	18,056
Depozita në bankat e huaja	-	4,667	5,458	428	-	10,553
Letra me vlerë të disponueshme për shitje	-	42,233	41,468	3,174	-	86,875
Aktive të tjera të huaja	360	221	7	-	-	588
Ari dhe metale të çmuara	43	-	-	-	-	43
Kredi tranzite	-	160	224	-	-	384
Letra me vlerë të disponueshme për shitje	71,687	-	-	-	-	71,687
Investime të mbajtura deri në maturim	1,573	-	-	-	-	1,573
Aktive të tjera vendase	2,560	56	18	1	-	2,635
Totali i aktiveve	84,102	47,337	47,175	3,603	10,770	192,987
Detyrimet dhe kapitali i vet						
Detyrime të huaja						
Detyrime ndaj Fondit Monetar Ndërkombëtar	7,879	-	-	-	9,599	17,478
Detyrime ndaj institucioneve financiare jo vendase	176	160	1,411	-	-	1,747
Para në qarkullim	127,774	-	-	-	-	127,774
Detyrime ndaj bankave vendase	24,777	5,086	4,107	-	-	33,970
Detyrime ndaj qeverisë	4,144	194	1,125	1	-	5,464
Të ardhura për t'u shpërndarë	117	-	-	-	-	117
Detyrime të tjera vendase	379	6	4	-	-	389
Kapitali dhe rezervat	3,552	874	1,391	118	113	6,048
Totali i detyrimeve dhe kapitali i vet	168,798	6,320	8,038	119	9,712	192,987
Pozicioni neto në valutë më 31 dhjetor 2003	(84,696)	41,017	39,137	3,484	1,058	-
Pozicioni neto në valutë më 31 dhjetor 2002	(88,841)	43,060	40,286	3,710	1,785	-

TREGUESIT E BUXHETIT

Banka e Shqipërisë harton dhe zbaton buxhetin e saj për realizimin e funksioneve që i janë ngarkuar me ligj.

Aktiviteti financiar i Bankës së Shqipërisë mbështetet në administrimin e rezervës valutore, kreditimin e qeverisë dhe në marrëdhëniet me bankat e nivelit të dytë, në funksion të politikës monetare. Banka e Shqipërisë ka objektivat e saj që gjejnë pasqyrim në treguesit e buxhetit, të cilët miratohen nga Këshilli Mbikëqyrës.

Treguesit kryesorë të buxhetit për vitin 2003 janë realizuar si në pasqyrën e mëposhtme:

Nr.	Treguesit	Plan	Fakt	Ndryshesa	
				Në vlerë	Në %
1.	Të ardhurat nga interesat	12,517,455	10,206,825	(2,310,630)	82%
	Të ardhura në valutë	3,450,745	2,615,667	(835,078)	76%
	Të ardhura nga veprimet me qeverinë	9,053,180	7,566,997	(1,486,183)	84%
	Të ardhurat nga kreditë për instit.fin.	13,530	24,161	10,631	179%
2.	Shpenzimet për interesat	1,204,146	1,416,336	212,190	118%
	Shpenzimet në valutë	191,531	138,097	(53,434)	72%
	Shpenzimet në lekë	1,012,615	1,278,239	265,624	126%
3.	Të ardhurat neto nga interesat (1-2)	11,313,309	8,790,489	(2,522,820)	78%
4.	Të ardhura të tjera (neto)	10,900	81,844	70,944	~8 herë
5.	Gjithsej të ardhurat (neto) (3+ 4)	11,324,209	8,872,333	(2,451,876)	78%
6.	Kosto operative	694,230	566,382	(127,848)	77%
	Kosto personeli	382,967	388,280	5,313	94%
	Shpenzime administrative	228,760	145,460	(83,300)	64%
	Shpenzime per administr. e aktiveve	82,503	32,642	(49,861)	40%
7.	Shpenzime amortizimi	497,700	438,934	(58,766)	88%
8.	Fitimi para zbritjeve (5-6-7)	10,132,279	7,867,017	(2,265,262)	78%

“Të ardhurat në valutë” të konvertuara në dollarë amerikanë janë tejkalar për rreth 267 mijë dollarë amerikanë, ndërsa të ardhurat në valutë të shprehura në lekë, nuk janë realizuar sipas parashikimit. Në këtë situatë kanë ndikuar disa faktorë, midis të cilëve kursi i këmbimit ka dhënë efektin negativ dominues rreth 873 milionë lekë, duke absorbuar dhe efektin pozitiv të tejkalimit të volumit të rezervës valutore. Rezerva valutore ishte parashikuar 812 milionë dollarë amerikanë, ndërsa u realizua në rreth 1 miliard dollarë e konvertuar.

“Të ardhurat nga veprimet për qeverinë” rezultojnë me mosrealizim si rezultat i ndërthryes së dy faktorëve: Ulja e stokut të financimit të deficitit të buxhetit të shtetit për më pak se 1 mld e 152 mln lekë dhe rënia e *yield*-it nga investimi në bono thesari për 334 mln lekë. Këta dy faktorë vlerësohen si faktorë pozitivë, sepse shprehin përmirësimin e likuiditetit në sistem dhe rënien e koston së parasë, pavarësisht se nuk janë realizuar të ardhurat e Bankës së Shqipërisë.

“Shpenzimet në valutë” nuk janë realizuar sipas parashikimit, kryesisht për shkak të rënies së kursit të këmbimit të valutave në krahasim me parashikimin. Një tjetër shkak është ulja e normave të interesit për llogaritë (detyrimet) me FMN-në dhe për rezervat e detyruara të bankave tregtare në Bankën e Shqipërisë, në krahasim me parashikimet e bëra.

“Shpenzimet ndaj detyrimeve në lekë” janë tejkalar në krahasim me parashikimin. Përmirësimi i ndjeshëm i likuiditetit në sistemin bankar ka dhënë efektet e veta në tejkalimin e shpenzimeve për interesat Repo dhe për depozitat e tjera të bankave të nivelit të dytë.

Shpenzimet për rezervën e detyruar në lekë rezultojnë në kufijtë e parashikimit. Efektet e rritjes së gjendjes mesatare të depozitave dhe të rritjes së përqindjes të normës bazë të interesit në lekë, të euriborit dhe të liborit në remunerimin e rezervës së detyruar, neutralizohen nga rënia e nivelit të normës mesatare të interesit.

Shpenzimet administrative janë realizuar më pak nga parashikimi, pothuajse në të gjithë përbërësit, për shkak të mosrealizimit në kohë të disa shpenzimeve nga njëra anë, por edhe për shkak të konceptimit të planit si kufi i sipërm (maksimal). Megjithatë, mosrealizimet nuk kanë penguar mbarëvajtjen e punës.

